

2025

RAPORT PËR
VLERËSIMIN E
INDUSTRIË SË
NAFTËS NË
REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË:
SHËNDET SIGURI,
NDIKIMI SOCIO-
EKONOMIK,
EMETIMET DHE
QËNDRUESHMËRI


KONSULT & CO

Gjeokonsult & Co Sh.p.k



TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES SË FIGURAVE	4
PËRMBAJTJA E TABELAVE	5
1. HYRJE	6
1.1 Historia e naftës në Shqipëri	6
1.2 Qëllimi dhe objektivat e raportit	9
1.3 Metodologjia e vlerësimit	9
2. VLERËSIMI I BURIMEVE	9
2.1 Rezervat kryesore të naftës sipas fushave	10
2.1.1 Vendburimet Ranore	10
2.1.2 Vendburimet Gëlqerore	12
2.2 Vendburimet kryesore të naftës dhe prodhimet e tyre ndër vite në Shqipëri	15
2.3 Kapaciteti i Prodhimit. Kërkimi dhe Eksplorimi i Rezervave Hidrokarbure në Shqipëri (2014–2024)	19
2.4 Projekti TAP (Trans Adriatic Pipeline)	22
2.5 Rafineritë	23
3. VLERËSIMI EKONOMIK	24
3.1 Klima e investimeve	24
3.2 Analizë Kontabël mbi Kontributin Ekonomik të Aktiviteteve Kryesore të industrisë nxjerrëse (naftë dhe nënprodukteve të saj) (2014–2024)	27
3.3 Kontributi në PBB dhe Financat Publike (2014–2024)	28
3.3.1 Kontributi në PBB (2014-2024)	28
3.3.2 Financat publike	29
3.4 Pësia relative e sektorit ekonomik të naftës në krijimin e vlerës së shtuar bruto në ekonominë e Shqipërisë	32
4. VLERËSIMI MJEDISOR DHE SOCIAL	34
4.1 VLERËSIMI RREGULLATOR DHE I POLITIKAVE	34
4.1.1 Analizë e kuadrit ligjor rregullator të sektorit të naftës në Shqipëri	34
4.1.2 Analizë e kuadrit ligjor fiskal të sektorit të naftës në Shqipëri	36
4.1.3 Kuadri ligjor me ndikim mjedisor në sektorin e naftës në Shqipëri	41
4.1.4 Kuadri ligjor rregullator liçencues i sektorit të naftës në Shqipëri	46
4.1.5 Kuadri ligjor mbrojtës i sigurisë në punë dhe mekanizmat mbrojtës për statusin e punonjësit në sektorin e naftës në Shqipëri	48
4.2 NDIKIMI MJEDISOR	53
4.2.1 Emetimet e gazeve serrë dhe ndotja e ajrit	54
4.2.2 Derdhjet aksidentale dhe mbetjet e naftës	63

4.3 EFEKTIVITETI I MASAVE MBROJTËSE	63
4.3.1 Procesi Teknik i Pastrimit të Përmbajtjeve të Sulfateve dhe H ₂ S në Ujërat e Ndotur nga Industria e Naftës	63
4.3.2 Trajtimi Biologjik i Ujrave të Ndotura me Naftë	64
4.4 PLANI I PËRMBALLIMIT TË EMERGJENCAVE	64
4.5 SHËRBIMET E EKOSISTEMIT.....	67
4.5.1 Pastrimi i ujit	67
4.5.2 Sasia e naftës që depërton në shtresë në varësi të tipit litologjik	68
4.5.3 Përcaktimi i pjellorisë natyrore të tokës.....	69
4.6 NDIKIMI MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE.....	71
4.6.1 Vlerësimi i përputhshmërisë së projekteve të naftës me angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare për klimën.	72
4.6.2 Burimet ujore lokale.....	72
4.7 NDIKIMI SOCIAL	73
4.7.1 Punësimi dhe mundësitë për punë lokale	74
4.7.2 Praktikë e punës në sektorin e naftës	78
4.7.3 Standardet e sigurisë në vendin e punës.....	79
4.7.4 Prokurimi lokal dhe zhvillimi i bizneseve vendore.....	80
4.7.5 Zhvillimi i infrastrukturës	80
4.7.6 Zhvendosjet e popullsisë	81
4.7.7 Angazhimi i komunitetit në vendimmarrje	81
4.7.8 Investimet e kompanive të naftës në zonat përreth	82
4.7.9 Plani i menaxhimit ambiental dhe social	82
5. VLERËSIMI TEKNOLOGJIK DHE INFRASTRUKTUROR	86
5.1 Vlerësimi Teknologjik	86
5.1.1 Inteligjenca Artificiale (AI) dhe Digitalizimi	87
5.1.2 Teknologji të EOR (Enhanced Oil Recovery)	87
5.1.3 Mirëmbajtja Parashikuese dhe Automatizimi me Ndihmën e Inteligjencës Artificiale (AI)	88
5.2 Vlerësimi i Infrastrukturës	89
5.2.1 Rafinieritë dhe magazinimi	89
5.2.2 Rrjeti i pipelajnit dhe rrugët industriale	89
5.2.3 Iniciativa të ardhshme dhe modernizime	90
5.3 Vlerësimi i rreziqeve	90
6. VLERËSIMI I QËNDRUESHMËRISË DHE KALIMI ENERGJETIK.....	92
6.1 Potenciali për tranzicion energjetik në sektorin e naftës.....	93

6.1.1 Gazifikimi dhe tranzicioni i butë.....	93
6.1.2 Transformimi i operatorëve ekzistues.....	93
6.1.3 Ulja e emetimeve nga nxjerrja	93
6.1.4 Shfrytëzimi i të ardhurave për tranzicionin energjetik.....	94
BIBLIOGRAFIA.....	95

TABELA E PËRMBAJTJES SË FIGURAVE

Figure 1. Blloqet e kerkimit te naftes ne Shqiperi.....	6
Figure 2. Grafiku. Ecuria e prodhimit, importit dhe eksportit të produkteve të naftës (ktoe) ndër vite.	19
Figure 3. Grafiku. Ecuria e përpunimit të naftës bruto (ktoe).....	20
Figure 4. Grafiku. Ecuria e Import, Eksportit të produkteve të naftës, (ktoe).	20
Figure 5. Grafiku. Prodhimi i Gazit (ktoe) nder vite.	21
Figure 6. Zgjerimi i kapacitetit te projektit TAP.	23
Figure 7. Grafik. Sasinë e përpunuar të naftës në ktoe për çdo vit (shtyllat blu) dhe Humbjen teknologjike në përqindje përkatëse (vija e kuqe).....	24
Figure 8. Shpenzime për materiale dhe furnitura në sektorin e naftës (2014-2023) sipas të dhënave të marra nga INSTAT.	25
Figure 9. Shpenzime për materiale dhe furnitura në sektorin e naftës (2014-2023) sipas të dhënave të marra nga INSTAT.	25
Figure 10. Shpenzime për investime gjithsej në sektorin e naftës (2014-2023) sipas të dhënave të marra nga INSTAT.	26
Figure 11. Ecuria e shpenzimeve dhe investimeve ne sektorin e naftës në Shqipëri sipas të dhënave të INSTAT (2014-2024).	26
Figure 12. Kontributi i naftës dhe nënprodukteve të saj në ekonominë e vendit 2014-2024 sipas të dhënave marrë nga INSTAT.	28
Figure 13. Kontributi i industrisë nxjerrëse dhe përpunuese (naftë) në PBB (2014-2024) sipas të dhënave të marra nga INSTAT (në përqindje).....	29
Figure 14. Kërkesa totale e investimeve kumulative 2018–2030 në aktivitetet e sektorit të naftës.	32
Figure 15. Grafik. Pesha relative e sektorit të naftës në vlerën e shtuar bruto (2014-2024) sipas të dhënave të marra nga INSTAT.	34
Figure 16. Grafiku numri i të punësuarve gjithsej në sektorin e naftës në Shqipëri (2014-2023) sipas të dhënave të marra nga INSTAT.	75
Figure 17. Grafik. Punësimi sipas gjinisë në sektorin e naftës dhe gazit (2019-2023) sipas të dhënave të marra nga DPT.	77
Figure 18. Përqindja e te punesuarve femra dhe meshkuj ne sektorin e naftes dhe gazit nder vite (2019-2023).	77
Figure 19. Përqindja e te punesuarve femra dhe meshkuj ne sektorin e naftes dhe gazit per vitet 2019-2023 (total).	78
Figure 20. Skema e menaxhimit të riskut sipas Albpetrol sh.a.	92

PËRMBAJTJA E TABELAVE

Table 1. Karakteristikat kryesore të vendburimit Patos-Marinzë.....	11
Table 2. Karakteristikat kryesore të vendburimit Kuçovë – Arrëz.....	11
Table 3. Karakteristikat kryesore të vendburimit Gorisht-Kocul.	12
Table 4. Karakteristikat kryesore të vendburimit Cakran-Mollaj.	13
Table 5. Karakteristikat kryesore të vendburimit të Amonicës.	13
Table 6. Karakteristikat kryesore të vendburimit Ballsh-Hekal.	14
Table 7. Prodhimi i naftës ndër vite Albpetrol.	14
Table 8. Prodhimi i naftës ndër vite në vendburimin e Kuçovës.	15
Table 9. Prodhimi i naftës ndër vite në vendurimin e Patosit.....	15
Table 10. Prodhimi i naftës ndër vite në vendurimin Cakran-Mollaj.....	16
Table 11. Prodhimi i naftës ndër vite në vendurimin Gorisht - Kocul.....	16
Table 12. Prodhimi i naftës ndër vite në vendburimin e Amonicës.	17
Table 13. Prodhimi për çdo 3-mujor në vendburimin e Ballsh-Hekal në periudhën 2015-2025.....	18
Table 14. Prodhimi gjatë viteve 1992-2025 në vendburimin Ballsh-Hekal.	18
Table 15. Prodhimi gjatë viteve 1967-2025 në vendburimin Ballsh-Hekal.	19
Table 16. Vlerat e shpenzime dhe investimeve të realizuara nga kompanitë në sektorin e naftës në Shqipëri sipas të dhënave të INSTAT (2014-2024).	27
Table 17. Kontributi i industrisë nxjerrëse dhe përpunuese (naftë) në PBB (2014-2024) sipas të dhënave të marra nga INSTAT (në përqindje).....	29
Table 18. Programi i zhvillimit ekonomik të shoqërisë “Albpetrol” SH.A për vitin 2023.....	30
Table 19. Programi i zhvillimit ekonomik të shoqërisë “Albpetrol” SH.A për vitin 2024.....	30
Table 20. Programi i Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë “Albpetrol” SH.A për vitin 2022, realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve.	31
Table 21. Donacione, sponsorizime (sipas viteve).....	32
Table 22. Pesha relative e sektorit të naftës në vlerën e shtuar bruto (2014-2024) sipas të dhënave të marra nga INSTAT.	34
Table 23. Matjet e kryera në pikën monitoruese Gj4 - Gjanice, Ura e Qytetit Fier.	58
Table 24. Përmbajtja e metaleve në ujin e lagunave për vitin 2023.	60
Table 25. Numri i të punësuarve gjithsej në sektorin e naftës në Shqipëri (2014-2023) sipas të dhënave të marra nga INSTAT.	75
Table 26. Punësimi sipas gjinisë në sektorin e naftës dhe gazit (2019-2023) sipas të dhënave të marra nga DPT.	77
Table 27. Plani I Menaxhimit Ambiental dhe Social.	86

1. HYRJE

1.1 Historia e naftës në Shqipëri

Industria e naftës në Shqipëri ka kaluar nëpër faza të ndryshme zhvillimi dhe sfidash, duke mbajtur ende një rol të rëndësishëm në ekonominë kombëtare. Shqipëria, me një histori të gjatë në nxjerrjen e naftës që daton që nga fillimi i shekullit të XX-të, vazhdoi të jetë një prej prodhuesve kryesorë të naftës në Ballkan. Në vitet e para të kësaj periudhe, sektori u fokusua në modernizimin e infrastrukturës ekzistuese dhe përmirësimin e efikasitetit të prodhimit, kryesisht nëpërmjet bashkëpunimeve me kompani të huaja dhe investimeve në teknologji më të avancuar.

Albpetrol, kompania shtetërore, mbeti aktori kryesor në menaxhimin e puseve ekzistuese dhe në zhvillimin e aktiviteteve eksploruese. Sektori përballoi sfida të konsiderueshme për shkak të uljes së prodhimit të rezervave të naftës dhe kërimit për fusha të reja eksploruese, duke u orientuar gjithashtu drejt diversifikimit të burimeve energjetike.

Në këtë periudhë, qeveria shqiptare miratoi disa reforma ligjore dhe rregullatore me qëllim përmirësimin e kuadrit të investimeve dhe rritjen e transparencës në sektor, duke përfshirë përputhjen me standardet e EITI. Kjo ndikoi në rritjen e besueshmërisë së sektorit dhe tërheqjen e investimeve të reja, megjithatë sfidat mjedisore dhe sociale mbetën problematika të rëndësishme për tu adresuar.

Një aspekt i rëndësishëm ishte përmirësimi gradual i standardeve të sigurisë dhe menaxhimit mjedisor, veçanërisht në drejtim të reduktimit të ndotjes së ujërave dhe ajrit, si dhe masave për parandalimin e aksidenteve industriale. Megjithatë, ndotja lokale dhe ndikimet në komunitetet përreth vazhduan të jenë shqetësime të vazhdueshme. Nga ana socio-ekonomike, sektori i naftës vazhdon të sigurojë vende pune dhe të kontribuojë në zhvillimin e disa rajoneve rurale, por nevoja për përfshirje më të madhe të komuniteteve dhe përmirësim të marrëdhënieve sociale u bë gjithnjë e më e evidente.

Gjatë periudhës 2014–2024, sektori i naftës ka kaluar nëpër një fazë të thellë tranzicioni, i ndikuar nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm: ndryshimet në tregjet ndërkombëtare të energjisë, hyrja dhe dalja e investitorëve të huaj, përmirësimet legislative dhe shtimi i kërkesave për transparencë. Këto zhvillime kanë ndikuar jo vetëm në volumet e prodhimit, por edhe në modelin e qeverisjes së këtij sektori.

Rëndësia ekonomike e këtij sektori u reflektua në të ardhurat fiskale që gjeneroi: sipas EITI Albania (2022), industria e naftës kontribuoi me 4.7% të totalit të të ardhurave nga industritë nxjerrëse dhe afërsisht 0.9% të PBB-së kombëtare në vitin 2021. Kjo peshë është më e ulët se në dekadën e mëparshme,




Figure 1. Billoqet e kerkimit te naftes ne Shqiperi.

por ende përfaqëson një burim të rëndësishëm për buxhetin publik, sidomos për bashkitë që përfitojnë nga shpërndarja e rentës minerare.

Industria e naftës në Shqipëri përbëhet nga disa kompani kryesore që operojnë në fusha të ndryshme. Disa prej tyre janë aktive në nxjerrjen e naftës, ndërsa të tjera janë të angazhuara në tregtimin dhe shpërndarjen e saj.

Disa nga kompanit kryesore në sektorin e naftës në Shqipëri mund të permendim:

- Albpetrol - Kompania shtetërore përgjegjëse për administrimin e puseve të naftës në fusha të mëdha si Patos-Marinë dhe Ballsh, me prodhim vjetor mbi 110,000 tonë;
- Bankers Petroleum Albania;
- Kompani të tjera - Transoil Group (IEC Visoka / Terraol Sëiss), Phoenix Petroleum sh.a., TransAtlantic Ltd (ish-Stream Oil & Gas), Sherwood International Petroleum, Kastrati Group, të përfshira në eksplorim, prodhim dhe distribim.

Ndërsa persë i përket perpunimit (rafinimit) të naftës mund të permendim :

1. Bitex Refinery (ish kombinati metalurgjik), (Balldren, Elbasan) – aktualisht është i vetmi objekt industrial i aktiv për përpunim të naftës së rëndë në vend, me kapacitet ~200 000 tonë/vit. Proceson bitumen, heavy gasoil dhe nafta (naphtha).
2. ARMO (Ballsh & Fier) – është jo-operative. Refineria e Ballshit u shkatërrua për skrap pas 2021 dhe ka borxhe të mëdha, ndërsa pjesa në Fier nuk funksionon si refineri aktive
3. Importues dhe tregtarë të karburanteve - Në mungesë të prodhimit vendas të karburanteve të përpunuara, Shqipëria importon pjesën me të madhe të tyre.

Në këtë dhjetëvjeçar të fundit, sektori i naftës në Shqipëri është karakterizuar nga një përqendrim i lartë i prodhimit në duart e pak kompanive. Albpetrol SHA, ndërmarrja shtetërore, vazhdoi të operojë si mbajtëse e të drejtave mbi shumë blloqe naftëmbajtëse. Në shumë raste, ajo luan rol si bashkëkontraktuese ose agjente mbikëqyrëse ndaj operatorëve privatë. Roli i saj institucional është i rëndësishëm për garantimin e kontinuitetit teknik dhe ruajtjen e kontrollit mbi rezervat strategjike, por sfidat financiare dhe mungesa e investimeve e kanë kufizuar rolin operacional të saj.

Transoil Group dhe Phoenix Petroleum janë ndër operatorët e mesëm dhe të vegjël që kanë fituar të drejtën e shfrytëzimit në disa blloqe më të vogla apo fushata me prodhim më të ulët. Kontributi i tyre në totalin e prodhimit mbetet modest, por kanë qenë të rëndësishëm për ruajtjen e aktivitetit në zona që ndryshe do mbeteshin të paprekura. Të dhënat nga raportet e EITI dhe AKBN tregojnë se mesatarisht 85% e gjithë prodhimit të naftës gjatë periudhës 2014–2024 është realizuar nga kompani të tjera, ndërkohë Albpetrol ka ruajtur një pjesë prej rreth 10–12%, ndërsa pjesa tjetër është ndarë midis operatorëve të vegjël.

Ndikimi ekonomik i këtyre kompanive nuk matet vetëm përmes sasisë së naftës së përpunuar që ato prodhojnë, por edhe në disa faktorë të tjerë të rëndësishëm, si: tatimet dhe taksat që ato paguajnë (përfshirë tatimin mbi fitimin, rentën, TVSH-në dhe të tjera), punësimin që krijojnë si në nivel lokal ashtu edhe përmes nënkontraktorëve, investimet që realizojnë në infrastrukturë si rrugë dhe impiante teknologjike, si dhe kontributet që japin në formën e rentës minerare për bashkitë përkatëse.

Në përfundim, kompanitë kryesore janë motorë të prodhimit, por edhe elementë kyç në sistemin e marrëdhënieve me shtetin, transparencën dhe përfitimin publik. Politikat publike duhet të sigurojnë një balancë midis nxitjes së investimeve dhe rritjes së kontrollit përmes mekanizmave të fortë të qeverisjes dhe përfaqësimit komunitar.

Zhvillimi i aktivitetit të hidrokarbureve në Shqipëri, përfshirë investimet dhe operacionet e kompanive që operojnë në kerkim - shfrytëzimin, sjell përfitime të rëndësishme ekonomike dhe ndihmon në plotësimin e nevojave kombëtare për energji. Ky sektor kontribuon në rritjen e të ardhurave shtetërore, krijimin e vendeve të punës dhe sigurimin e furnizimit të brendshëm me naftë dhe gaz. Megjithatë, megjithëse ka përfitime të dukshme, aktivitetet e nxjerrjes dhe përpunimit të hidrokarbureve kanë ndikime negative në mjedis, duke përfshirë ndotjet në:

- Ndotja me gazra të dëmshme në ajër (H₂S, CO₂);
- Nivele të larta të metaleve të rënda dhe përbërësve toksikë janë evidentuar në ujërat sipërfaqësorë dhe tokat përreth, duke rrezikuar bujqësinë dhe ekosistemet.
- Përdorimi i fracking-ut ka shkaktuar lëkundje të tokës dhe ka nxitur shqetësime për sigurinë dhe mjedisin.
- Mungesa e protokolleve të qarta për trajtimin e mbetjeve radioaktive dhe kimike përbën rrezik afatgjatë për mjedisin.
- Rritje e sëmundshmërisë, veçanërisht sëmundjeve respiratore dhe kancerogjene në zonat e prodhimit.
- Protesta dhe tensione sociale për shkak të ndotjes dhe mungesës së kompensimeve.
- Probleme me pabarazi sociale dhe përfshirjen e komuniteteve vendore në përfitime ekonomike.

Për këtë arsye, është e domosdoshme të implementohen masa të forta mbrojtjeje mjedisore dhe politika të qëndrueshme zhvillimore për të minimizuar efektet e dëmshme. Është thelbësore të forcohet rregullimi dhe monitorimi mjedisor për të minimizuar ndotjen dhe efektet negative.

- Nevojitet transparencë dhe drejtësi sociale në shpërndarjen e përfitimeve ekonomike, me fokus në përmirësimin e kushteve për komunitetet lokale.
- Zhvillimi i teknologjive të pastra dhe investimet në kapacitete të reja për përpunim duhet të jenë prioritare për të reduktuar varësinë nga importet.
- Iniciativa për trajtimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e burimeve natyrore duhet të implementohen në bashkëpunim me organizatat lokale dhe ndërkombëtare.

Për më tepër, përmirësimet në teknologjinë e monitorimit të prodhimit dhe implementimi i sistemit të regjistrimit të pronarëve përfitues kanë rritur besueshmërinë dhe kontrollin institucional mbi industrinë. Këto reforma janë jetike për të siguruar një ndarje më të drejtë të përfitimeve dhe për të reduktuar rreziqet e korrupsionit në një sektor me peshë të madhe strategjike.

Nga ana institucionale, periudha 2014–2024 përkoi me konsolidimin e kornizës së transparencës përmes angazhimit në Iniciativën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI). Shqipëria ka përmirësuar ndjeshëm publikimin e kontratave¹, raportimin e të ardhurave, dhe përfshirjen e aktorëve lokalë në proceset e vendimmarrjes. Këto zhvillime janë përshpejtuar pas vitit 2020, kur Shqipëria filloi zbatimin e plotë të standardit EITI 2019 dhe përgatitjen për standardin EITI 2023.

Në përfundim, sektori i naftës ka qenë jo vetëm një kontribues fiskal, por edhe një fushë testuese për reformat institucionale dhe ligjore në Shqipëri. Ai përfaqëson një shembull të qasjes graduale drejt qeverisjes së mirë dhe transparencës, si dhe një sfidë të vazhdueshme për ta përshtatur këtë industri me kërkesat e reja të zhvillimit të qëndrueshëm dhe tranzicionit energjetik.

¹ Për më tepër shih <https://qbz.gov.al/>, <http://www.akbn.gov.al/marrevshjet-hidrokarbure-kompanite/>, <https://www.infrastruktura.gov.al/kompanite-2/>.

1.2 Qëllimi dhe objektivat e raportit

Qëllimi i kësaj detyre është të vlerësojë shtrirjen, karakteristikat dhe ndikimet e investimeve të industrisë së naftës në Shqipëri, me fokus të veçantë në këto aspekte kryesore:

- Vlerësimi i ndikimeve të aktiviteteve nxjerrëse në shëndetin publik, duke përfshirë aksesin në ujë të pastër, cilësinë e ajrit dhe ndikimet shëndetësore që lidhen me afërsinë ndaj infrastrukturës së rrezikshme të industrisë së naftës.
- Vlerësimi i standardeve të sigurisë në vendin e punës, kapacitetit për përballimin e situatave emergjente, frekuencës dhe menaxhimit të derdhjeve aksidentale, si dhe rreziqeve për komunitetet përreth.
- Analiza e krijimit të vendeve të punës, angazhimit të furnitorëve lokalë, investimeve në infrastrukturën mbështetëse, zhvendosjes së popullsisë dhe cilësisë së angazhimit me komunitetin.
- Shqyrtimi i emetimeve të gazeve serrë, ndotjes së ujit dhe ajrit, praktikave të djegies së gazit (flaring), ndotjes së tokës, ndikimeve mbi habitatet natyrore, humbjes së biodiversitetit dhe rreziqeve të tjera mjedisore të lidhura me veprimtarinë e industrisë së naftës në Shqipëri.

1.3 Metodologjia e vlerësimit

Për realizimin e këtij vlerësimi gjithëpërfshirës të industrisë së naftës në Shqipëri gjatë periudhës 2014–2024, është përdorur një qasje metodologjike që kombinon analiza dokumentare, mbledhjen e të dhënave dhe vlerësimin e ndikimeve në aspektet shëndetësore, sociale, ekonomike dhe mjedisore. Burimet kryesore të të dhënave përfshijnë raportet vjetore dhe të ndërmjetme të kompanive kryesore si Albpetrol dhe kompani të tjera private që operojnë në sektor, të cilat ofrojnë informacion mbi prodhimin, investimet, standardet e sigurisë dhe masat për menaxhimin e ndikimeve mjedisore. Gjithashtu, janë përdorur të dhëna nga institucionet shtetërore si Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës, Ministria e Mjedisit, Banka e Shqipërisë dhe Instituti i Statistikave (INSTAT), që sigurojnë shifra zyrtare lidhur me ndikimet ekonomike, të ardhurat nga sektori dhe çështjet mjedisore e shëndetësore që lidhen me aktivitetet industriale.

Përveç kësaj, janë shqyrtuar studime të ndryshme mjedisore dhe social-ekonomike të realizuara nga organizata joqeveritare, agjenci ndërkombëtare dhe institucione akademike, të cilat ndihmuan në identifikimin e çështjeve kryesore lidhur me ndotjen e ujërave, cilësinë e ajrit dhe efektet në komunitetet përreth. Metodologjia përfshiu rishikimin e literaturës së disponueshme, analizën e të dhënave sekondare për identifikimin e trendeve dhe sfidave në sektor, si dhe mbledhjen e të dhënave primare përmes intervistave me përfaqësues të institucioneve shtetërore, kompanive dhe organizatave lokale për të marrë një pamje më të thelluar të situatës në terren. Për më tepër, u krye një analizë krahasuese me standardet ndërkombëtare për të identifikuar boshllëqet dhe mundësitë për përmirësim.

Megjithatë, metodologjia ka disa kufizime, përfshirë mungesën e të dhënave të detajuara nga disa kompani private për shkak të politikave të konfidencialitetit, si dhe mungesën e monitorimit të vazhdueshëm mjedisor dhe shëndetësor në disa zona, që kanë vështirësuar krijimin e një panorame të plotë.

2. VLERËSIMI I BURIMEVE

Albpetrol sh.a., është një ndërmarrje e kërkimit dhe prodhimit të naftës dhe gazit, plotësisht në pronësi të qeverisë, e cila ka të drejtat ekskluzive për zhvillimin e të gjitha vendburimeve ekzistuese të naftës dhe

gazit. Pjesa më e madhe e prodhimit të naftës mbi të cilin ALBPETROL-in ka të drejta prodhimi, është kontraktuar në kompanitë e huaja prej të cilave pothuajse 60% eksportohen për rafinim në produkte jashtë vendit, gjë e cila varet nga konjunkturën e tregut të rafinimit të naftës bruto në vend, duke pasur ndryshime të vazhdueshme të sasive të naftës bruto të përpunuara në vend. Rezervat e naftës dhe gazit ende të pazbuluara në Shqipëri, si në det të hapur dhe në tokë, besohet të jenë të rëndësishme, por kërkimi i tyre do të kërkojë përdorimin e teknologjive të sofistikuar të cilat është synuar që të sigurohen nga tërheqja e investitorëve të huaj që disponojnë kapacitete të tilla. Po punohet që të zhvillohen programe për t'i paraqitur këto mundësi industrisë ndërkombëtare të naftës në një mënyrë të strukturuar si një mjet për t'i kthyer ato në burime shumë të rëndësishme zhvillimi ekonomik për Shqipërinë.²

Resurset gjeologjike të Shqipërisë janë vlerësuar nga Albpetrol SHA me një total rreth 437.6 milionë ton, nga të cilat 81 milionë ton janë konsideruar të rikuperueshme sipas teknologjive të disponueshme deri në vitet 1990. Deri më 1 janar 2018, ishin prodhuar gjithsej 61.36 milionë ton naftë bruto, ose rreth 75.7% e rezervave të rikuperueshme dhe 14% e rezervave gjeologjike totale. Bazuar në zhvillimet teknologjike në 20 vitet e fundit, vlerësohet se rezervat e rikuperueshme mund të jenë 50–60% më të larta, pra në intervalin 110–120 milionë ton. Sipas vlerësimeve të burimeve ndërkombëtare për periudhën 2016–2021, Shqipëria zotërte 150–168 milionë barele rezervë të provuar naftë, duke u renditur në vendin e 59-të në rang botëror.³

Tregu i Shqipërisë për produktet e rafinuara është i vogël sipas standardeve evropiane, me një konsum total prej rreth 1 milion ton metrikë (mt) në vit. Në situatën aktuale është domosdoshmëri rritja e kapaciteteve të rafinimit të naftës bruto në vend, nëpërmjet përmirësimit të teknologjive në rafineritë ekzistuese (në Ballsh dhe në Fier) sipas standardeve bashkëkohore, apo zhvillimit të rafinerive të reja sipas standardeve evropiane.⁴

Rezervat ekzistuese dhe potenciale të hidrokarbureve kanë potencial të konsiderueshëm për Shqipërinë për përfitime të konsiderueshme ekonomike nga shfrytëzimi më i madh dhe intensiv i naftës. Në vendburimet kryesore të naftës në Shqipëri të cilat janë vlerësuar me rezerva gjeologjike në 437 milionë tonë, nga të cilat, deri më tani, janë prodhuar rreth 62,3 milionë tonë naftë, kanë mbetur ende edhe afërsisht rreth 46,9 milionë tonë naftë rezerva të nxjerrshme, sipas vlerësimit të AKBN-së. Duke pasur në konsideratë që rezervat e nxjerrshme të naftës kushtëzohen edhe nga mënyrat e shfrytëzimit dhe teknologjia që aplikohet në vendburime, sasia e llogaritur e rezervave të nxjerrshme mund të ndryshojë me kohën. Të gjitha shifrat e lartpërmendura bazohen në shifrat e deklaruar të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe të AKBN-së.⁵

2.1 Rezervat kryesore të naftës sipas fushave

2.1.1 Vendburimet Ranore

A. VENDBURIMI PATOS – MARINËZ

Vendburimi Patos – Marinëz ndodhet në juglindje të Ultësirës Pran Adriatike. Në shkëmbinjtë ranorik të Tortonianit gjenden 5 formacione naftëmbajtëse të cilët nga poshtë lart emërtohen; Bubullima, Marina

² Këshilli i Ministrave. (2018). *Vendim nr. 480, datë 31.07.2018; Për miratimin e strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018-2030 – Shqipëria 2030*. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Marrë nga <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2024/09/vendim-2018-07-31-480.pdf>, Faqe 36.

³ Albpetrol. (2018). *Geological reserves*. <https://www.albpetrol.al/en/geological-reserves/>

⁴ Këshilli i Ministrave. (2018). *Vendim nr. 480, datë 31.07.2018; Për miratimin e strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018-2030 – Shqipëria 2030*. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Marrë nga <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2024/09/vendim-2018-07-31-480.pdf>, Faqe 36.

⁵ Po aty.

nr. 1, Marinza Nr. 2, Driza dhe Gorani. Mënyra kryesore e nxjerrjes së naftes nga shtresa është ajo e energjisë së gazit të tretur në naftë.⁶

KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË VENDBURIMIT PATOS-MARINZË	
Formacioni	Ranor
Rezervat gjeologjike (ton)	258 393 913
Rezervat fillestar të nxjerrshme (ton)	31 120 186
Tipi i fluidit	Naftë
Tipi i naftës	Gjysëm aromatike – asfalto aromatike
Densiteti (⁰ API)	3 – 38.8
Viskoziteti 20 ⁰ C(Cp)	50 – 190, 000
Presioni fillestar i rezervuarit (atm)	20 – 185
Përmbajtja e Squfurit (%)	2 – 6
Temperatura (⁰ C)	0 – 50
Trashësitë e përgjithshme të shtresave ranore (m)	1 – 120
Përshkushmëria e shtresave ranore (MD)	10 – 7500
Kripshmëria e ujit e shtresave ranore (mg/l)	1000 – 42 000

Table 1. Karakteristikat kryesore të vendburimit Patos-Marinzë⁷

B. VENDBURIMI KUÇOVË – ARRËZ

Ky vendburim përbëhet nga shtresa naftëmbajtëse me sipërfaqe të kufizuara në formë linzash të vendosura njëra mbi tjetrën dhe të ndara nga argjilat.

KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË VENDBURIMIT KUÇOVË	
Formacioni	Ranorë
Rezervat Gjeologjike (ton)	78 331 796
Rezervat fillestar të nxjerrshme (ton)	11 772 485.7
Nafta e nxjerrë (ton) deri më 01.01.2023	4 415 248.14
Rezervat e nxjerrshme të mbetura (ton) deri më 01.01.2023	7 357 237.56
Tipi i fluidit	Naftë
Tipi i naftës	Nafteno – aromatike
Densiteti (⁰ API)	12 – 22
Viskoziteti 20 ⁰ C(Cp)	50 – 200
Presioni fillestar i rezervuarit (atm/10m)	1.05, Arrëza (118 atm)
Përmbajtja e Squfurit (%)	2,4 - 5
Temperatura (⁰ C)	30-35
Përshkushmëria e shtresave ranore (MD)	20 – 900
Kripshmëria e ujit e shtresave ranore (mg/l)	10 000 – 45 000
Trashësia e përgjithshme (m)	2 – 19 dhe 10 – 160

Table 2. Karakteristikat kryesore të vendburimit Kuçovë – Arrëz.⁸

⁶ Albpetrol. Vendburimet neogjenike. Albpetrol. <https://albpetrol.al/vendburimet-neogjenike/>

⁷ Po aty.

⁸ Albpetrol. Vendburimet neogjenike. Albpetrol. <https://albpetrol.al/vendburimet-neogjenike/>

2.1.2 Vendburimet Gëlqerore

A. VENDBURIMI GORISHT – KOCUL

Ky vendburim ndodhet rreth 20 km në lindje të qytetit të Vlorës. Vendburimi i Gorisht – Koculit u zbulua në vitin 1965. Distancat midis puseve në zonën qendrore të vendburimit janë reduktuar nga 150-200 m në rreth 100 m.⁹

KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË REZERVUARIT	
Formacioni	Gëlqerorë
Rezervat gjeologjike (ton)	30 500 000
Rezervat fillestar të nxjerrshme (ton)	14 674 087
Prodhimi i naftës (ton) deri më 01.01.2023	12 228 617.537
Rezervat e nxjerrshme të mbetura (ton) deri më 01.01.2023	2 245 469.5
Tipi i fluidit	Naftë
Tipi i naftës	Asfaltik – aromatik
Densiteti (⁰ API)	13 - 23
Viskoziteti 20 ⁰ C(Cp)	2000
Presioni fillestar i rezervuarit (atm)	120
Përmbajtja e Squfurit (%)	3.16 - 6.3
Temperatura (⁰ C)	32 - 38
Përshkushmëria e gëlqerorëve (MD)	300
Kripshmëria e ujrave të gëlqerorëve të rezervuarit (mg/l)	28 000 - 58 000
Trashësia e përgjithshme e rezervuarit (m)	350 - 450

Table 3. Karakteristikat kryesore të vendburimit Gorisht-Kocul.¹⁰

B. VENDBURIMI ÇAKRAN – MOLLAJ

Ky vendburim ndodhet 6 km në perëndim të qytetit të Ballshit. Vendburimi i gazkondesatit Çakran – Mollaj u zbulua në vitin 1977. Struktura e saj është një brahiantiklinal që shtrihet në drejtimin juglindje-veriperëndim. Distancat fillestare të puseve ishin 600 m, por rrjeti aktual i puseve është më i dendur dhe distanca aktuale ndërmjet puseve është 300 m.¹¹

KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË REZERVUARIT	
Formacioni	Gëlqerorë
Rezervat gjeologjike (ton)	16 127 983
Rezervat fillestar të nxjerrshme (ton)	8 144 469
Prodhimi i naftës (ton) deri më 01.01.2023	4 371 991.1
Rezervat e nxjerrshme të mbetura (ton) deri më 01.01.2023	3772 477.9
Tipi i fluidit	Naftë

⁹ Albpetrol. Vendburimet gëlqerore. Albpetrol. <https://albpetro.al/vendburimet-gelqerore/>

¹⁰ Albpetrol. Vendburimet gëlqerore. Albpetrol. <https://albpetro.al/vendburimet-gelqerore/>

¹¹ Po aty.

Tipi i naftës	Gjysëm aromatike deri parafinike
Densiteti ($^{\circ}$ API)	11.5 - 37
Viskoziteti 20 $^{\circ}$ C(Cp)	10-30
Presioni fillestar i rezervuarit (atm)	368
Përmbajtja e Squfurit (%)	3.16 - 6.3
Temperatura ($^{\circ}$ C)	68
Përshkushmëria e gëlqerorëve (MD)	2 - 600
Kripshmëria e ujrave të gëlqerorëve të rezervuarit (mg/l)	30 000 - 50 000
Trashësia e përgjithshme e rezervuarit (m)	400 - 800

Table 4. Karakteristikat kryesore të vendburimit Cakran-Mollaj.¹²

C. VENDBURIMI I AMONICËS

Ky vendburim ndodhet 30 km në lindje të qytetit të Vlorës. Vendburimi i Amonicës është zbuluar në vitin 1980. Ky vendburim ndodhet në vargun Selenicë – Amantia të brezit të Kurveleshit.

KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË REZERVUARIT	
Formacioni	Gëlqerorë
Rezervat gjeologjike (ton)	2 835 849
Rezervat fillestare të nxjerrshme (ton)	1 503 000
Nafta e nxjerrë (ton) deri më 01.01.2023	737 257.0
Rezervat e nxjerrshme të mbetura (ton) deri më 01.01.2023	765 725.0
Tipi i fluidit	Naftë
Tipi i naftës	Asfalto aromatike – gjysëm aromatike
Densiteti ($^{\circ}$ API)	14.5 – 22
Viskoziteti 20 $^{\circ}$ C(Cp)	150 – 2300
Presioni fillestar i rezervuarit (atm)	241
Përmbajtja e Squfurit (%)	4
Temperatura ($^{\circ}$ C)	35 - 52
Përshkushmëria e gëlqerorëve (MD)	20 - 150
Kripshmëria e ujrave të gëlqerorëve të rezervuarit (mg/l)	10 000 - 45 000
Trashësia e përgjithshme e rezervuarit (m)	deri më 200

Table 5. Karakteristikat kryesore të vendburimit të Amonicës.¹³

D. VENDBURIMI GORISHT

Gorishti është një nga vendburimet e naftës në vend i trajtuar si një zonë e përbashkët Gorisht -Kocul të mbivendosur njëri me tjetrin. Vendburimi ka gjithsej 284 puse vertikale në inventar, prej të cilëve 142 puse janë aktiv për naftë e gaz. Thellësia e puseve është nga 700 m – 1500 m. Nafta e prodhuar është relativisht e rëndë me një peshë specifike prej 0.965 gr/cm³. Prodhimi në këtë rajon ka variuar nga viti 1962 në vit ku konkretisht në vitin 2024 ishte 11.6 mijë ton naftë

¹² Albpetrol. Vendburimet gëlqerore. Albpetrol. <https://albpetrol.al/vendburimet-gelqerore/>

¹³ Albpetrol. Vendburimet gëlqerore. Albpetrol. <https://albpetrol.al/vendburimet-gelqerore/>

E. VENDBURIMI BALLSH-HEKAL

Vendburimi Ballsh-Hekal është pjesë e vargut Kremenarë-Patos-Verbas të brezit të Kurveleshit dhe i përket moshës Kretak-Paleogen. Ky vendburim ka kapelë gazore me kontakt fillestar gaz-naftë në thellësinë 730m. Puset e shpuara në kapelën gazore e kanë të ulur kezingun disa metra poshtë kontaktit gaz-naftë. Rezervuari është i tipit masive kulmor, me ujëra fundorë aktivë. Karakteristikat kryesore të rezervuarit janë si më poshtë vijon:

FORMACIONI	GËLQERORË
Rezervat Gjeologjike (ton)	19,269,224
Koeficienti i rikuperimit	33%
Rezervat fillestare të naftëshme (ton)	6,359,844
Nafta e nxjerrë (ton) deri më 01.01.2018	5,153,222
Rezervat e naftëshme të mbetura (ton) deri më 01.01.2018	1,206,622
Tipi i fluidit	Naftë
Tipi i naftës	Asfaltik-aromatik
Densiteti (°API)	8 – 17
Viskoziteti 200°C (cP)	2000
Presioni fillestar i rezervuarit (atm)	133
Përmbajtja e Sqfurit (%)	5.7 – 6.4
Temperatura (°C)	41
Përshkueshmëria e gelqerorëve (MDI)	40 – 300
Kripshmëria e ujërave të gelqerorëve të rezervuarit (mg/l)	15,000 – 35,000
Trashësia e përgjithshme e rezervuarit (m)	350

Table 6. Karakteristikat kryesore të vendburimit Ballsh-Hekal.¹⁴

“Albpetrol” SH.A në më shumë se 100 vjet eksperiencë në nxjerrjen e naftës dhe gazit, aktualisht prodhon naftë nga 2 vendburime ranore dhe 4 vendburime gëlqerore. Sot zhvillon aktivitetin e nxjerrjes së naftës në vendburimet Kuçovë, pjesën Jugore të vendburimit Patos-Marinëz, Cakran-Mollaj, Gorisht-Kocul Amonicë dhe Karbunarë.




Table 7. Prodhimi i naftës ndër vite Albpetrol.¹⁵

¹⁴ Anio.al. Vendburimi Ballesh – Hekal. Anio.al. <https://anio.al/prodhimi-nder-vite/>

¹⁵ Albpetrol. Prodhimi i naftës ndër vite. <https://albpetrol.al/prodhimi-i-naftes-nder-vite/>

2.2 Vendburimet kryesore të naftës dhe prodhimet e tyre ndër vite në Shqipëri

A. VENDBURIMI KUÇOVË

Kuçova është një vendburim ranor naftë, i cili është shfrytëzuar me puse vertikale relativisht të cekët (jo më shumë se 1,000 m të thellë afërsisht), të cilët, duke patur energji të ulët të shtresës, prodhojnë me debitë shumë të ulëta (të rendit 50 – 200 litra naftë në ditë). Pjesa nën administrimin e shoqërisë “Albpetrol” SH.A numëron gjithsej 1.613 puse në inventar, ndër të cilët 100 janë puse të fondit të ndalur.




Table 8. Prodhimi i naftës ndër vite në vendburimin e Kuçovës.¹⁶

Duke qenë ngushtësisht të lidhur me mbarrëvajtjen e operacioneve hidrokarbure, numri i puseve aktiv është gjithmonë subjekt i ndryshimeve. Mesatarisht shoqëria “Albpetrol” SH.A numëron rreth 950 puse në punë në këtë zonë.

B. VENDBURIMI PATOS

Vendburimi i Patosit është ranor dhe aktualisht shoqëria “Albpetrol” SH.A administron një pjesë të vogël të vendburimit Patos – Marinzës. Ky vendburim shfrytëzohet me puse vertikale relativisht të cekët, të cilët nuk e kalojnë zakonisht thellësinë totale prej 1,200 m.

Pjesa nën administrimin e shoqërisë “Albpetrol” SH.A numëron gjithsej 888 puse në inventar, prej të cilave 307 janë në ruajtje, pra, që nuk mund të kthehen më në prodhim. Janë rreth 22 puse të cilët mbahen si puse aktiv sot. Rreth 542 puse janë pjesë e fondit të ndalur dhe paraqesin vështirësi shumë të mëdha për t’u venë në punë.




Table 9. Prodhimi i naftës ndër vite në vendurimin e Patosit¹⁷

¹⁶ Albpetrol. Vendburimet. Albpetrol. <https://albpetrol.al/vendburimet/>

C. VENDBURIMI ÇAKRAN – MOLLAJ

Ky vendburim është një rezervuar gëlqeror karbonatik me presione mbi normale. Është zbuluar në vitin 1977 dhe shfrytëzohet me puse vertikale mjaft të thellë, të cilët arrijnë deri në 3,800 m thellësi totale. Gjithsej janë 63 puse në inventarin e këtij sektori, ndër të cilët 32 janë puse aktive për naftë e gaz. Pjesa tjetër e puseve kërkojnë remonte dhe investime serioze për t'u kthyer në pune. Nafta e këtij vendburimi krahasuar me atë të vendburimeve të tjera në Shqipëri klasifikohet si e lehtë me një peshë specifike prej rreth 0.9 gr/cm³.




Table 10. *Prodhiimi i naftës ndër vite në vendurimin Çakran-Mollaj.*¹⁸

D. VENDBURIMI GORISHT – KOCUL

Gorisht – Koculi është një vendburim naftë karbonatik i përbërë prej dy antiklinaleve që mbivendosen me njëri – tjetrin, ai i Gorishtit dhe i Koculit. Vendburimi ka gjithsej 284 puse vertikale në inventar, prej të cilëve 142 puse janë aktiv për naftë e gaz. Thellësia e puseve është nga 700 m – 1500 m. Nafta e prodhuar është relativisht e rëndë me një peshë specifike prej 0.965 gr/cm³.




Table 11. *Prodhiimi i naftës ndër vite në vendurimin Gorisht - Kocul.*¹⁹

E. VENDBURIMI I AMONICËS

Nga ana gjeologjike ky është një vendburim naftë karbonatik dhe bën pjesë në vargun antiklinal Amonicë-Kocul-Selenicë, i cili ka shtrirje gati meridionale duke zënë pjesën jugore të vargut strukturor naftëmbajtës aktual. Aktualisht ka 59 puse në inventar nga të cilët vetëm 23 puse janë aktiv për naftë e

¹⁷ Albpetrol. Vendburimet. Albpetrol. <https://albp petrol.al/vendburimet/>

¹⁸ Albpetrol. Vendburimet. Albpetrol. <https://albp petrol.al/vendburimet/>

¹⁹ Albpetrol. Vendburimet. Albpetrol. <https://albp petrol.al/vendburimet/>

gaz. Thellësia e puseve shkon deri në 3,000 m. Nafta e prodhuar është relativisht e lehtë me një peshë specifike prej rreth 0.9 gr/cm³.




Table 12. *Prodhim i naftës ndër vite në vendburimin e Amonicës.*²⁰

F. VENDBURIMI I BALLSH-HEKALIT

Vendburimi i Ballsh-Hekalit është vënë në shfrytëzim në vitin 1967, duke arritur një prodhim vjetor prej 13.410 ton naftë. Vitet e para të shfrytëzimit të këtij vendburimi kanë qenë shumë produktive, ku sasia më e lartë e prodhuar ndonjëherë është arritur në vitin 1972 me 383,010 ton naftë në vit. Vendburimi Ballsh-Hekal ndodhet 29 km në juglindje të qytetit të Fierit, në strukturën antiklinale të Ballshit. Rezervuari i Ballsh-Hekalit është një rezervuar karbonatik, rreth 1,000m i thellë, i cili përmban naftë relativisht të rëndë me një peshë specifike prej 0.97 gr/cm³. Vendburimi është i ndarë në dy seksione nga një kreshtë; më i vogli seksioni i Hekalit, është një rezervuar me kapele gazore që duket sikur ka mungesë uji, gjë të cilën e ka seksioni më i madh, ai i Ballshit.

Rezervuari u zbulua në Prill të 1966 dhe prodhimi filloi në 1967. Rezervuari pati kulmin e prodhimit prej 383,010 ton (376,000m³, 2,400,000 bbl) naftë në vitin 1972 (~ 6,500 bopd) dhe ra në mënyrë të ndjeshme, pavarësisht nga aktiviteti i disa shpimeve në rritje, të cilat zvogëluan hapësirën e puseve në më pak se 200m (10 acre). Studimet dhe testimet e kryera së fundmi tregojnë se rezervuari i Ballshit ka potencial për t'u kthyer përsëri në një prodhues i rëndësishëm i naftës në Shqipëri. Në inventarin e këtij vendburimi ndodhen 206 puse, nga të cilët rreth 120 konsiderohen si puse aktive. Vendburimi Ballsh-Hekal ndodhet i pozicionuar në kufi me vendburimin e Shpiragut, i cili menaxhohet nga kompania Shell.

Në pranverë të vitit 2019 Shell njoftoi zbulimin e një sasie të konsiderueshme naftë në këtë vendburim, duke rritur potencialin e rezervave të naftës në zonë. Ky është edhe zbulimi i parë i një vendburimi të ri të naftës në 30 vitet e fundit në Shqipëri.

²⁰ Albpetrol. *Vendburimet*. Albpetrol. <https://albpetrol.al/vendburimet/>




Table 13. Prodhiimi për çdo 3-mujor në vendburimin e Ballsh-Hekal në periudhën 2015-2025.²¹




Table 14. Prodhiimi gjatë viteve 1992-2025 në vendburimin Ballsh-Hekal.²²

²¹ Anio.al. Prodhiimi ndër vite. Anio.al. <https://anio.al/prodhiimi-nder-vite/>

²² Anio.al. Prodhiimi ndër vite. Anio.al. <https://anio.al/prodhiimi-nder-vite/>




Table 15. Prodhiimi gjatë viteve 1967-2025 në vendburimin Ballsh-Hekal.²³

2.3 Kapaciteti i Prodhitimit. Kërkimi dhe Eksplorimi i Rezervave Hidrokarbure në Shqipëri (2014–2024)

Kapaciteti i prodhimit në tërë vendin mbështetet në masë të madhe te fusha Patos Marinzë, që përbën rreth 88 % të prodhimit kombëtar bruto. Në vitin 2014, prodhimi kulmoi me afër 20,000 barelë për ditë (bpd) në Patos Marinzë. Nëse flasim për prodhimin në vendin e naftës për vitin 2023 ka patur një prodhim 642.04 ktone me një ulje krahasuar me vitin 2022 prej 15.36 ktone ose 2% si pasojë e problematikave të tregjeve të shitjes. Në vitin 2023 nafta brutë nga marreveshjet hidrokarbure ishte 572.243 ktone, ku shitjet brenda vendit kanë qenë 150.353 ktone dhe eksportet 515.792 ktone.




Figure 2. Grafiku. Ecuria e prodhimit, importit dhe eksportit të produkteve të naftës (ktone) ndër vite.²⁴

²³ Anio.al. Prodhiimi ndër vite. Anio.al. <https://anio.al/prodhiimi-nder-vite/>

²⁴ Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Divizioni Teknik, & Drejtoria e Energjisë së Rinovueshme. (2024). Hartimi i bilancit energjetik bazuar në përpunimin e informacionit sipas standardeve dhe rregulloreve të statistikës së energjisë të BE-së: Bilanci energjetik 2023., Pg. 23. <http://www.akbn.gov.al/ep-content/uploads/2014/06/Bilanci-Komb%C3%ABtar-i-Energjis%C3%AB-2023.pdf>

Për vitin 2023 sasia e naftës brut për rafinim ka qenë 172.40 ktoe duke patur një ritje krahasuar me vitin 2022 prej 55.77 ktoe. Kjo ritje e sasisë së rafinimit ka ardhur si rezultat i ritjes së kërkesës të produkteve të naftës nga tregu i huaj.




Figure 3. Grafiku. Ecuria e përpunimit të naftës bruto (ktoe).²⁵

Importi i produkteve të naftës për vitin 2023 arrin vlerën 1181.679 ktoe me një ulje prej 24 ktoe krahasuar me vitin 2022. Produktet si gazoili, benzina, nafta e avioneve dhe gazi i lëngëshëm i naftës vazhdojnë të dominojnë në importin e produkteve të naftës.



Figure 4. Grafiku. Ecuria e Import, Eksportit të produkteve të naftës, (ktoe).²⁶

²⁵ Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Divizioni Teknik, & Drejtoria e Energjisë së Rinovueshme. (2024). *Hartimi i bilancit energjetik bazuar në përpunimin e informacionit sipas standardeve dhe rregulloreve të statistikës së energjisë të BE-së: Bilanci energjetik 2023*. Pg.23. <http://www.akbn.gov.al/ep-content/uploads/2014/06/Bilanci-Komb%C3%ABtar-i-Energjis%C3%AB-2023.pdf>

²⁶ Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Divizioni Teknik, & Drejtoria e Energjisë së Rinovueshme. (2024). *Hartimi i bilancit energjetik bazuar në përpunimin e informacionit*

Eksporti i naftës dhe i nënprodukteve të saj për vitin 2023 për naftën brut ishte 592.92 ktoe dhe krahasuar me vitin 2022 kemi një ritje prej 7.63 ktoe si pasojë e kërkesës nga tregu për bitum.

Prodhimi i gazit në vendin tonë për vitin 2023 ka qenë në total gaz shoqërues i naftës, rreth 48.49 milion Nm³, sasi gati e papërfillshme dhe që shërben vetëm për proceset teknologjike të industrisë së naftës. Është e kuptueshme se lidhja e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit do të ketë një ndikim pozitiv në përmirësimin e situatës energjetike në vend, duke ndikuar në mënyrë të ndjeshme në raportet e përdorimit të energjive ku deri më sot ngarkesa kryesore i takon nënprodukteve të naftës dhe energjisë elektrike.




Figure 5. Grafiku. Prodhiimi i Gazit (ktoe) ndër vite.²⁷

Në periudhën 2014–2024, Shqipëria ka shfaqur potencial të papërdorur në fushën e kërkimit dhe eksplorimit të rezervave hidrokarbure, veçanërisht në blloqet onshore të pashfrytëzuara dhe në segmentin offshore, i cili mbetet praktikisht i paprekur.

Sipas të dhënave nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), gjatë kësaj periudhe janë shpallur disa raunde për dhënien me kontratë të zonave të kërkimit, përfshirë blloqet onshore 'C', 'Panaja', 'Velça' dhe 'Dumre'.

Duhet theksuar se Shqipëria mban disa zona me potencial ende të paeksploruar në mënyrë të plotë, siç janë blloqet pranë Dumresë dhe Maliqit, si dhe segmenti detar në zonën Jonike. Studimet gjeologjike historike sugjerojnë praninë e strukturave të mundshme me depozitime naftëmbajtëse. Për të zhvilluar këto potenciale, kërkohet një reformë thelbësore në politikat e ofertës, dixhitalizimi i të dhënave ekzistuese, dhe ofrimi i paketave tërheqëse për investitorët ndërkombëtarë.

AKBN ka filluar një proces të dixhitalizimit të të dhënave në bashkëpunim me donatorë ndërkombëtarë, i cili pritet të mundësojë akses më të lehtë për investitorët dhe studiuesit. Së bashku me krijimin e një platforme të hapur për aplikim dhe publikim të kontratave, ky zhvillim mund të japë frytet e para në fund të dekadës.

sipas standardeve dhe rregulloreve të statistikës së energjisë të BE-së: Bilanci energjetik 2023.Pg. 24. <http://www.akbn.gov.al/ep-content/uploads/2014/06/Bilanci-Komb%C3%ABtar-i-Energjis%C3%AB-2023.pdf>

²⁷ Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Divizioni Teknik, & Drejtoria e Energjisë së Rinovueshme. (2024). Hartimi i bilancit energjetik bazuar në përpunimin e informacionit sipas standardeve dhe rregulloreve të statistikës së energjisë të BE-së: Bilanci energjetik 2023.Pg. 24. <http://www.akbn.gov.al/wp-content/uploads/2014/06/Bilanci-Komb%C3%ABtar-i-Energjis%C3%AB-2023.pdf>

Në përfundim, kërkimi dhe eksplorimi në Shqipëri ka potencial për rritje, por kërkon reformë strukturore, rritje të transparencës dhe harmonizim me praktikën më të mira ndërkombëtare për të ndikuar në tërheqjen e kapitalit dhe ekspertizës së nevojshme për zhvillim.

2.4 Projekti TAP (Trans Adriatic Pipeline)

Shqipëria do të sigurojë një lidhje kyçe dhe do të ketë rol konkret institucional në plotësimin e nyjave energjetike që lidhin Italinë, Evropën Qendrore dhe shtetet e Ballkanit. Vizioni i qeverisë shqiptare është nxitja e zhvillimit ekonomik, duke shërbyer si korridor i tranzitit të energjisë për energjinë elektrike, gazin natyror dhe naftën në të gjitha format e tij, për të kaluar në pjesën më të madhe të Evropës nga deti dhe nëpërmjet tubacionit tokësor të naftës. Vendndodhja e saj gjeografike e vendos Shqipërinë në pozicionin e ndarjes së burimeve të sapopërfutuara të energjisë me ato të fqinjëve të saj në Evropën Juglindore nëpërmjet zhvillimit të rrjeteve të qarkullimit të energjisë për të forcuar sigurinë rajonale të energjisë së vendeve fqinje, si dhe sigurinë e vet.

Gazsjellësi TAP do të jetë funksional në pak vite, çka e bën thelbësore fuqizimin e potencialit të eksplorimit dhe prodhimit të naftës dhe gazit në Shqipëri dhe në det të hapur, hartimin e një plani strategjik të integruar për të gjithë nënsektorin ekonomik të naftës dhe gazit. Në këto kushte natyreshmë një strategji kombëtare për sektorin e naftës dhe gazit përfshin:

- a) Krijimin e një standardi bazë që përcakton në mënyrë të përshtatshme vendin aktual të Shqipërisë në zhvillimin e sektorit të naftës dhe gazit në rajon;
- b) Përcaktimin e një sërë objektivash zhvillimi që duhet të arrihen kundrejt vitit 2030;
- c) Krijimin e planeve të detajuara për zbatimin e secilit komponent të planit strategjik;
- d) Politika dhe institucione të aftë për elementet e administrimit teknik, ligjor, rregullator dhe pajtueshmërisë rregullatore që kërkohet për të administruar dhe menaxhuar në mënyrë efikase zhvillimin ekonomik të burimeve kombëtare të naftës. Pjesa më e madhe e këtyre elementëve tashmë është realizuar, por është e nevojshme të organizohet dhe të vendoset në formën e një plani.

Deri tani ka pasur hapa të qartë në këtë drejtim brenda sektorit të hidrokarbureve në Shqipëri, pasi për sa i përket sektorit të gazit është miratuar masterplani i zhvillimit të gazifikimit në Shqipëri (miratuar me VKM-në nr. 84, datë 14.2.2018), gjë e cila në periudhën në vazhdim duhet harmonizuar dhe integruar edhe me sektorin e naftës.²⁸

Deri në fund të vitit 2023, TAP-i ka finalizuar konceptet për zbatimin e produktit Brenda Ditës në TAP, pas bashkërendimit me Autoritetet Rregullatore, si një mjet fleksibiliteti ofruar për transportuesit dhe OST-të fqinje në Greqi, Itali dhe Bullgari. Operacional Vjetor për vitin 2024, TAP-i do ta informojë EREN për statusin e zbatimit të produktit të ri. Kështu, deri në fund të vitit 2023, TAP-i ka transportuar gjithsej 29.37 bcma nga kufiri grekoturk në Kipoi, ku 25.9 bcma janë transportuar deri në Itali duke kaluar përmes Shqipërisë dhe afërsisht 2.87 bcma që kanë dalë drejt Greqisë dhe 1.73 bcma drejt Bullgarisë, sikurse tregohet më poshtë:

²⁸ Këshilli i Ministrave. (2018). *Vendim nr. 480, datë 31.07.2018; Për miratimin e strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018-2030 – Shqipëria 2030*. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Marrë nga , <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2024/09/vendim-2018-07-31-480.pdf>, Faqe 33.

Nga COD (15/11/20) deri më 31 dhjetor 2023	Gjithsej KWh	Gjithsej Nm3	Gjithsej BCMA
Pika hyrëse e TAP (Kipoi)	344,746,893,269	29,372,582,610	29.37
Pika dalje e TAP (Nea Mesimvria - Greqi)	33,651,439,365	2,868,977,401	2.87
Pika dalje e TAP (Komotini – IGB)	20,294,983,310	1,730,946,066	1.73
Pika dalje e TAP (Melendugno-Itali) duke kaluar transit përmes Shqipërisë	287,673,713,593	24,540,814,317	25.90




Figure 6. Zgjerimi i kapacitetit të projektit TAP.²⁹

Në varësi të nivelit të zgjerimit për të cilin janë pranuar ofertat deri më 22 janar 2023, kapaciteti i zgjerimit mund të jetë i disponueshëm si më poshtë:

1. Niveli 1 - Projekti minimal i zgjerimit 39,8 MSm3/ditë (387 GËh/ditë) – Dhjetor 2025.
2. Niveli 2 - Projekti i Zgjerimit të Kufizuar TAP 45,3 MSm3/ditë (440 GËh/ditë) – Dhjetor 2026.
3. Projekti i Zgjerimit të Pjesëshëm të Nivelit 3 – 52,7 MSm3/ditë (512 GËh/ditë) Dhjetor 2027
4. Projekti i zgjerimit të plotë të nivelit 4 – 62,6 MSm3/ditë (608 GËh/ditë) Dhjetor 2027.

2.5 Rafineritë

Për vitin 2023 rafineritë kanë punuar në mënyrë periodike, duke përpunuar rreth 172.04 ktqe kryesisht dy rafineri Fieri dhe Elbasani, me një humbje teknologjike 0.6%. Sektori i rafinimit të naftës bruto vazhdon të përballët me vështirësi serioze, si pasojë e problemeve ekonomike të shoqërisë që administron këtë sektor. Vlen të theksojmë se rafineritë tona kanë probleme serioze në kontrollin e ndotjeve mjedisore, për shkak të mungesës së investimeve në këtë sektor pasi teknologjia e përdorur është e vjetër dhe e amortizuar;

- Për vitin 2022 - rafineritë kanë punuar në mënyrë periodike, duke përpunuar rreth 116.54 ktqe kryesisht dy rafineri Fieri dhe Elbasani, me një humbje teknologjike 0.6%
- Për vitin 2021 - rafineritë kanë punuar në mënyrë periodike, duke përpunuar rreth 164.59 ktqe kryesisht dy rafineri Fieri dhe Elbasani, me një humbje teknologjike 0.4%.
- Për vitin 2020 - rafineritë kanë punuar në mënyrë periodike, duke përpunuar rreth 134.37 ktqe ku 85% të saj e ka përpunuar rafineria e Ballshit me një humbjet teknologjike 0.4%.
- Për vitin 2018 - rafinerite kane punuar ne menyre periodike, duke përpunuar rreth 335.27 ktqe ku 85% te saj e ka përpunuar rafineria e Ballshit me nje humbjet teknologjike 0.4%

²⁹ Trans Adriatic Pipeline. <https://www.tap-ag.com/infrastructure-operation/tap-route-and-infrastructure>




Figure 7. Grafik. Sasinë e përpunuar të naftës në ktoe për çdo vit (shtyllat blu) dhe Humbjen teknologjike në përqindje përkatëse (vija e kuqe).³⁰

3. VLERËSIMI EKONOMIK

3.1 Klima e investimeve

A. TENDENCAT E SHPENZIMEVE PËR MATERIALE DHE FURNITURA NË SEKTORIN E NAFTËS (2014–2023)

Shpenzimet për materiale dhe furnitura përbëjnë një komponent të rëndësishëm të kostove operative në sektorin e naftës, duke reflektuar nivelin e aktivitetit ekonomik dhe ritmin e operacioneve. Gjatë periudhës 2014–2017, këto shpenzime kanë qenë relativisht të qëndrueshme, duke lëvizur nga 19,677 milionë lekë në vitin 2014 në 18,159 milionë lekë në vitin 2017. Viti 2015 shënoi nivelin më të lartë në këtë periudhë me 21,179 milionë lekë, në përputhje me një vit investimesh të larta.

Në vitet 2018 dhe 2019, vërehet një rënie e moderuar në 14,502 dhe 14,403 milionë lekë përkatësisht, duke sinjalizuar një orientim drejt rristurimit dhe menaxhimit më të kujdesshëm të kostove. Në vitin 2020, si pasojë e ndikimit të pandemisë COVID-19, shpenzimet ranë më tej në 13,167 milionë lekë, ndërsa në 2021 u ulën në 12,231 milionë lekë – niveli më i ulët i dekadës. Viti 2022 shënoi një rikuperim të ndjeshëm me 26,775 milionë lekë, ndërkohë që në vitin 2023 shpenzimet u reduktuan sërish në 18,978 milionë lekë, duke reflektuar stabilizimin pas rritjes së mprehtë post-pandemike dhe një rikthim në një ritëm më të moderuar të operacioneve.

³⁰ Grafik. Sasinë e përpunuar të naftës në ktoe për çdo vit (shtyllat blu) dhe Humbjen teknologjike në përqindje përkatëse (vija e kuqe), bazuar në të dhënat e publikuara të EITIT ndër vite dhe INSTAT.




Figure 8. Shpenzime për materiale dhe furnitura në sektorin e naftës (2014-2023) sipas të dhënave të marra nga INSTAT.

B. ANALIZA E SHPENZIMEVE GJITHSEJ NË SEKTORIN E NAFTËS (2014–2023)

Gjatë periudhës 2014–2023, shpenzimet totale në sektorin e naftës kanë reflektuar ritmet e aktivitetit ekonomik dhe intensitetin operativ të industrisë, duke përfshirë kostot për materiale dhe furnitura, mirëmbajtje, administratë, paga dhe shpenzime të tjera mbështetëse. Vlera më e lartë u regjistrua në vitin 2015 me 50,721 milionë lekë, në vijim të një rritjeje të konsiderueshme krahasuar me 2014-n (45,315 milionë lekë). Gjatë periudhës 2016–2018, shpenzimet qëndruan në nivele relativisht të stabilizuara, nga 32,270 deri në 38,964 milionë lekë. Ndikimi i pandemisë COVID-19 u reflektua ndjeshëm në vitet 2020 dhe 2021, ku shpenzimet zbritën në nivelet më të ulëta të dekadës (respektivisht 26,672 dhe 27,078 milionë lekë), për shkak të kufizimeve të aktivitetit në terren dhe pasigurive operationale. Në vitin 2022 u shënua një rikuperim i dukshëm me 43,712 milionë lekë, ndjekur nga një rënie në 31,892 milionë lekë në vitin 2023. Këto zhvillime pasqyrojnë hyrjen në një fazë të re të menaxhimit më të kujdesshëm të shpenzimeve, të diktuar jo vetëm nga kërkesa për efikasitet, por edhe nga nevoja për të përballuar një realitet të ri tregtar dhe ekonomik, ku pasiguritë globale, si ajo e shkaktuar nga pandemia, mbeten faktorë të rëndësishëm ndikues.




Figure 9. Shpenzime për materiale dhe furnitura në sektorin e naftës (2014-2023) sipas të dhënave të marra nga INSTAT.

C. ANALIZA E INVESTIMEVE GJITHSEJ NË SEKTORIN E NAFTËS (2014–2023)

Gjatë periudhës 2014–2023, investimet në sektorin e naftës kanë reflektuar dinamizmin dhe sfidat e dekadës së fundit. Ato nisën me një nivel të lartë në vitin 2014 (35,676 milionë lekë) dhe, pas luhatjeve të moderuara, u rigjallëruan në 2017 (29,103 milionë lekë). Nga 2018 e në vijim, investimet kanë shënuar rënie, duke arritur minimumin në 2021 me 1,413 milionë lekë, një reflektim i drejtpërdrejtë i pasigurive ndërkombëtare, krizës së çmimeve të naftës dhe ndikimeve të pandemisë globale. Megjithatë, dy vitet e fundit tregojnë një rikuperim të kujdesshëm, me investime që arrijnë 2,845 milionë lekë në vitin 2023. Kjo tendencë sugjeron një potencial të vazhdueshëm për rimëkëmbje, nëse mbështetet nga politika më të qarta, stimuj të qëndrueshëm dhe një klimë e besueshme investimi.




Figure 10. Shpenzime për investime gjithsej në sektorin e naftës (2014–2023) sipas të dhënave të marra nga INSTAT.

Në vijim të trajtimit teorik të mësipërme, paraqitja e të dhënave në formë tabelare dhe grafike e të tre seksioneve të trajtuara më sipër e cila synon konkretizimin empirik të analizës së kryer. Kjo mënyrë e prezantimit shërben për të ilustruar më qartë dhe në mënyrë të strukturuar ecurinë e treguesve ekonomikë në sektorin e naftës gjatë periudhës 2014–2023, duke lehtësuar interpretimin e mësipërm.




Figure 11. Ecuria e shpenzimeve dhe investimeve në sektorin e naftës në Shqipëri sipas të dhënave të INSTAT (2014–2024).

Viti	Shpenzime për materiale dhe furniture (milionë lekë)	Shpenzime gjithsej (milionë lekë)	Investime gjithsej (milionë lekë)
2023	18,978	31,892	2,845
2022	26,775	43,712	2,077
2021	12,231	27,078	1,413
2020	13,167	26,672	3,103
2019	14,403	29,437	14,336
2018	14,502	32,270	11,529
2017	18,159	35,820	29,103
2016	18,100	38,964	3,235
2015	21,179	50,721	21,800
2014	19,677	45,315	35,676

Table 16. Vlerat e shpenzime dhe investimeve të realizuara nga kompanitë në sektorin e naftës në Shqipëri sipas të dhënave të INSTAT (2014-2024).

3.2 Analizë Kontabël mbi Kontributin Ekonomik të Aktiviteteve Kryesore të industrisë nxjerrëse (naftë dhe nënprodukteve të saj) (2014–2024)

Sipas të dhënave kontabël marrë nga INSTAT industria nxjerrëse paraqet një profil të lartë volatiliteti ndër vite, duke reflektuar ndjeshmëri të lartë ndaj faktorëve të jashtëm dhe cikleve ekonomike globale. Kulmi i kontributit pozitiv u regjistrua në vitin 2014, me një vlerë prej +0.68%, ndërsa një vit më pas, në 2015, u evidentua një devijim i rëndësishëm negativ në masën -0.91%, i cili përbën një ndryshim drastik në rendin e 1.59 %, me pasoja të drejtpërdrejta mbi balancat ekonomike të sektorit publik dhe të ardhurat fiskale të lidhura me të.

Në vitin 2020, ndikimi negativ i këtij sektori (-0.62%) përkon me krizën ekonomike globale të shkaktuar nga pandemia COVID-19, duke theksuar karakterin ciklik dhe të ekspozuar të industrisë ndaj goditjeve ndërkombëtare. Për periudhën 2022–2024, vërehet një tendencë regresive e qëndrueshme, me vlera përkatëse -0.09%, -0.31% dhe -0.39%, që sinjalizon një ngadalësim struktural të aktivitetit nxjerrës dhe një potencial të reduktuar për të gjeneruar vlera të qëndrueshme bruto. Nga pikëpamja kontabël, kjo situatë sugjeron rënie të normës së kthimit mbi investimet, amortizim të shpejtë të kapitalit fizik dhe reduktim të efikasitetit të përdorimit të resurseve natyrore. Kjo gjendje krijon hapësirë për rekomandime ndërhyrëse në politikat fiskale, strukturore dhe stimuluese të këtij sektori.

Në analizën kontabël të kontribueshmërisë ekonomike, industria përpunuese dallohet për një nivel të lartë stabiliteti operacional dhe financiar gjatë dekadës në shqyrtim. Nga viti 2014 deri në 2019, kontributi i këtij sektori ka qenë vazhdimisht pozitiv, duke luhatur ndërmjet **+0.28% dhe +0.62%**, duke përfaqësuar një bazë të qëndrueshme fiskale dhe një burim të rregullt të vlerës së shtuar kombëtare. Ky qëndrueshmëri tregon për kapacitete të mirëmenaxhuara prodhuese dhe cikle prodhimi të mirëpërkufizuara, të afta për të absorbuar faktorët makroekonomikë me efikasitet relativ.

Rënia e regjistruar në vitin 2020, me një ndikim prej **-0.25%**, është një reflektim i goditjes sistematike nga pandemia, e cila shkaktoi ndërprerje të zinxhirit të furnizimit dhe ulje të kërkesës së përgjithshme. Megjithatë, rikuperimi në 2021 dhe 2022 është i menjëhershëm dhe i qëndrueshëm (+0.71% dhe +0.43% përkatësisht), duke demonstruar rezistencë strukturore dhe kapacitet të lartë rikuperimi, tipik për sektorët

me diversifikim të burimeve të të ardhurave. Uljet e kontributit në 2023 dhe 2024 nuk sinjalizojnë ndonjë regres të brendshëm të industrisë, por më tepër përfaqëson rregullime ciklike apo faktorë të jashtëm të përkohshëm.

Përpunimi i Koksit dhe Produkteve të Naftës së Rafinuar, paraqet një kontribut kontabël pothuaj neutral, me vlera që lëvizin nga -0.01% deri në +0.02%, dhe një mesatare vjetore afër zeros ($\approx 0.00\%$). Pavarësisht se operon në një sektor me potencial të lartë ekonomik, ky aktivitet nuk ka arritur të prodhojë impakt të matshëm në strukturën makroekonomike të vendit gjatë periudhës së analizuar. Nga pikëpamja kontabël, kjo tregon për mungesë të efektit multiplikues, qarkullim të kufizuar vjetor të kapitalit dhe ndoshta nën-shfrytëzim të kapaciteteve ekzistuese.




Figure 12. Kontributi i naftës dhe nënprodukteve të saj në ekonominë e vendit 2014-2024 sipas të dhënave marrë nga INSTAT.

3.3 Kontributi në PBB dhe Financat Publike (2014–2024)

3.3.1 Kontributi në PBB (2014-2024)

Viti 2014 shënon kulmin e dekadës me 3.99% të PBB-së – një kontribut i lartë që përputhet me ciklin e lartë të çmimeve të lëndëve të para në tregjet ndërkombëtare dhe prurjet e konsiderueshme nga koncesionarët e mëdhenj në sektorin e hidrokarbureve. Megjithatë, në 2015 fillon një rënie e fortë në 2.63%, e ndikuar nga rënia globale e çmimit të naftës dhe ulja e intensitetit të prodhimit.

Periudha 2016-2019 karakterizohet nga një stabilizim relativ, me kontribut të industrisë nxjerrëse në intervalin 1.9–2.1% të PBB-së. Këto shifra tregojnë një maturim të industrisë, me cikle më të ulëta prodhimi dhe një orientim të kujdesshëm të kapitalit në sektor. Duhet theksuar se në këtë periudhë është rritur edhe kontrollat mjedisore dhe fiskale mbi shfrytëzimin e burimeve natyrore.

Gjatë pandemisë COVID-19, ndodhi një turrje e dukshme në aktivitetet nxjerrëse, për shkak të kufizimeve në zinxhirët e furnizimit, mbylljes së përkohshme të disa aktiviteteve nxjerrëse dhe pasigurisë në tregjet ndërkombëtare. Kjo pasqyrohet në uljen e kontributit në PBB në nivelet më të ulëta të dekadës: 1.53% (2020) dhe 1.49% (2021).

Ndërsa në vitin 2022 vihet re një stabilitet i lehtë në kontributin e industrisë nxjerrëse në PBB, në nivelin 1.50%, gjatë viteve pasuese ky tregues pëson një rënie të vazhdueshme, duke zbritur në 1.27% në vitin

2023 dhe në 1.10% sipas projeksioneve për vitin 2024. Kjo tendencë nënvizon zbehjen progresive të rolit të këtij sektori në strukturën e ekonomisë kombëtare.




Figure 13. Kontributi i industrisë nxjerrëse dhe përpunuese (naftë) në PBB (2014-2024) sipas të dhënave të marra nga INSTAT (në përqindje).

Viti	Industria nxjerrëse (%)	Industria përpunuese (%)	Përpunimi i koksit dhe produkteve të naftës së rafinuar (%)
2014	3.99	5.91	0.00
2015	2.63	6.28	0.02
2016	1.98	6.30	0.02
2017	1.93	6.52	0.02
2018	2.01	6.71	0.02
2019	2.12	6.97	0.02
2020	1.53	7.07	0.03
2021	1.49	6.92	0.03
2022	1.50	7.50	0.03
2023	1.27	7.20	0.04
2024	1.10	6.51	0.03

Table 17. Kontributi i industrisë nxjerrëse dhe përpunuese (naftë) në PBB (2014-2024) sipas të dhënave të marra nga INSTAT (në përqindje).

3.3.2 Financat publike

Mbështetur në Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “Albpetrol” SH.A me Nr. 55, datë 04.01.2023 “Mbi miratimin e Programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë “Albpetrol” SH.A për vitin 2023”, buxheti dhe plani financiar është si më poshtë:

Nr	Treguesit kryesor	Njësia	Programi
1	Prodhim naftë (në total)	ton	117,023
2	Prodhim gazit (në total)	000/Nm3	2,932
3	Të ardhura gjithsej	000/lekë	8,263,820
4	Shpenzime gjithsej	000/lekë	7,240,126
5	Numri mesatar i punonjësve	Numër	1,790
6	Paga mesatare/punonjës	lekë/muaj	57,317
7	Fondi i pagave	000/lekë	1,231,160
8	Investime gjithsej	000/lekë	997,470

Table 18. Programi i zhvillimit ekonomik të shoqërisë “Albpetrol” SH.A për vitin 2023.³¹

Mbështetur në Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “Albpetrol” SH.A me Nr. 2155/1, datë 08.03.2024 “Mbi miratimin e Programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë “Albpetrol” SH.A për vitin 2024”, buxheti dhe plani financiar është si më poshtë:

Nr	Treguesit kryesor	Njësia	Programi
1	Prodhim naftë (në total)	ton	112,307.0
2	Prodhim gazit (në total)	000/Nm3	2,383.0
3	Të ardhura gjithsej	000/lekë	6,838,521.0
4	Shpenzime gjithsej	000/lekë	6,664,751.0
5	Numri mesatar i punonjësve	numër	1,532.0
6	Paga mesatare/punonjës	lekë/muaj	90,635.0
7	Fondi i pagave	000/lekë	1,666,329.0
8	INVESTIME GJITHSEJ	000/LEKË	755,543.0

Table 19. Programi i zhvillimit ekonomik të shoqërisë “Albpetrol” SH.A për vitin 2024.³²

Mbështetur në Programin e Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë “Albpetrol” SH.A për vitin 2022, realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve paraqitet në tabelën më poshtë:

NR	TE ARDHURAT	000/lekë
1	Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit (a+b+c+d)	6,955,072
a	Nga shitja e naftes	4,975,673
b	Nga shitja e gazit	4,659
a	Nga shitja e energjise	1,970,602
b	Sherbime te tjera	4,138

³¹ Albpetrol sh.a.. Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara (sipas viteve). <https://www.albpetrol.al/buxheti-plani-i-shpenzimeve-per-vitin-financiar-ne-vijim-dhe-vitet-e-kaluara-sipas-viteve/>

³² Albpetrol sh.a. Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset (sipas viteve). <https://albpetrol.al/raport-vjetor-per-zbatimin-e-buxhetit-dhe-anekset-sipas-viteve/>

2	Investime	33,134
3	Te tjera te veprimtarise se shfrytezimit	76,966
4	Te ardhura nga interesi	6,155
I	TOTALI TE ARDHURA(1+2+3+4)	7,071,327
II	Ndryshimi ne inventarin e produktit dhe prodhimit ne proces	1,415,027
	SHPENZIMET	
1	Materiale te para	2,385,481
2	Personeli	1,532,255
3	Amortizimi	402,196
4	Shpenzime te tjera te veprimtarise se shfrytezimit	3,676,690
	Raporti Drejtimit të Brendshëm – Albpetrol sha 2022	
5	Shpenzime per interesa	3,661
III	TOTALI SHPENZIME (1+2+3+4+5)	8,000,283
IV	Fitimi para tatimit (I+II-III)	486,071
V	Tatim fitimi	469,880
	FITIMI NETO (IV-V)	16,191

Table 20. Programi i Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë “Albpetrol” SH.A për vitin 2022, realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve.³³

Ndikimi i të ardhurave varet jo vetëm nga niveli i prodhimit, por edhe nga çmimi ndërkombëtar i naftës, luhatjet në shpenzimet e raportuara nga kompanitë, si dhe ritmi i mbledhjes së detyrimeve nga strukturat përkatëse fiskale.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është shpërndarja e rentës minerare për bashkitë ku ndodhen aktivitetet hidrokarbure. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, një përqindje e kësaj rente (zakonisht 5%) i kalon pushtetit vendor. Në praktikë, bashkitë si Fier, Kuçovë dhe Vlorë kanë përfituar shuma të konsiderueshme, të cilat janë përdorur për investime në infrastrukturë dhe shërbime publike. Sidoqoftë, raportimet e EITI dhe raportet e auditit kanë ngritur shqetësime mbi transparencën dhe efikasitetin e shpenzimit të këtyre fondeve.

Për më tepër, ka një hendek të dukshëm midis kontributit të kompanive në buxhet dhe përfitimeve të perceptuara nga komunitetet. Kjo ka shtuar presionin mbi institucionet publike për të publikuar më shumë të dhëna të detajuara mbi pagesat dhe përdorimin e fondeve.

Në përfundim, edhe pse pesha e sektorit në PBB është zvogëluar krahasuar me të kaluarën, ai mbetet një burim i rëndësishëm i të ardhurave për shtetin dhe zonat prodhuese. Rritja e transparencës, forcimi i kontrollit fiskal dhe përdorimi efektiv i rentës do të jenë kyçe për maximizimin e përfitimeve ekonomike në të ardhmen.

Mbeshtetur ne Programin e Zhvillimit Ekonomik te shoqerise “Albpetrol” SH.A per vitin perkates, fondi në dispozicion për sponsorizim eshte realizuar sipas te dhenave te tabelës me poshte:

³³ Albpetrol SH.A. Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset (sipas viteve). <https://albpetrol.al/raport-vjetor-per-zbatimin-e-buxhetit-dhe-aneokset-sipas-viteve/>

Nr	VITI	Vlera e sponsorizuar (Lekë)
1	2019	960,000
2	2020	10,000,000
3	2021	—
4	2022	399,000
5	2023	—
5	2024	—

Table 21. Donacione, sponsorizime (sipas viteve).³⁴

Investimi kryesor është te eksplorimi dhe prodhimi i naftës bruto (1,020 M EUR), që përbën rreth 70% të totalit të sektorit. Ndërtimi i rafinerive të reja është i dyti me rëndësi, duke marrë 350 M EUR (~24% të totalit të investimeve). Ndërkohë rehabilitimi i rafinerive ekzistuese (59 M EUR) dhe përmirësimi i infrastrukturës së nënprodukteve (24 M EUR) përbëjnë një pjesë shumë të vogël të totalit (~6% së bashku), që tregon fokus më të madh në zgjerim sesa në mirëmbajtje të infrastrukturës ekzistuese. Fondet nga donatorët janë 530 M EUR, që përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të burimeve të sektorit. Në krahasim me investimet e brendshme (1,453 M EUR), donatorët kontribuojnë rreth 27% të totalit. Nëse përfshihen donatorët, total fondesh për sektorin shkon në 1,983 M EUR. Kjo tregon se sektori i naftës ka një mbështetje të konsiderueshme financiare jo vetëm nga burimet vendase, por edhe nga donatorët ndërkombëtarë.

Kjo tabelë përfaqëson shpërndarjen e fondeve në sektorin e naftës në Shqipëri, duke përfshirë investimet për eksplorim, prodhim, përpunim dhe ndihmat nga donatorët.

AKTIVITETET E SEKTORIT TË NAFTËS	
Eksplorimi dhe prodhimi i naftës bruto	1020
Rehabilitimi i rafinerive në Ballsh dhe Fier	59
Përmirësimet e infrastrukturës së nënprodukteve të naftës	24
Ndërtimi i rafinerive të reja	350
Totali Eksplorim, prodhim, përpunim, rafinim dhe shpërndarjen	1,453
DONATORE	530

Figure 14. Kërkesa totale e investimeve kumulative 2018–2030 në aktivitetet e sektorit të naftës.³⁵

3.4 Pesha relative e sektorit ekonomik të naftës në krijimin e vlerës së shtuar bruto në ekonominë e Shqipërisë

Struktura e vlerës së shtuar bruto (VSB) në ekonominë shqiptare përgjatë periudhës 2014–2024 tregon qartazi një rënie të vazhdueshme të kontributit të industrisë nxjerrëse, e cila dikur përfaqësonte një komponent të rëndësishëm të aktivitetit ekonomik. Në vitin 2014, industria nxjerrëse përbënte rreth 4.66% të VSB-së totale, duke shënuar një nga nivelet më të larta të dekadës. Megjithatë, në vitet pasuese, pesha e saj u tkurr ndjeshëm, për të zbritur në nivelin 1.28% në vitin 2024. Kjo rënie është e qëndrueshme dhe e vazhdueshme, dhe tregon jo thjesht një luhatje ciklike, por një tendencë strukturore drejt dobësimit të rolit të këtij sektori në ekonomi. Nga këndvështrimi kontabilist dhe ekonomik, kjo do të thotë se

³⁴ Albpetrol sh.a. Donacione, sponsorizime (sipas viteve). <https://albpetrol.al/donacione-sponsorizime-sipas-viteve/#>

³⁵ Këshilli i Ministrave. (2018). Vendim nr. 480, datë 31.07.2018; Për miratimin e strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018-2030 – Shqipëria 2030. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Marrë nga , <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2024/09/vendim-2018-07-31-480.pdf>, Faqe 54.

industria nxjerrëse ka humbur gradualisht ndikimin e saj në krijimin e vlerës së shtuar neto, si pasojë e një sërë faktorësh të ndërlidhur.

Së pari, rënia e kontributit në VSB është një tregues i qartë i rënies së volumit të prodhimit bruto në këtë industri, që mund të vijë si rezultat i eksaurimit të rezervave të shfrytëzueshme, mungesës së investimeve në kërkime të reja gjeologjike, si dhe pamundësisë për të përthithur teknologji moderne që rrisin produktivitetin dhe eficiencën. Për më tepër, reduktimi i kapitalit fiks, amortizimi i mjeteve të prodhimit dhe mungesa e rivitalizimit teknologjik ndikojnë drejtpërdrejt në uljen e inputeve që ky sektor kontribuon në llogaritjen e vlerës së shtuar bruto. Nga ana tjetër, kjo ulje sugjeron edhe një zhvendosje të prioriteteve ekonomike dhe fiskale në drejtim të sektorëve më të qëndrueshëm dhe me ndikim më të ulët në mjedis, siç është energjia e rinovueshme apo teknologjia e pastër. Për pasojë, industria nxjerrëse ka humbur gjithashtu pozicionin e saj si një kontribuues kryesor i të ardhurave tatimore për buxhetin e shtetit, sidomos në segmentin e tatimeve mbi fitimin dhe tatimeve indirekte.

Ndryshe nga industria nxjerrëse, industria përpunuese ka përjetuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe progresiv gjatë kësaj periudhe. Nga 6.89% në vitin 2014, pesha e saj në krijimin e VSB-së është rritur në mënyrë graduale, duke kulmuar në 8.70% në vitin 2022, dhe më pas duke rënë lehtësisht në 7.52% në vitin 2024. Ky zhvillim dëshmon për një transformim strukturor të ekonomisë shqiptare, nga një ekonomi e orientuar drejt burimeve natyrore drejt një ekonomie më industriale, e mbështetur në vlerë të shtuar të prodhuar nga transformimi i lëndës së parë. Rritja e peshës së industrisë përpunuese në VSB përkon me rritjen e kapaciteteve teknike dhe teknologjike të kësaj industrie, përmirësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore, si dhe rritjen e nivelit të konkurrueshmërisë së prodhimit vendas në tregje të jashtme. Kjo rritje gjithashtu nënkupton një rritje të efikasitetit operacional, kontroll më të mirë të kostove dhe potencialisht zgjerim të eksporteve të produkteve të përpunuara.

Brenda industrisë përpunuese, nënsektori i përpunimit të koksit dhe produkteve të naftës së rafinuar paraqitet me një kontribut modest, por në rritje të ngadaltë. Në vitin 2014, ky nënsektor nuk shfaqte asnjë peshë të matshme në krijimin e VSB-së (0.00%), ndërsa në vitet pasuese, ai arrin një kontribut simbolik prej 0.03%–0.05%. Edhe pse në dukje të vogla, këto përqindje tregojnë për një rigjallërim të aktivitetit të rafinimit, i cili mund të jetë rezultat i rikthimit në funksion të disa kapaciteteve industriale ose përpjekjeve për të përpunuar një pjesë më të madhe të naftës bruto në vend. Kjo lëvizje ka implikime pozitive për bilancin tregtar dhe për të ardhurat nga akcizat dhe TVSH-ja, nëse kjo tendencë do të mbështetet nga politika të favorshme fiskale dhe investime teknologjike.

Në përmbledhje, pesha relative e sektorit të industrisë nxjerrëse në krijimin e vlerës së shtuar bruto në Shqipëri ka rënë ndjeshëm gjatë dekadës së fundit, duke reflektuar një transformim strukturor të ekonomisë shqiptare. Ky transformim karakterizohet nga zhvendosja e theksit nga sektori i burimeve të papërpunuara drejt sektorëve të përpunimit dhe të prodhimit me vlerë më të lartë të shtuar. Kjo lëvizje është në përputhje me trendet globale të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të ekonomive të bazuara në teknologji dhe inovacion, por në të njëjtën kohë kërkon kujdes të shtuar për të garantuar që tranzicioni të mos sjellë pasojë negative në zonat e varura tradicionalisht nga industria nxjerrëse. Për të maksimizuar përfitimet nga kjo dinamikë, politika ekonomike duhet të fokusohet në nxitjen e përpunimit vendor, diversifikimin industrial dhe krijimin e zinxhirëve të integruar të vlerës që përfshijnë teknologji moderne dhe burime njerëzore të kualifikuara.




Figure 15. Grafik. Pesha relative e sektorit të naftës në vlerën e shtuar bruto (2014-2024) sipas të dhënave të marra nga INSTAT.

Viti	Industria nxjerrëse (%)	Industria përpunuese (%)	Përpunimi i naftës së rafinuar (%)
2014	4.66	6.89	0.00
2015	3.05	7.29	0.03
2016	2.29	7.29	0.03
2017	2.25	7.61	0.03
2018	2.34	7.79	0.03
2019	2.45	8.05	0.03
2020	1.74	8.03	0.03
2021	1.75	8.09	0.03
2022	1.73	8.70	0.03
2023	1.46	8.27	0.05
2024	1.28	7.52	0.04

Table 22. Pesha relative e sektorit të naftës në vlerën e shtuar bruto (2014-2024) sipas të dhënave të marra nga INSTAT.

4. VLERËSIMI MJEDISOR DHE SOCIAL

4.1 VLERESIMI RREGULLATOR DHE I POLITIKAVE

4.1.1 Analizë e kuadrit ligjor rregullator të sektorit të naftës në Shqipëri

Për sektorin e naftës në Shqipëri, ekziston një kuadër i gjerë ligjor dhe nënligjor që rregullon të gjitha fazat e ciklit jetësor të hidrokarbureve, duke filluar nga kërkimi dhe zbulimi, tek prodhimi dhe përpunimi, e deri te transporti dhe tregtimi i tyre. Ky kuadër juridik jo vetëm që përcakton detyrimet dhe të drejtat e

operatorëve ekonomikë në këtë sektor, por gjithashtu ka për qëllim të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm të industrisë, përmes garantimit të sigurisë së punonjësve, mbrojtjes së mjedisit dhe përdorimit efikas të burimeve natyrore. Ky kuadër përfshin ligjet dhe aktet kryesore si më poshtë:

Ligji, Nr.7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet” (kërkimi dhe prodhimi), i ndryshuar.

Ligji, Nr.7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet” (kërkimi dhe prodhimi), i ndryshuar, rregullon veprimtarinë në sektorin e hidrokarbureve në Republikën e Shqipërisë. Ligji për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Republikën e Shqipërisë paraqet një kornizë për menaxhimin e burimeve natyrore të hidrokarbureve, duke mbështetur në parimin se këto burime janë pronë ekskluzive e shtetit shqiptar dhe duhet të shfrytëzohen në interes të popullit, kjo parashikuar në nenin 3 të ligjit. Ligji ka një strukturë të qartë që trajton aspektet pronësore, autorizuese, kontraktuale dhe administrative të veprimtarisë hidrokarbure, duke e ndarë rolin e shtetit ndërmjet Ministrisë përkatëse, Albpetrolit, Agjencisë Shtetërore për Hidrokarbure dhe Institutit Shkencor të Hidrokarbureve.

Ligji përfaqëson një ndërthurje të qartë ndërmjet zhvillimit të qëndrueshëm, ruajtjes së interesit kombëtar dhe krijimit të një partneriteti të strukturuar publik–privat. Në vetë përkufizimet themelore që ofron ligji nënkuptohet orientimi drejt një modeli të kontrolluar të menaxhimit të burimeve natyrore, ku zhvillimi ekonomik duhet të harmonizohet me mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin racional të pasurisë publike. Përmes përfshirjes së aktorëve privatë si kontraktorë, por edhe të “Albpetrol” si një subjekt me karakter të dyfishtë, ligji forcon parimin e partneritetit publik-privat në mënyrë të strukturuar dhe të kontrolluar. Në këtë mënyrë, shteti ruan një rol thelbësor në monitorimin dhe drejtimin e veprimtarive hidrokarbure, veçanërisht në fazat kritike të kërkimit, zhvillimit dhe prodhimit. Gjithashtu, ligji vendos një kuadër të fortë garancish teknike, mjedisore dhe ekonomike që mbulojnë të gjithë ciklin e jetës së operacioneve hidrokarbure duke filluar nga kërkimi, deri në prodhimin dhe mbylljen e puseve çka reflekton një përjasje gjithëpërfshirëse ndaj sigurisë dhe qëndrueshmërisë së sektorit.

Ky ligj forcon pozitën e shtetit si autoriteti i vetëm që mund të disponojë të drejtën për të kërkuar, zhvilluar dhe prodhuar hidrokarbure, përmes mekanizmit të Marrëveshjeve Hidrokarbure, të cilat kanë natyrë kontraktuale dhe përmbajnë dispozita të veçanta mbi të drejtat, detyrimet dhe garancitë e kontraktorëve. Veçanërisht e rëndësishme është përfshirja e klauzolave të stabilitetit fiskal (*nuk mund të tejkalojnë një afat prej 12 vitesh, nga data e fillimit të prodhimit*), të cilat synojnë të ruajnë parashikueshmërinë e mjedisit fiskal për investitorët, por që kanë kufizime dhe nuk prekin legjislacionin që lidhet me sigurinë kombëtare, mjedisin, apo shëndetin publik. Ky pozicion juridik siguron një balancim mes interesit të investitorit dhe sovranitetit shtetëror mbi burimet natyrore.

Ligji parashikon standarde të qarta për operacionet hidrokarbure, të cilat duhet të kryhen në përputhje me “*standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare*”, si dhe me legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e mjedisit. Dispozitat kërkojnë që çdo kontraktor të paraqesë planin e zhvillimit (*plan për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve të zbuluara në një zonë kontrate*) dhe planin e vlerësimit të zbulimeve (*plan për përcaktimin e parametrave të hidrokarbureve dhe të rezervuarit të zbuluar*), duke i nënshtruar ato miratimit nga ministria përkatëse (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë).

Ligji i ndryshuar parashikon që Ministria e Energjisë (*vetë apo duke autorizuar Albpetrol*) mund të lidhë Marrëveshje Hidrokarburesh me persona juridikë që kanë kapacitet financiar dhe teknik për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri. Këto marrëveshje bëhen me procedura të hapura dhe transparente, ku Ministria fton subjektet e interesuara të aplikojnë, ose mund të pranojë kërkesa për blloqe të caktuara. Marrëveshjet i japin kontraktorit të drejtën ekskluzive për kërkimin brenda zonës për një periudhë deri në 5 vjet (me mundësi zgjatjeje deri në 7 vjet), dhe për zhvillim dhe prodhim deri në 25 vjet, me mundësi rinovimi deri në 5 vjet. Gjithashtu, kontraktori mund të ndërtojë dhe operojë tubacione në përputhje me rregulloret kombëtare dhe traktatet ndërkombëtare. Marrëveshja garanton kontraktorit

pronësinë mbi hidrokarburet e prodhuara dhe të drejtën për t'i shitur apo eksportuar, përveç rasteve emergjente ku parashikohet furnizimi i tregut lokal. Ministria mund të refuzojë lidhjen e marrëveshjes për arsye sigurie kombëtare. Ky kuadër synon të sigurojë një proces transparent, të kontrolluar dhe të efektshëm për menaxhimin e burimeve hidrokarbure në vend.

Sa i përket rolit të institucioneve publike, ligji krijon një ndarje funksionale të qartë. Ministria luan rol kryesor për lidhjen e marrëveshjeve dhe mbikëqyrjen e politikave të sektorit, ndërsa Agjencia Shtetërore Përgjegjëse për Hidrokarburet (AKBN) zbaton politikat e qeverisë në fushën e hidrokarbureve, merr pjesë në negocimin e marrëveshjeve hidrokarbure me persona vendas e të huaj, mbikëqyr veprimtarinë hidrokarbure dhe ndjek zbatimin e marrëveshjeve të lidhura, përgatit dokumentacionin dhe praktikën e nevojshme për dhënien e lejeve, të licencave, të autorizimeve. Agjencia Shtetërore Përgjegjëse për Hidrokarburet bashkëpunon me Institutin Shkencor të Hidrokarbureve, për të gjitha problemet shkencore në fushën e hidrokarbureve, si dhe për studime, oponenta, konsulencë dhe asistencë teknike. Ky i fundit, i krijuar nga Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit përkatës, funksionon si një strukturë publike nën varësinë e tij dhe ka rol këshillimor për çështjet shkencore në fushën e hidrokarbureve. Ky institut nuk përbën një krijim të ri nga ligjvënësi, por një riorganizim institucional të një strukture të mëparshme, duke marrë parasysh se funksionet e ish-Qendrës Kombëtare Shkencore të Hidrokarbureve, e shkruarë në vitin 2006, i cili u rikthye dhe u institucionalizua sërish përmes ndryshimeve të vitit 2017 në legjislacionin për hidrokarburet. Ligji nr. 6/2017 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)” parashikoi ringritjen e Institutit Shkencor të Hidrokarbureve si një entitet shtetëror i cili kryen studime, analiza, konsulencë dhe monitorim për institucionet shtetërore, mbulon gjithë ciklin e veprimtarive nga kërkimi te prodhimi, përpunimi dhe tregtimi i hidrokarbureve. Gjithashtu, zhvillon dhe aplikon njohuri në fusha si gjeologjia, gjeofizika dhe teknologjia e nxjerrjes së naftës, duke bashkëpunuar me universitetet për kualifikimin profesional. Instituti administron të dhënat teknike dhe shkencore sipas standardeve ndërkombëtare, duke garantuar pronësinë shtetërore mbi informacionin strategjik në këtë sektor.

Neni 13/3, i shtuar me ligjin nr. 6/2017, përcakton se të ardhurat nga marrëveshjet hidrokarbure, përveç rentës minerare dhe detyrimeve fiskale, shpërndahen nga ministri në favor të institucioneve të përcaktuara në nenet 13/1 (Institutit Shkencor të Hidrokarbureve) dhe 13/2 (Agjencia Shtetërore Përgjegjëse për Hidrokarburet), pas verifikimit të nevojave të tyre financiare. Për këtë qëllim, Agjencia Shtetërore për Hidrokarburet dorëzon tek ministri, brenda muajit të parë të vitit, planifikimin e të ardhurave të pritshme nga marrëveshjet hidrokarbure. Kjo dispozitë përforcon parimin e menaxhimit të qëndrueshëm dhe transparent të burimeve financiare publike që rrjedhin nga aktivitetet hidrokarbure.

Një veçanti e rëndësishme e ligjit është statusi i veçantë i shoqërisë “Albpetrol” sh.a., e cila përfiton nga një marrëveshje specifike hidrokarbure “Marrëveshja Albpetrol” që i garanton të drejtën për të zhvilluar, prodhuar dhe tregtuar hidrokarbure në emër të shtetit në zonat ku nuk janë lidhur marrëveshje me palë të treta dhe njëkohësisht si subjekt kontraktor, duke pasur të drejtën ekskluzive për të zhvilluar aktivitet në zona jo të dhëna me marrëveshje të tjera, çka e pozicionon atë në mënyrë të veçantë brenda tregut.

4.1.2 Analizë e kuadrit ligjor fiskal të sektorit të naftës në Shqipëri

Ligji Nr. 153/2020, “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”.

Ligji nr. 153/2020 “Për Regjimin Fiskal në Sektorin Hidrokarbur” synon të rregullojë trajtimin fiskal të operacioneve hidrokarbure, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve. Ai zbatohet për personat juridikë që zhvillojnë aktivitete hidrokarbure në tokë (*onshore*), ndërsa për operacionet në det (*offshore*) parashikohet një ligj i veçantë. Ky ligj ka sjellë risi të rëndësishme në mënyrën e tatimit të kompanive që operojnë në sektorin hidrokarbur, duke krijuar një regjim fiskal të veçantë për këtë industri, i ndarë nga ai i veprimtarive të zakonshme tregtare.

Ky ligj shtrin efektet e tij edhe mbi nënkontraktorët e lidhur me kontraktorin, në rast se plotësohet një nga kushtet e mëposhtme: kur nënkontraktori konsiderohet “person i lidhur” me kontraktorin sipas përkufizimeve të legjislacionit në fuqi për tatimin mbi të ardhurat; kur nënkontraktori është operator që kryen aktivitete të cilat janë thelbësore për operacionet hidrokarbure – pra, kur kontributi i faturimeve të tij përbën të paktën 25% të shpenzimeve të përgjithshme të operacioneve; apo kur qëllimi kryesor i marrëveshjes me nënkontraktorin është shmangia nga zbatimi i normës së tatimit të përcaktuar nga ky ligj dhe përfitimi i një norme më të favorshme sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat.

Ligji rregullon detyrimet për tatimin mbi fitimin dhe taksën mbi rentën minerare në këtë sektor, si dhe përcakton ndikimin e marrëveshjeve hidrokarbure mbi detyrimet tatimore kombëtare dhe vendore.

Ky ligj parashikon kuadrin ligjor tatimor në sektorin e hidrokarbureve (*onshore*), ku parashikon rentën minerare, tatimin mbi fitimin për operacionet hidrokarbure, aplikimi i tatimit mbi fitimin, operacionet e vecanta hidrokarbure, fitimet e tatueshme dhe humbjet e lejuara, shpenzimet e zbritshme dhe ato të pazbritshme, shpërndarjet alokime dhe kontabilitetit, stabiliteti fiskal, si dhe lehtësimi nga taksat vendore e taksat e tjera, shmangia nga përfitimet e dyfishta nga marrëveshjet hidrokarbure.

Përkufizimi i rentës minerare jepet nga ligji për hidrokarburet. Ajo përkufizohet si taksa që paguhet për mineralet që nxirren nga mbitoka e nëntoka e territorit të Republikës së Shqipërisë dhe nënprodukteve të prodhuara nga këto minerale. Neni 5 i ligjit, përcakton një kuadër të qartë ligjor që synon të garantojë përfitimin e shtetit nga shfrytëzimi i burimeve natyrore nëpërmjet rentës minerare për hidrokarburet. Ky nen parashikon që çdo mbajtës i një të drejte hidrokarbure është i detyruar të paguajë një rentë minerare për sasinë e hidrokarbureve të nxjerra në territorin e Republikës së Shqipërisë. Renta përcaktohet si një përqindje fikse prej 10% e vlerës së tregut të naftës dhe gazit, duke siguruar një lidhje direkte midis sasisë së nxjerrë dhe përfitimit ekonomik të shtetit. Matja e sasisë së hidrokarbureve bëhet në pikën e lëvrimit, çka siguron objektivitet dhe transparencë në përlllogaritje.

Ligji Nr. 9957, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i përditësuar.

Gjithashtu, një rregull të rentës minerare përpara hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 153/2020, “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur” e parashikonte dhe **ligji Nr. 9957, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i përditësuar**. Taksa e rentës minerare, e parashikuar në nenin 4 të ligjit aplikohet si një detyrim mujor për subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën minerare, dhe llogaritet në momentin kur këto subjekte realizojnë shitjen e produkteve minerare. Afati për pagesën e saj është deri më 15 të muajit pasardhës nga realizimi i shitjes. Në rast eksporti, arkëtimi kryhet nga degët doganore, ndërsa për shitjet brenda vendit, përgjegjëse janë degët tatimore. Një pjesë prej 5% e të ardhurave nga renta i takon pushtetit vendor në territorin e të cilit kryhet veprimtaria minerare, dhe këto fonde përdoren për investime në nivel vendor. Në rastin kur taksa e rentës minerare aplikohet në përqindje, kjo taksë llogaritet duke shumëzuar vlerën e shitjes së produktit (pa TVSH) me përqindjen e rentës. Kur taksa e rentës minerare aplikohet në vlerë fikse për njësi, shuma e rentës minerare llogaritet duke shumëzuar sasinë e shitjes së produktit me vlerën e rentës minerare.

Neni 5 i ligjit Nr. 9957, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare” parashikon se ngarkohen për vjeljen e rentës minerare organet doganore e tatimore. Në shtojcën Nr. 2 të këtij ligji përcaktohet renta minerare sipas klasifikimit ku nafta dhe gazi janë pjesë e grupit të VII, sipas së cilës përcaktohet përqindja e rentës minerare prej 10%.

Më tej, vijojmë përsëri me analizën ligjorë të ligjit Nr. 153/2020, “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”, si një hapësirë ligjore shumë e rëndësishme në sistemin hidrokarbur në Shqipëri. Ky ligj parashikon gjithashtu detyrimin për pagimin e rentës minerare për hidrokarburet e nxjerra gjatë një muaji kalendarik nga mbajtësi i të drejtës hidrokarbure brenda datës 15 të muajit të ardhshëm, duke shoqëruar këtë pagesë me dorëzimin e deklaratës tatimore pranë administratës tatimore. Deklarata, duhet të

përmbajë informacion mbi sasinë e hidrokarbureve, vlerën e tregut sipas ligjit, shumën e rentës minerare që paguhet, si dhe çdo të dhënë tjetër të kërkuar nga udhëzimet përkatëse.

Një person që kryen operacione hidrokarbure i nënshtrohet tatimit mbi fitimin të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat ndërsa fitimet e tatueshme të një personi nga operacionet hidrokarbure llogariten dhe tatohen sipas dispozitave të këtij ligji. Operacione hidrokarbure i nënshtrohen tatimit mbi fitimin sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi të ardhurat, duke llogaritur fitimet e tatueshme veçmas për operacionet hidrokarbure dhe johidrokarbure për të shmangur mbivendosjen. Tatimi mbi fitimin nga operacionet hidrokarbure për një periudhë tatimore llogaritet duke aplikuar shkallën tatimore 50% të fitimit të tatueshëm nga operacionet hidrokarbure për këtë periudhë.

Fitimet e tatueshme nga operacionet hidrokarbure për një periudhë tatimore përbëhen nga shuma totale e fitimeve të secilit operacion të veçantë, duke përfshirë humbjet. Çdo operacion hidrokarbur trajtohet si një biznes i pavarur, ku personi duhet të mbajë të dhëna financiare të ndara dhe të llogarisë fitimin, humbjet dhe detyrimin tatimor veçmas për secilën periudhë. Për të parandaluar shmangien e tatimit, transferimi i aktiveve midis operacioneve trajtohet si blerje-shitje. Në rastet kur më shumë persona janë bashkëmbajtës të një të drejte hidrokarbure, secili llogarit veçmas fitimet e tij tatueshme, duke e trajtuar transaksionet ndërmjet tyre si transaksione ndërmjet palëve të lidhura, për të siguruar transparencë dhe drejtësi fiskale.

Ligji nr. 153/2020 trajton dhe operacionet e vecanta hidrokarbure. Çdo grup operacionesh që lidhen me një të drejtë të caktuar hidrokarbure konsiderohet si një operacion i veçantë. Në rastin kur miratohet një zonë zhvillimi dhe prodhimi brenda zonës së kontratës, operacionet e kryera para dhe pas miratimit brenda kësaj zone konsiderohen pjesë e të njëjtit operacion të veçantë. Megjithatë, operacionet e kryera pas datës së miratimit jashtë kësaj zone llogariten si një operacion i ri dhe i ndarë.

Neni 9 i ligjit nr. 153/2020 rregullon mënyrën e llogaritjes së fitimit të tatueshëm dhe trajtimin e humbjeve për operacionet e vecanta hidrokarbure. Fitimi i tatueshëm llogaritet duke zbritur nga të ardhurat shpenzimet e periudhës dhe humbjet e mbartura nga e kaluara, por kjo zbritje nuk mund të kalojë 85% të të ardhurave të periudhës përkatëse. Përparësi në zbritje u jepet shpenzimeve aktuale përpara humbjeve të mbartura. Humbjet e lejuara janë ato që tejkalojnë kufirin 85% dhe mund të mbarten pa afat për të ardhmen, deri në kompensimin e plotë, por nuk mund të përdoren për të ulur fitimet nga operacione të tjera hidrokarbure apo johidrokarbure. Po ashtu, humbjet nga operacionet johidrokarbure nuk mund të ndikojnë fitimet nga operacionet hidrokarbure, duke ruajtur ndarjen e qartë fiskale mes aktiviteteve.

Neni 10 i Ligjit nr. 153/2020 përcakton përbërjen e të ardhurave që një person përfiton nga një operacion i veçantë hidrokarbur gjatë një periudhe tatimore. Të ardhurat përfshijnë vlerën e tregut të hidrokarbureve të shitura, të ardhurat nga përdorimi ose shitja e aktiveve të operacionit, kompensimet dhe pagesat nga sigurimet, çdo tepriçë fondi rehabilitimi, si dhe çdo të ardhur tjetër të lidhur me ofrimin e shërbimeve apo informacionit brenda operacionit. Megjithatë, disa zëra përjashtohen nga të ardhurat tatimore, si interesat dhe fitimet financiare, si dhe pagesat që lidhen me transferimin e të drejtës hidrokarbure. Ky nen synon të qartësojë bazën e të ardhurave që do të përdoret për llogaritjen e fitimit të tatueshëm.

Nenet 11 dhe 12 të Ligjit nr. 153/2020 “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur” përcaktojnë kuadrin ligjor për trajtimin tatimor të shpenzimeve në operacionet e vecanta hidrokarbure. Neni 11 detajon kategoritë e shpenzimeve të cilat mund të zbriten nga të ardhurat e tatueshme, duke vënë theksin tek lidhja e drejtpërdrejtë e këtyre shpenzimeve me operacionin, përputhshmërinë me marrëveshjen hidrokarbure dhe respektimin e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar (IFRS). Ndër shpenzimet e zbritshme përfshihen ato që lidhen me pagat, sigurimet, trajtimin mjekësor të punonjësve, kostot e transportit, materialeve dhe pajisjeve, shërbime konsulence dhe administrative, kostot e rehabilitimit dhe mbylljes së puseve, dhe shumë të tjera, përfshirë edhe shpenzimet kapitale, ndërkohë neni 12 përjashton nga zbritja disa lloje shpenzimesh që nuk përbëjnë shpenzime të lejuara tatimore, si

interesat dhe kostot financiare, pagesat për të drejtën hidrokarbure, si bonuset, shumat që lidhen me pjesëmarrjen në fitime, tatimi mbi fitimin dhe disa shpenzime të përcaktuara në legjislacionin ekzistues për tatimin mbi të ardhurat.

Transferimi i të drejtave hidrokarbure, qoftë i pjesshëm apo i plotë, sjell pasoja tatimore për shitësin, si në operacionet hidrokarbure ashtu edhe në ato johidrokarbure. Kur e drejta transferohet bashkë me të njëjtin interes në operacionin përkatës, marrësi i së drejtës trashëgon proporcionalisht humbjet, të ardhurat, shpenzimet dhe këstet tatimore të lidhura me operacionin.

Shumat e paguara nga një fond i miratuar rehabilitimi i një operacioni të veçantë hidrokarbur te personi që kryen operacionin për të përmbushur shpenzimet e braktisjes, të rehabilitimit dhe të eliminimit të operacionit nuk janë të ardhura të personit. Lifgji parashikon se fondet e miratuara të rehabilitimit përjashtohen nga tatimi.

Ligji në nenin 17 të tij parashikon se marrëveshjet hidrokarbure, përveç rasteve të veçanta, nuk ndikojnë në zbatimin e ligjeve fiskale, duke e detyruar administratën tatimore të zbatojë kuadrin ligjor pa marrë parasysh përmbajtjen e marrëveshjes. Për marrëveshjet e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave dhe të përcjella nga ministri i financave, rregullat fiskale merren parasysh vetëm për palët e përfshira në marrëveshje. Nëse marrëveshja është lidhur para hyrjes në fuqi të ligjit, zbatohen mbrojtjet apo përjashtimet fiskale të saj. Nëse është lidhur pas hyrjes në fuqi të ligjit, merren parasysh vetëm klauzolat e stabilitetit fiskal dhe lehtësimet nga taksat vendore.

Në nenin 18 të tij, rregullohet klauzola e stabilitetit fiskal. Në kuadër të marrëveshjeve hidrokarbure të lidhura pas hyrjes në fuqi të ligjit, klauzola e stabilitetit fiskal ofron mbrojtje të veçantë për mbajtësit e së drejtës hidrokarbure ndaj ndryshimeve të pafavorshme fiskale. Kjo klauzolë pengon vendosjen e tatimeve, taksave dhe tarifave të reja diskriminuese, të cilat nuk ekzistojnë në momentin e lidhjes së marrëveshjes, si dhe ndryshimet diskriminuese në tatimet ekzistuese. Për më tepër, ajo mbron nga ndryshimet që shkaktojnë dëm material nëpërmjet rritjes së rentës minerare, normës së tatimit mbi fitimin, tatimit në burim, apo nëpërmjet ndryshimeve në strukturën dhe metodologjinë e llogaritjes së taksave, duke përfshirë kufizimet në zbritjen e shpenzimeve dhe humbjeve. Kjo mbrojtje është e vlefshme për një periudhë prej dymbëdhjetë vjetësh nga data e fillimit të prodhimit sipas marrëveshjes hidrokarbure. Megjithatë, përjashtohen nga kjo klauzolë ligjet që lidhen me sigurinë kombëtare, mbrojtjen e mjedisit, shëndetin publik, marrëdhëniet e punës dhe traktatet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është anëtare. Në rast se klauzola e stabilitetit fiskal zgjatet me marrëveshje të mëvonshme, ajo mund të vazhdojë të jetë në fuqi edhe pas periudhës prej dymbëdhjetë vjetësh.

Ligji në nenin 19 të tij parashikon që njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të zbatojnë lehtësim nga taksat/tarifat vendore të parashikuara nga marrëveshja hidrokarbure.

Ndërkohë në nenin 20 të ligjit trajtohet parimi i shmangies së përfitimeve të dyfishta nga marrëveshjet hidrokarbure, duke vendosur qartë se një palë në këto marrëveshje nuk mund të përfitojë njëkohësisht nga mbrojtje specifike apo përjashtim tatimor i garantuar në marrëveshje dhe nga lehtësime të mëvonshme fiskale të vendosura në legjislacion pas miratimit të marrëveshjes. Ky parim synon të parandalojë abuzimet dhe t'i sigurojë sistemit fiskal qëndrueshmëri dhe drejtësi.

Ligji vendos detyrimin për subjektet që kryejnë operacione hidrokarbure të paraqesin veçmas deklaratën tatimore për këto operacione dhe një tjetër për veprimtaritë johidrokarbure. Raportimi i fitimeve duhet të bëhet individualisht për çdo operacion të veçantë hidrokarbur, duke siguruar ndarje dhe transparencë fiskale. Kjo dispozitë synon të rrisë kontrollin fiskal dhe të shmangë përfitimet e padrejta nëpërmjet ndërthurjes së aktiviteteve të ndryshme.

Udhëzimi Nr. 6, datë 22.2.2022 “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”.

Në mbështetje të zbatimit të Ligjit nr. 153/2020 “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”, është miratuar **Udhëzimi nr. 6, datë 22.2.2022, i cili ofron një interpretim më të qartë dhe praktik të dispozitave ligjore.** Ky udhëzim ndihmon subjektet dhe administratën tatimore në zbatimin korrekt të rregullave fiskale që lidhen me të ardhurat, shpenzimet, deklarimin dhe pagesën e tatimeve për operacionet hidrokarbure. Gjithashtu, ai ndihmon në ndarjen e aktiviteteve hidrokarbure dhe johidrokarbure, zbatimin e klauzolave të stabilitetit fiskal dhe parandalimin e përfitimeve të dyfishta, duke rritur transparencën dhe sigurinë ligjore në këtë sektor strategjik.

Ligji nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” .

Gjithashtu, edhe ligji nr. 92/2014 i cili ka për objekt vendosjen dhe rregullimin e TVSH-së si një tatim i përgjithshëm mbi konsumin e mallrave dhe shërbimeve. Ky tatim është proporcional me çmimin e mallrave apo shërbimeve dhe aplikohet në çdo fazë të prodhimit dhe shpërndarjes së tyre. TVSH-ja zbatohet si një tatim në përqindje mbi çmimin e mallrave dhe shërbimeve dhe bëhet e kërkueshme për t’u paguar pas zbritjes së TVSH-së që rëndon drejtpërdrejt elementet e kostos së mallrave dhe të shërbimeve.

Nën pikën 1, shkronja *k*, e nenit 53 të ligjit, parashikohet se furnizimi i shërbimeve të destinuara vetëm për realizimin e fazës së kërkimit të operacioneve hidrokarbure, të kryera nga kontraktorët ose nënkontraktorët, të vërtetuar si të tillë nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, lidhur me realizimin e fazës së kërkimit, si dhe furnizimi i mallrave që bëjnë kontraktorët për njëri-tjetrin ose nënkontraktorët për kontraktorët e tyre, të importuara sipas parashikimeve të këtij ligji, janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja.

Udhëzim i Përbashkët Nr. 17, datë 12.6.2015, “Për përcaktimin e listës së mallrave dhe shërbimeve që përdoren në realizimin e fazës së kërkimit të operacioneve hidrokarbure nga shoqëritë e kërkimit të hidrokarbureve, të cilat përjashtohen nga pagesa e TVSH-së, si dhe procedurat e përjashtimit”.

Ky udhëzim përcakton listën e mallrave dhe shërbimeve që përdoren në fazën e kërkimit të hidrokarbureve dhe përjashtohen nga pagesa e TVSH-së në Shqipëri. Përjashtimi vlen për shërbimet dhe mallrat që përdoren drejtpërdrejt në operacionet e kërkimit nga kontraktorët dhe nënkontraktorët që kanë marrëveshje hidrokarbure me autoritetet shqiptare, si dhe për importin e këtyre mallrave dhe shërbimeve.

Furnizimet me mallra dhe shërbime që përdoren në fazën e kërkimit të hidrokarbureve nga shoqëritë kontraktore dhe nënkontraktorët e tyre për vendburime të reja të naftës dhe gazit përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH). Kjo përjashtim vlen për shërbime si studime gjeologjike dhe gjeofizike, punime gjeofizike tokësore dhe detare, shpime puse kërkimi, dhe projektet teknike dhe teknologjike që mbështesin operacionet e kërkimit. Importi i mallrave dhe furnizimet midis kontraktorëve dhe nënkontraktorëve për qëllime të kërkimit gjithashtu janë të përjashtuara nga TVSH.

Përjashtimet nuk përfshijnë shërbimet që nuk lidhen drejtpërdrejt me kërkimin, si interneti, telefoni, akomodimi, konsulencat e ndryshme apo ndërtimet e përgjithshme.

Për të përfituar nga ky përjashtim, kontraktorët dhe nënkontraktorët duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës pranë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), e cila vërteton furnizimet brenda 30 ditëve dhe lëshon vërtetimin për përjashtimin nga TVSH-ja. Në mungesë të këtij vërtetimi, furnizimet konsiderohen të tatueshme dhe kërkohet rregullimi i faturave.

Administrata tatimore, doganore dhe AKBN-ja janë përgjegjëse për zbatimin e këtij udhëzimi, duke kontrolluar dhe verifikuar furnizimet e përjashtuara dhe duke marrë masa në rast shkeljesh. Në rast se mallrat e përjashtuara nuk përdoren brenda periudhës së kërkimit ose përdoren për qëllime të tjera, ato i nënshtrohen TVSH-së.

4.1.3 Kuadri ligjor me ndikim mjedisor në sektorin e naftës në Shqipëri

Ligji 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar

Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar së fundmi me ligjin nr. 66/2024, përbën bazën kryesore të kuadrit ligjor për mbrojtjen e mjedisit në Republikën e Shqipërisë, ligj i cili është përafëruar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 21 prill 2004 “Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin”, të ndryshuar, ligj i vili synon të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, duke pasur në qendër jetën dhe shëndetin e njeriut, cilësinë e jetesës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Ky ligj ka si qëllim mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit në të gjitha aspektet e tij, si dhe sigurimin e një ekuilibri të qëndrueshëm midis nevojave të brezave të tanishëm dhe atyre të ardhshëm.

Objekti i këtij ligji, konsiston në përcaktimin e parimeve, rregullave, përgjegjësi dhe procedurave që garantojnë mbrojtjen mjedisore. Ai ka natyrë kornizë dhe shërben si bazë për miratimin e një sërë aktesh nënligjore që rregullojnë aspektet teknike të veprimit administrativ në fushën e mjedisit.

Neni 4 i ligjit sanksionon fushën e zbatimit të tij, duke theksuar se mbrojtja e mjedisit është përparësi kombëtare dhe detyrë për të gjithë shtetasit, institucionet shtetërore, personat fizikë e juridikë, vendas dhe të huaj. Ky nen e ngre mbrojtjen e mjedisit në një nivel që përfshin gjithë shoqërinë dhe forcon bazën ligjore për një qasje të përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse ndaj mjedisit.

Kreu II, i Ligjit 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar, parashikon një sërë parimesh për mbrojtjen e mjedisit. Parimet kryesore të politikave mjedisore që përcaktohen në këtë ligj përfshijnë parimin e zhvillimit të qëndrueshëm (neni 6), Parimin e parandalimit dhe marrjes së masave paraprake (neni 7), Parimin e ruajtjes së burimeve natyrore (neni 8), Parimin e zëvendësimit dhe/ose kompensimit (neni 9), Parimin e qasjes së integruar (neni 10); Parimin e përgjegjësisë së ndërsjelltë dhe bashkëpunimit (neni 11), Parimin “Ndotësi paguan” (neni 12), Parimin e të drejtës për informim dhe pjesëmarrjes së publikut (neni 13) dhe së fundmi Parimin e nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit (neni 14).

Në kreun III, ligji në nenet 15-20 parashikon mbrojtjen e të gjithë elementëve përbërës të mjedisit. Ligjvënësi ka zgejdhur t’i kushtojë hapësira ligjore mbrojtjes së ajrit, ujërave, tokës, natyrës dhe ndryshimeve klimatike.

Kreun IV të këtij ligji ligjvënësia ia ka dedikuar mbrojtjes së mjedisit në procesin e planifikimit. Në paragrafin e parë të nenit 24 të këtij ligji parashikohet se për planet dhe programet në fushën e bujqësisë, pyjeve, peshkimit, energjisë, industrisë, minierave, transportit, telekomunikacionit, menaxhimit të mbetjeve, menaxhimit të ujërave, planifikimin e territorit, si dhe për planet dhe programet e zhvillimit kombëtar, rajonal dhe vendor kërkohet vlerësimi strategjik mjedisor.

Neni 44 i ligjit nr. 10 431 “Për mbrojtjen e mjedisit” përcakton detyrimet e operatorëve ekonomikë lidhur me monitorimin e përputhshmërisë mjedisore të veprimtarisë së tyre, ku operatori ka detyrimin të monitorojë shkarkimet që burojnë nga veprimtaria, në përputhje me dispozitat e ligjit për lejet mjedisore dhe kushtet që përmban leja përkatëse. Monitorimi duhet të bëhet përmes pajisjeve të miratuara, të

mirëmbajtura dhe të certifikuara, ose përmes laboratorëve të akredituar. Rezultatet e vetëmonitorimit duhet t'i dorëzohen autoriteteve përkatëse në përputhje me kërkesat ligjore dhe kushtet e lejes mjedisore.

Sektori i hidrokarbureve (nxjerrja, përpunimi, transporti dhe magazinimi i naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre) përbën një nga aktivitetet më me ndikim në mjedis në Republikën e Shqipërisë dhe për rrjedhojë, çdo subjekt që operon në këtë sektor klasifikohet në mënyrë tipike si kategori A sipas nenit 29 të këtij ligji, duke qenë se veprimtaritë e tij janë të rrezikshme dhe me ndikim potencialisht të madh në komponentët mjedisorë. Bazuar në nenin 44, çdo kompani ose operator hidrokarbures duhet të ndërmarrë vetëmonitorim të vazhdueshëm për burimet e ndotjes. Ky monitorim duhet të kryhet duke përdorur pajisje të akredituara dhe të mirëmbajtura ose laboratorë të jashtëm të certifikuar. Në praktikë, për sektorin e hidrokarbureve, operatorët janë të detyruar të kenë një sistem të integruar të menaxhimit mjedisor.

Në neni 25, të këtij ligji ligjvënësi ka parashikuar VNM-në, të cilën e përshkruan si vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme, të mundshme të një veprimtarie në mjedis, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjella. Ligjvënësi ka parashikuar që kërkesat e hollësishme për zbatimin e këtij neni përcaktohen në ligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis, i cili do të trajtohet më poshtë.

Ligji nr 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar.

Ligji nr 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, (VNM) është një instrument juridik që synon të sigurojë mbrojtjen e mjedisit përmes një procesi të detajuar vlerësimi para fillimit të projekteve me potencial ndikimi në natyrë. Ky ligj është përafëruar plotësisht me Direktivën 85/337/KEE të Këshillit, datë 27 qershor 1985 “*Mbi vlerësimin e efekteve të projekteve publike dhe private mbi mjedisin*”, të ndryshuar.

Neni 1 i ligjit përcakton qëllimin kryesor të tij, i cili konsiston në sigurimin e një niveli të lartë mbrojtjeje të mjedisit përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve të mundshme nga projektet e propozuara. Kjo qasje reflektuar në ligj thekson rëndësinë e një parashikimi proaktiv ndaj ndikimeve mjedisore, duke përfunduar rolin e mjedisit si një element thelbësor në proceset zhvillimore dhe planifikimin ekonomik. Parashikimi ligjor i këtyre parimeve përkon me praktikën më të mira ndërkombëtare, ku parandalimi i dëmeve është prioritet ndaj trajtimit të pasojave negative, duke garantuar që zhvillimi i projekteve të mos bëhet në dëm të mjedisit. Për më tepër, ligji nënvizon rëndësinë e procesit të hapur dhe transparent të vendimmarrjes. Në nenin 2 përcaktohet objekti i ligjit, duke kufizuar fushëveprimin e tij vetëm në projektet që shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative në mjedisin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nëse janë projekte private apo publike. Në kuadër të objektit, ligji vendos përgjegjësi dhe kërkesa specifike për palët e përfshira në proces, duke formuar një kornizë të qartë dhe të detajuar rregullatore për vlerësimin e ndikimeve mjedisore. Kjo ndihmon në harmonizimin e veprimeve administrative dhe në mbrojtjen e mjedisit në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke garantuar edhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social.

Neni 4 i ligjit nr 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, vendos bazat thelbësore për mënyrën se si duhet të kryhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM) për projektet e propozuara. Ai kërkon që vlerësimi të jetë gjithëpërfshirës dhe të analizojë ndikimet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta, duke marrë parasysh jo vetëm fazën e ndërtimit dhe funksionimit të projektit, por edhe fazën e mbylljes dhe rehabilitimit të zonës. Ky nen nënvizon se analiza duhet të bazohet në gjendjen aktuale të mjedisit dhe të përfshijë gjithashtu edhe rreziqet e aksidenteve të mundshme. Një element kyç është kërkesa për propozimin e masave për parandalimin, zbutjen apo kompensimin e ndikimeve negative dhe përmirësimin e atyre pozitive gjatë zbatimit të projektit mbi mjedisin.

Ligji njeh dy lloje të VNM-së, VNM-në paraprake dhe VNM-në e thelluar. Për përgatitjen e raporteve paraprake dhe të thelluara të VNM-së, Zhvilluesi duhet të angazhojë subjekte juridike ose fizike tregtare të licencuara nga QKL, ose ekspertë të certifikuar nga ministria Raportet pranohen vetëm kur janë nënshkruar nga ekspertë të certifikuar ose nga subjektet e licencuara, por nënshkrimi nuk e heq zhvilluesin nga përgjegjësia për përmbajtjen e tyre.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ndërsa dokumenti bazë, ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë raporti paraprak i VNM-së, për projektet e shtojcës II ose raporti i thelluar i VNM-së, për projektet e shtojcës I.

Sipas shtojcës I pikës 2 të ligjit, projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis janë ndër të tjera, rafineritë e naftës bruto (duke përjashtuar ndërmarrjet që prodhojnë vetëm lubrifikantë nga nafta bruto) dhe instalimet për gazifikimin ose lëngëzimin e 500 tonë ose më shumë qymyr ose argjila/shiste bitumonoze në ditë.

Projektet që i nënshtrohen Procedurës Paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, sipas shtojcës II pikës 1 të ligjit, në industrinë nxjerrëse, janë Gurore, miniera sipërfaqësore dhe nxjerrje e torfës (projekte që nuk janë përfshirë në shtojcën I); Minierat nëntokësore; Nxjerrje e mineraleve nga marina ose llumërat lumore; Shpim i thellë, në veçanti: a) shpim gjeotermal; b) shpim për depozitimin e materialeve të mbetjeve bërthamore; c) shpim për furnizim me ujë, me përjashtim të shpimit për studimin e stabilitetit të tokës; dhe Instalime sipërfaqësore industriale për nxjerrjen e qymyrit, naftës, gazit natyror dhe xeherorëve, si dhe të argjilave/shisteve bituminoze.

Sipas nenit 10 të ligjit përcaktohet që zhvilluesi, për projektet me ndikim në mjedis, që janë subjekt i ligjit për VNM-në, paraqet pranë QKL-së, përveç dokumentacionit të kërkuar sipas ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, edhe dokumentacionin përkatës për procedurën e VNM-së, përfshirë, ku për projektet e shtojcës II, duhet të paraqitet raporti paraprak i VNM-së, i hartuar sipas llojit të projektit, projekti teknik i veprimtarisë dhe fatura e pagesës së tarifës së shërbimit, ndërsa për projektet e shtojcës I duhet të paraqitet raporti i thelluar i VNM-së, i hartuar sipas llojit të projektit, përmbledhja joteknike e raportit të VNM-së, projekti teknik i veprimtarisë, informacion për informimin dhe konsultimin me publikun dhe së fundmi faturën e pagesës së tarifës së shërbimit, sipas përcaktimeve të nenit 27 të ligjit Nr. 10 440, datë 07.07. 2011.

Pas përfundimit të procedurës paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) vendos nëse një projekt i listuar në Shtojcën II duhet t’i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së. Në rast se vendos që jo, AKM duhet të arsyetojë vendimin, të përfshijë mendimet e institucioneve të konsultuara dhe të përshkruajë masat për shmangien apo zbutjen e ndikimeve negative në mjedis. Vendimi u dërgohet menjëherë ministrisë, palëve të përfshira dhe QKL-së, dhe publikohet në faqen zyrtare të AKM-së. Ndaj zhvilluesi, për projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të VNM-së, informon dhe konsultohet me publikun e interesuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis të veprimtarisë së tij.

Procesi i VNM-së përfshin një sërë pales, ndër to zhvilluesin e projektit, ministrinë përgjegjëse dhe strukturat e saj vartëse, ministrinë e linjës dhe strukturat e varësisë, njësitë e qeverisjes vendore, publikun dhe organizatat jofitimprurëse, institucionet që përfshihen në procesin e VNM-së, si dhe shtetet fqinje në rastet e ndikimeve ndërkufitare, në përputhje me Konventën e ESPOO-s.

Gjatë procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) të thelluar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) organizon një seancë dëgjimore me publikun dhe organizatat jofitimprurëse (OJQ-të) të

interesuara, me qëllim përfshirjen e mendimeve të tyre në vendimmarrjen përfundimtare mbi projektin. Kjo seancë zhvillohet në bashkëpunim me njësinë përkatëse të qeverisjes vendore dhe me zhvilluesin e projektit. Njësia vendore ka detyrimin të njoftojë publikun dhe OJF-të për vendin, datën dhe orën e seancës sapo ato të jenë përcaktuar. Mendimet dhe komentet e publikut dhe OJF-ve pjesëmarrëse në këtë seancë përbëjnë një kriter të domosdoshëm në procesin e vendimmarrjes për VNM-në.

Neni 21 i ligjit rregullon rastet kur një projekt mund të ndikojë në zonat veçanërisht të mbrojtura. Nëse AKM ose ministria, pas përfundimit të procedurës së VNM-së, konstaton se projekti, mund të shkaktojë ndikim negativ të rëndësishëm në integritetin e një zone të mbrojtur, atëherë autoriteti përgjegjës për fushën e projektit nuk mund të lejojë zhvillimin e tij, përjashtimisht lejon zhvillimin kur nuk ka zgjidhje tjetër alternative, kur projekti ka arsye urgjente të interesit madhor publik, përfshirë interesa sociale dhe ekonomike dhe kur merren masa kompensuese për të garantuar përmbushjen e objektivave të rrjetit “Natyra 2000”. Nëse zona përmban habitate apo specie prioritare, arsye të tilla urgjente kufizohen vetëm në ato që lidhen me shëndetin e njeriut, sigurinë publike ose që sjellin ndikime të rëndësishme pozitive për mjedisin.

Ligji, në nenet 46 deri në 49, garanton të drejtën e publikut për informim në lidhje me çështjet mjedisore, të drejtën për të pasur akses në informacion, të drejtën për pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse mjedisore, si dhe të drejtën për ndjekje gjyqësore. Në përputhje me këto dispozita, çdo individ, pavarësisht nëse ka apo jo një interes të drejtpërdrejtë ose specifik, ka të drejtë të kërkojë informacion mjedisor pranë autoriteteve kompetente, sipas kategorive të parashikuara në nenin 46 të ligjit. Për më tepër, ligji parashikon edhe mekanizma mbrojtës për publikun, përfshirë të drejtën për ankim pranë autoritetit përkatës, si dhe iniciimin e padive gjyqësore, kur publiku vlerëson se mjedisi është i kërcënuar, ndotur apo dëmtuar. Këto të drejta synojnë forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare në mbrojtjen e mjedisit.

VKM Nr. 247, date 30.04.2014, “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.

Gjithashtu, nëpërmjet VKM-së Nr. 247, date 30.04.2014, “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”, ligjvënësi synon përfshirjen e publikut të gjerë në informimin dhe përfshirjen e tij gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis. Vendimi nr. 247, datë 30.04.2014, parashikon një kuadër të detajuar për informimin dhe përfshirjen e publikut në procesin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, duke garantuar transparencë dhe pjesëmarrje të gjerë gjatë gjithë fazave të procesit. Gjatë procedurës paraprake, publiku informohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit brenda 5 ditëve nga marrja e aplikimit dhe ka të drejtë të japë mendim për projektin për 20 ditë, ndërsa në fazën e thelluar parashikohen njoftime të detajuara, konsultime me komunitetin, organizim i dëgjësive publike nga zhvilluesi në bashkëpunim me institucionet përkatëse, si dhe marrja në konsideratë e mendimeve të publikut në hartimin e raportit të VNM-së dhe miratimin e Deklaratës Mjedisore. Gjithashtu, pas zbatimit të projektit, parashikohet përfshirja e publikut në fazën e monitorimit të ndikimeve mjedisore dhe jepet mundësia për ankim ndaj çdo veprimi apo mosveprimi gjatë procesit, duke përforcuar të drejtën për një mjedis të pastër dhe vendimmarrje të qëndrueshme.

Çdo plan apo program për zhvillimin e naftës, gazit dhe minierave duhet t’i nënshtrohet një vlerësimi strategjik mjedisor. Procesi i vlerësimit strategjik mjedisor përcaktohet dhe rregullohet nga ligji nr 91/2013 “Mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, i cili do të trajtohet më poshtë.

VKM-në Nr. 686, datë 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, e ndryshuar.

Në VKM-në Nr. 686, datë 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, i ndryshuar, përcaktohen rregullat, përgjegjësitë dhe afatet për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis, duke përfshirë procedurën paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe zhvillimin e procedurës së thelluar të VNM-së. VKM-ja përcakton procedurën e transferimit të vendimit ose të deklaratës mjedisore, si dhe përmban disa shtojca të rëndësishme: Shtojca I përfshin kriteret ndihmëse për marrjen e vendimit gjatë procedurës paraprake të VNM-së; Shtojca II përshkruan strukturën dhe informacionin që duhet të përmbajë raporti i thelluar i VNM-së; Shtojca III përmban kriteret ndihmëse për shqyrtimin e raportit të thelluar të VNM-së dhe hartimin e deklaratës mjedisore; Shtojca IV paraqet formatin e vendimit për VNM-në paraprake dhe të thelluar; dhe Shtojca V ofron formatin për deklaratën mjedisore.

Ky kuadër ligjor siguron një procedurë të detajuar dhe të qartë për vlerësimin e ndikimit në mjedis, duke garantuar transparencë dhe përgjegjësi gjatë procesit.

Ligji nr 91/2013 “Mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, i ndryshuar.

Ky ligj synon të sigurojë një mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, duke përfshirë çështjet mjedisore në proceset e hartimit, miratimit, ndryshimit dhe rishikimit të planeve dhe programeve që mund të kenë ndikime negative në mjedis. Ligji përcakton institucionet përgjegjëse, detyrat dhe të drejtat e tyre, si dhe procedurat për zbatimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM). Ky proces është i detyrueshëm për planet dhe programet në sektorë si bujqësia, energjia, industria, transporti, turizmi, menaxhimi i mbetjeve e ujërave, planifikimi i territorit dhe përdorimi i tokës, si dhe për çdo ndryshim apo rishikim të tyre. Gjithashtu, VSM aplikohet edhe në raste të veçanta kur planet apo programet mund të kenë ndikim të rëndësishëm në zonat e mbrojtura. Pra, në nenin 2 të këtij ligji, industria energjetike dhe minerare përfshihen në listën e sektorëve që duhet t’i nënshtrohen VSM.

Ky ligj është përafshuar plotësisht me Direktivën 2001/42/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 27 qershor 2001 “Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara”.

VSM nënkupton hartimin e një raporti të posaçëm për pasojat në mjedis të një plani apo programi, realizimin e konsultimeve me grupet e interesit, si dhe marrjen në konsideratë të rezultateve të raportit dhe konsultimeve në marrjen e vendimit përfundimtar për planin apo programin, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë ligj. Sipas ligjit raporti i VSM-së është përgjegjësi e autoritetit propozues dhe përgatitet nga subjekte fizike ose juridike të certifikuar nga ministria e të licencuara nga Qendra Kombëtare e Licencimit për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Në nenin 7 të këtij ligji trajtohen fazat e procesit të vlerësimit strategjik mjedisor. Ligji parashikon fazat detyruese të VSM-së që duhet të kalojë personi fizik apo juridik që ushtron një aktivitet ekonomik që mund të ketë ndikime negative në mjedis. Sipas këtij neni fazat e procesit të VSM përbëhen nga:

1. Njoftimi i Ministrisë së Mjedisit nga autoriteti propozues;
2. Konsultimi me Aktorët e interesuar mbi çështjet që do të trajtohen në Raportin e VSM;
3. Përgatitja e raportit konsultativ paraprak me aktorët e interesuar dhe publikun dhe përgatitjen e Raportit paraprak të VSM;
4. Përgatitja e Raportit Përfundimtar të VSM;
5. Shqyrtimi i propozimit dhe lëshimi i deklaratës nga Ministri i Mjedisit;
6. Vendimi i autoritetit miratues;
7. Monitorimi dhe raportimi i ndikimeve në mjedis të planit apo programit.

Në kuadër të ligjit nr. 91/2013 “Mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, është nxjerrë dhe Vendimi Nr. 507, datë 10.6.2015, “Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t’i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”. Sipas kësaj VKM-je, në planet

apo programet me pasoja negative në mjedis që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor janë edhe strategjitë, planet, programet dhe dokumentet e tjera të planifikimit, që janë subjekt i legjislacionit në fuqi për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi) sipas parashikimeve ligjorë në fuqi, kjo parashikuar në pikën 5 të shtojcës I të këtij vendimi.

4.1.4 Kuadri ligjor rregullator liçencues i sektorit të naftës në Shqipëri

Ligji nr 10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar.

Ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” synon vendosjen e një kuadri ligjor për parandalimin, reduktimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga veprimtari të caktuara, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës. Ky ligj përcakton rregullat për lejimin e zhvillimit të aktiviteteve që ndikojnë në ndotjen mjedisore në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe masat parandaluese për ndotjen. Në rastet kur parandalimi nuk është i realizueshëm, ligji parashikon masa për pakësimin e shkarkimeve ndotëse në ajër, ujë dhe tokë, në formë të gaztë, të lëngët apo të ngurtë.

Ky ligj harmonizohet plotësisht me legjislacionin e Bashkimit Evropian, në veçanti me Direktivën 2008/1/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 15 janar 2008, “Për kontrollin e integruar dhe parandalimin e ndotjes”, të ndryshuar, si dhe me Direktivën 2001/80/EC, datë 23 tetor 2001, “Për kufizimin e çlirimeve të disa ndotësve në ajër nga impiantet e mëdha të djegies”. Kjo përputhje synon të sigurojë një standard të unifikuar mjedisor në përputhje me praktikën më të mira evropiane për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik.

Në përputhje me ligjin nr.10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, krijohet një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipit A, B e C.

Në shtojcën 1 të ligjit, parashikohen lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi. Ligjvënësia ka përcaktuar se kërkimi dhe nxjerrja e naftës i nënshtrohen marrjes së lejes së tipit A.

Kreu II i ligjit përcakton kuadrin ligjor dhe procedural për lejet e mjedisit të tipit A, të cilat aplikohen për instalimet e kategorisë A. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është organi përgjegjës për përcaktimin dhe zbatimin e Teknikave më të Mira të Disponueshme (TMD), duke u mbështetur në faktorë teknikë, ekonomikë dhe mjedisorë, përfshirë referencat e Komisionit Evropian (EU-BREF) dhe praktikën më të mira ndërkombëtare. TMD-të hartohen në bashkëpunim me grupe teknike pune të ngritura nga ministri përkatës dhe dokumentet miratohen e publikohen në mënyrë elektronike. Çdo instalim i kategorisë A duhet të pajiset me një leje përkatëse të tipit A.

Neni 9 përcakton parimet thelbësore që udhëheqin detyrimet e zotëruesit të lejes së mjedisit të tipit A. AKM-ja cakton kushtet e lejes në mënyrë që të sigurohet parandalimi i ndotjes, veçanërisht nëpërmjet zbatimit të Teknikave më të Mira të Disponueshme (TMD), shmangia e ndotjes në nivele të larta dhe menaxhimi i mbetjeve sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, kërkohet përdorimi efikas i energjisë dhe ujit, marrja e masave për parandalimin e aksidenteve dhe rikthimi i mjedisit në gjendje të pranueshme pas përfundimit të veprimtarisë, në përputhje me Ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Leja e tipit A përmban kushte që garantojnë parandalimin e ndotjes, përdorimin efikas të energjisë dhe ujit, menaxhimin e mbetjeve dhe marrjen e masave kundër aksidenteve. Gjithashtu, kërkohet rehabilitimi i mjedisit pas mbylljes së veprimtarisë. Kërkesat për leje dorëzohen pranë Qendrës Kombëtare të Liçencimeve (QKL), shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe pagesën e tarifës ligjore.

Përsa i përket kuadrit institucional, QKL është institucioni pranë të cilit paraqitet kërkesa dhe nga i cili lëshohet leja e mjedisit për të gjitha tipet A, B dhe C, ndërsa Ministri përkatës është autoriteti përgjegjës për firmosjen e akteve të miratimit të lejeve të mjedisit të tipit A dhe B, pasi këto të jenë shqyrtuar dhe përgatitur nga AKM-ja. Kjo e fundit ka për detyrë të verifikojë saktësinë e informacionit të paraqitur nga operatori në aplikimin për leje të tipit A dhe B dhe të japë një mendim të argumentuar ministrit lidhur me dhënien ose refuzimin e lejes, së bashku me kushtet përkatëse, të cilat përfshihen në lejen e lëshuar nga QKL-ja. Për lejet e tipit C, autoriteti kompetent është agjencia rajonale e mjedisit, e cila kryen verifikimin e informacionit të paraqitur nga operatori dhe merr vendimin për lëshimin ose jo të lejes, gjithashtu të shoqëruar me kushte të detajuara, të cilat përfshihen në dokumentin përfundimtar të lëshuar nga QKL-ja. Ndërkohë, Inspektorati Shtetëror Kompetent është autoriteti përgjegjës për monitorimin dhe kontrollin e përmbushjes së kushteve të përcaktuara në leje, pas lëshimit të saj nga QKL-ja.

VKM Nr 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregulla të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”.

VKM Nr 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregulla të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, i ndryshuar, ndër të tjera, parashikon dispozita specifike për procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimin e kushteve për leje mjedisi të tipit A, ndryshime në funksionimin e instalimeve të tipit A dhe rishikimin e kushteve të lejeve ekzistuese, informimin dhe pjesëmarrjen e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A si dhe transferimin e lejeve të mjedisit të tipit A.

VKM-ja, në Shtojcën 1 të saj, përcakton në mënyrë të detajuar formatin standard të kërkesës për leje mjedisi të tipit A, me qëllim që të ofrojë mbështetje të qartë dhe praktike për aplikantët gjatë procesit të paraqitjes së dokumentacionit. Ky format synon të lehtësojë dhe të thjeshtojë procedurën administrative për shqyrtimin e kërkesave ligjore të nevojshme për miratimin e lejes, duke siguruar kështu transparencë dhe efikasitet në trajtimin e dosjeve për lejet e mjedisit të këtij tipi.

Sipas VKM-së, kërkuuesi që aplikon pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) për pajisjen me leje mjedisi të tipit A, duhet të dorëzojë;

- a) Formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit A, sipas shtojcës 1 të VKM-së;
- b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit A;
- c) Çdo informacion tjetër që kërkuuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;
- d) Kopjen e vendimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraprak ose kopje të deklaratës së ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- e) Raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, kur kërkohet;
- f) Relacion rreth dëgjësës me publikun.

AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit për leje mjedisi të tipit A nga QKL-ja, dërgon një kopje të aplikimit në Drejtoritë teknike në Ministrinë e Mjedisit, sipas specifikave të instalimit, Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (ISHMPU) dhe Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM), të cilat japin mendimin e tyre, me shkrim dhe në formë elektronike, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune dhe nëse nuk shprehen brenda këtij afati AKM vijon me procedurën.

AKM-ja, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune, pas verifikimit për saktësinë e dokumentacionit të aplikimit për lejen e mjedisit të tipit A dhe mbledhjes së mendimeve nga publiku e institucionet e cituar më sipër, harton aktin e miratimit ose të refuzimit për dhënien ose jo të lejes së mjedisit të tipit A, të shoqëruar me argumentet përkatëse, dhe e dërgon tek Ministri i Mjedisit. Ky i fundit brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes, firmos aktin e miratimit ose të refuzimit të lejes së mjedisit të tipit A ose ia kthen praktikën AKM-së për shtesa apo ndryshime të këtij akti të shoqëruar me argumentet përkatëse. Vendimi i miratimit apo refuzimit publikohet nga AKM-ja në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve.

VKM Nr. 551, datë 18.6.2015, “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure”.

VKM-ja Nr. 551, datë 18.6.2015, “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure” miraton kriteret dhe procedurat për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për personat që kryejnë veprimtari studimore-projektuese dhe zbatuese në fushën e hidrokarbureve, përfshirë kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin. Vendimi parashikon që specialistët që kërkon të ushtrojë veprimtari studimore-projektuese, veprimtari zbatuese në fushën hidrokarbure për konsulencën, mbikëqyrjen, kolaudimin, monitorimin dhe drejtimin teknik, përfshirë ndërtimin e instalimeve teknologjike dhe impianteve të nevojshme për shpimin e puseve, prodhimin, depozitimin, përpunimin, transportimin dhe tregtimin e këtyre lëndëve, duhet të pajiset me certifikatë në bazë të aftësive tekniko-profesionale dhe përvojës në këtë fushë, ndërsa pajisja bëhet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet, mbi bazën e vlerësimit të një komisioni të ngritur pranë ministrisë. Personat juridikë që ofrojnë shërbime në këtë sektor duhet të jenë të licencuar me kodin përkatës të parashikuar në këtë vendim dhe të kenë të punësuar një drejtues teknik të certifikuar.

4.1.5 Kuadri ligjor mbrojtës i sigurisë në punë dhe mekanizmat mbrojtës për statusin e punonjësit në sektorin e naftës në Shqipëri

Ligj Nr.10 237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar.

Ligji Nr. 10 237, datë 18.2.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", i ndryshuar me ligjin nr. 161/2014, synon të përcaktojë masat për garantimin e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve në vendin e punës. Objektivi kryesor i ligjit është parandalimi i rreziqeve profesionale dhe eliminimi i faktorëve që shkaktojnë aksidente apo dëmtojnë shëndetin. Ligji gjithashtu vendos detyrime për informimin, këshillimin dhe formimin e punonjësve dhe përfaqësuesve të tyre, si dhe promovon pjesëmarrjen e tyre aktive në politikat e sigurisë në vendin e punës. Ai përcakton udhëzimet e përgjithshme për mbrojtjen e shëndetit në çdo sektor pune, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Dispozitat e këtij ligji zbatohen në të gjithë sektorët e veprimtarisë private dhe publike.

Ky ligj është kuadri ligjor bazë për sigurinë dhe shëndetin në punë në Shqipëri, i cili përcakton përgjegjësitë dhe detyrimet e punëdhënësve dhe punëmarrësve për të krijuar dhe ruajtur një ambient pune të sigurt dhe të shëndetshëm, duke synuar parandalimin e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale.

Punëdhënësi ka për detyrë të sigurojë mbrojtjen e punëmarrësve në çdo aspekt që lidhet me sigurinë dhe shëndetin në punë, përmes masave si parandalimi i rreziqeve, informimi, formimi profesional, sigurimi i mjeteve dhe organizimi i vendit të punës. Masat duhet të përditësohen në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe ndryshimet në ambientin e punës. Punëdhënësi udhëhiqet nga parimet e parandalimit: shmangia dhe vlerësimi i rreziqeve, luftimi i tyre në burim, përshtatja e procesit të punës me punëmarrësin dhe zhvillimi teknologjik, zëvendësimi i substancave të rrezikshme dhe dhënia përparësi mbrojtjes kolektive para asaj individuale. Gjithashtu, ai duhet të kryejë vlerësim të rreziqeve në çdo hap të veprimtarisë dhe të garantojë përfshirjen e sigurisë në të gjitha nivelet e ndërmarrjes. Punëdhënësi duhet

të konsultohet me punonjësit për teknologji të reja dhe të sigurojë që në zonat me rrezik të hyjnë vetëm punëmarrës të udhëzuar.

Punëdhënësi, sipas Ligjit Nr. 10 237/2010 për sigurinë dhe shëndetin në punë, ka detyrimin ligjor të garantojë mbrojtjen e punëmarrësve në çdo aspekt të aktivitetit të punës. Ai duhet të vlerësojë rreziqet në vendin e punës, të hartojë dhe zbatojë masa parandaluese për aksidentet dhe sëmundjet profesionale, si dhe të sigurojë trajnimin, informimin dhe pajisjen me mjete mbrojtëse të punëmarrësve. Gjithashtu, punëdhënësi është i detyruar të bashkëpunojë me këshillin e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke përfshirë përfaqësuesit e punonjësve në çdo vendim që lidhet me përmirësimin e kushteve të punës. Ky angazhim nuk vetëm që rrit sigurinë, por edhe kontribuon në një mjedis pune më të shëndetshëm dhe më produktiv. Në sektorin e naftës në Shqipëri, punëmarrësit duhet të veprojnë në përputhje me kualifikimin dhe trajnimet specifike që kanë marrë, duke ndjekur me përpikëri udhëzimet e punëdhënësve dhe rregulloret për sigurinë në vendin e punës. Ata duhet të përdorin në mënyrë të saktë makineritë, pajisjet dhe materialet e rrezikshme, si dhe mjetet mbrojtëse personale që iu janë dhënë, për të shmangur aksidentet dhe sëmundjet profesionale që janë të zakonshme në këtë industri. Është e domosdoshme që punëmarrësit të mos ndërhyjnë në mekanizmat e sigurisë të pajisjeve dhe të raportojnë menjëherë çdo rrezik ose defekt që mund të kërcënojë jetën dhe shëndetin e tyre apo të kolegëve. Bashkëpunimi i vazhdueshëm me punëdhënësit dhe specialistët e sigurisë është thelbësor për zbatimin e masave mbrojtëse dhe për të siguruar një ambient pune të sigurt. Për më tepër, punëdhënësit në sektorin e naftës janë të detyruar të ofrojnë shërbime mjekësore të specializuara dhe kontroll të rregullt shëndetësor për punëmarrësit, duke marrë parasysh rreziqet e veçanta që lidhen me këtë fushë, sipas legjislacionit në fuqi në Shqipëri.

VKM Nr. 562, datë 3.7.2013, “Për miratimin e rregullores “për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”.

VKM Nr. 562, datë 3.7.2013, “Për miratimin e rregullores “për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”, miraton rregulloren për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës. Rregullorja zbatohet në të gjitha ndërmarrjet dhe mjediset e punës ku kryhen veprimtari pune apo trajnim profesional, pavarësisht llojit të pronësisë apo organizimit të punës. Ajo përcakton detyrime të qarta për punëdhënësin, i cili është i detyruar të sigurojë që pajisjet e punës të jenë të përshtatshme, të sigurta dhe të përdorura në mënyrë që të mos rrezikojnë jetën dhe shëndetin e punëmarrësve. Pajisjet duhet të instalohen dhe mirëmbahen në kushte të sigurta, të kontrollohen në mënyrë periodike dhe të përdoren vetëm nga persona të trajnuar dhe të autorizuar. Rregullorja përfshin detaje mbi mënyrën e instalimit, funksionimit dhe ndalimit të pajisjeve, duke përfshirë masat për ndalimin emergjent, shmangien e rreziqeve nga pjesët lëvizëse, mbrojtjen nga temperatura ekstreme, kontakti elektrik dhe shpërthimet e mundshme. Për më tepër, punëdhënësi është i detyruar të informojë dhe të trajtojë punëmarrësit mbi përdorimin e sigurt të pajisjeve, si dhe të marrë masa për ergonominë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. Rregullorja përfshin edhe kërkesa shtesë për pajisje të veçanta si ato të lëvizshme ose ngritëse, duke përcaktuar standarde të detajuara për mbrojtje ndaj përmbysjeve, frenim, telekomandim, ndriçim dhe mbrojtje kundër zjarrit.

Punëdhënësi është i detyruar të përzgjedhë pajisjet më të përshtatshme për llojin dhe kohëzgjatjen e punës, të sigurojë montimin dhe përdorimin e tyre nga persona të trajnuar dhe kompetentë, si dhe të japë përparësi masave kolektive të mbrojtjes ndaj atyre individuale. Gjithashtu, ai duhet të ndërmarrë masa për të parandaluar rëniet, të kufizojë aksesin në zona të pasigurta dhe të ndalojë punën në kushte të motit që rrezikojnë sigurinë. Trajnimi specifik i punonjësve, pajisja me mjete personale mbrojtëse dhe planifikimi i masave të evakuimit në rast emergjence janë gjithashtu detyrime thelbësore. Moszbatimi i këtyre dispozitave e ekspozon punëdhënësin ndaj përgjegjësiwe ligjore, ndërkohë që rrezikon drejtpërdrejt jetën e punëmarrësve.

VKM Nr. 563, datë 3.7. 2013, “Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”.

VKM Nr. 563, datë 3.7. 2013, “Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”, mbështetet në ligjin nr. 10 237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe ka për qëllim mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve në mjedise pune ku risqet nuk mund të shmangen përmes masave kolektive apo organizative. Rregullorja detyron punëdhënësit të vlerësojnë rreziqet në vendin e punës dhe, kur është e nevojshme, të sigurojnë pajisje mbrojtëse individuale (PMI) që janë të certifikuara, të përshtatshme për detyrën specifike dhe të garantuara për siguri e rehati. Pajisjet duhet të jenë në përputhje me standardet e BE-së, të jenë të pastra, funksionale dhe të përshtatura për përdorim personal.

Kjo rregullore detyron punëdhënësin të sigurojë falas pajisjet mbrojtëse individuale (PMI), të certifikuara dhe të përshtatshme për kushtet e punës dhe karakteristikat e punëmarrësit. Pajisjet duhet të jenë ergonomike, të ruajnë higjienën, dhe të mos shkaktojnë rreziqe shtesë gjatë përdorimit. Punëdhënësi është i detyruar të kryejë vlerësim të riskut për secilën veprimtari pune, të hartojë listën përkatëse të pajisjeve dhe të informojë e trajtojë punëmarrësit për përdorimin e tyre. Punëmarrësit, nga ana tjetër, kanë detyrimin t’i përdorin pajisjet sipas udhëzimeve të dhëna. Kjo rregullore përbën një masë të rëndësishme për parandalimin e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale, si dhe për forcimin e kulturës së sigurisë në vendin e punës. Kjo VKM gjithashtu parashikon gjithashtu një listë joshtruese të artikujve të pajisjeve mbrojtëse individuale dhe një listë udhëzuese joshtruese të veprimtarive dhe sektorëve të veprimtarisë që mund të kërkojnë sigurimin e këtyre pajisjeve. Këto lista shërbejnë si udhërrëfyes për punëdhënësit dhe punëmarrësit, duke treguar shembuj konkretë të pajisjeve që mund të jenë të nevojshme në vende të ndryshme pune, në varësi të rreziqeve specifike që paraqiten në secilin sektor. Kjo ndihmon në zbatimin më të saktë dhe efektiv të masave të sigurisë dhe shëndetit në punë, duke siguruar që punëmarrësit të jenë të mbrojtur me pajisje të përshtatshme dhe të duhura për rreziqet që përballen.

Ligj Nr. 8/2017, “Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit”.

Ligji Nr. 8/2017, rregullon statusin juridik, ekonomik, financiar dhe social të punonjësve dhe ish-punonjësve në industrinë e naftës dhe gazit në Shqipëri. Ky ligj synon të adresojë karakteristikat specifike të kësaj industrie, duke marrë parasysh natyrën e veçantë të punës, rreziqet e mundshme për shëndetin e punonjësve dhe ndikimin social që ajo ka.

Ligji trajton statusin e ish-naftëtarit dhe naftëtarit, duke i përcaktuar ish-naftëtarët si personat që kanë punuar më parë në industrinë e naftës dhe gazit në profesionet e përcaktuara ligjore, ndërsa naftëtarët si ata që punojnë aktualisht në të njëjtat fusha dhe role, përfshirë punonjësit teknikë dhe mekanikë në shpim, prodhim, përpunim dhe transport të naftës dhe gazit.

Ligji parashikon se statusi i naftëtarit i përket të gjithë shtetasve që kanë punuar dhe punojnë në industrinë e naftës dhe gazit, duke përfshirë edhe personat që janë aksidentuar në punë, pavarësisht kohëzgjatjes së punës. Përfituesit pajisen me dëshmi zyrtare identifikuese nga komisioni pranë ministrisë përgjegjëse. E drejta për marrjen e statusit lind që nga data e fillimit të punës në industrinë e naftës, për profesionet e përcaktuara në ligj. Për të marrë statusin, kërkohet dokumentacion zyrtar që vërteton periudhën e punës, si librezë pune, vërtetim nga ndërmarrja apo institucionet përkatëse, ndërsa për ish-naftëtarët në pension, vërtetimi jepet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Një pjesë e periudhës së punës mund të përfshijë edhe periudha pune në shtete të tjera me marrëveshje sociale të njohura.

Paga e naftëtarëve përcaktohet sipas kontratës kolektive dhe nuk mund të jetë më e ulët se 150% e pagës minimale kombëtare, duke reflektuar rrethanat e vështira dhe ndikimet në shëndet. Vjetërsia në punë njihet plotësisht për përfitime sociale dhe shpërblime. Naftëtarët që kanë mbi 20 vite punë (burra) dhe mbi 15 vite (gra), dhe që janë të papunë në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit, përfitojnë shpërblim financiar jo më pak se 80% e pagës minimale kombëtare. Ata që mbeten të papunë për shkak të

ristrukturimeve kanë përparësi në punësim dhe marrin shpërblim financiar për tre vitet e para pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Mosha e daljes në pension përcaktohet në 60 vjeç për burrat dhe 55 vjeç për gratë, me të paktën 30 vite (*prej të cilave 20 vitë në punë*) sigurim të përgjithshëm për burrat dhe 25 vite (*prej të cilave 15 vitë në punë*) për gratë, ku nga këto vite një pjesë duhet të jetë në industrinë e naftës. për profesione të veçanta me rrezikshmëri të lartë, mosha e pensionit mund të jetë më e ulët (55 vjeç burrat dhe 50 vjeç gratë). Masa e pensionit llogaritet sipas ligjit të sigurimeve shoqërore, ndërsa përfituesit marrin shtesë pensioni prej 1% për çdo vit pune në industrinë e naftës, deri në maksimum 40%. Pensioni nuk ka afat parashkrimi dhe nis nga data e lindjes së së drejtës ose nga data e paraqitjes së kërkesës. Gjatë periudhave kur përfituesit ushtrojnë aktivitet ekonomik nuk kanë të drejtë për përfitime, me përjashtim të vetëpunësimit në bujqësi. Përfitimet e papërfituara paguhën deri në tre vjet.

Financimi i statusit dhe përfitimeve të naftëtarëve bëhet përmes kontributeve shtesë prej 5% të pagës bruto (3% nga punëdhënësi dhe 2% nga punëmarrësi), si dhe nga buxheti i shtetit për diferencat financiare. Kërkesa për përfitime paraqitet pranë agjencisë së sigurimeve shoqërore me dokumentacionin e nevojshëm, ndërsa masa mbështetëse për strehim dhe përfitime sociale miratohen nga Këshilli i Ministrave. Përfitimet indeksohen çdo vit sipas indeksimit të pensioneve. Llogaritja dhe administrimi i pensioneve bëhet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore në përputhje me procedurat ligjore në fuqi.

Naftëtarët kanë të drejtë për kontroll mjekësor falas dy herë në vit dhe trajtim falas të sëmundjeve që lidhen me punën, qoftë në institucionet shtetërore apo në ato private. Për trajtimin jashtë vendit, financimi bëhet nga buxheti i shtetit për ish-naftëtarët dhe nga kompanitë për punonjësit aktualë. Ata përfitojnë edhe pushim vjetor shtesë prej 25% mbi ditët e zakonshme të pushimit. Në proceset e privatizimit naftëtarët përfitojnë në bazë të kohës së punës dhe kualifikimit të tyre, ndërsa koncesionarët janë të detyruar të krijojnë fonde profesionale pensioni me kontribut të paktën 10% të pagës bruto të punonjësve. Pushteti vendor ka përgjegjësi për kujdesin ndaj punësimin të përfituesve në rast papunësie dhe për krijimin e kushteve të përshtatshme për jetesën e tyre në zonat ku ata banojnë.

VKM Nr. 425, datë 10.5.2017, “Për rregullat e organizimit, funksionimit të komisionit për dhënien e dëshmisë së statusit të punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit, kriteret dhe procedurat për lëshimin e vërtetimit të posaçëm zyrtar”.

Në mbështetje të ligjit ligjit nr. 8/2017 për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe gazit, ka dalë edhe VKM Nr. 425, datë 10.5.2017. Ky vendim parashikon ngritjen e një komisioni pranë ministrisë përgjegjëse për industrinë e naftës dhe gazit një Komision me përbërje të përcaktuar, i cili ka për detyrë të shqyrtojë kërkesat për pajisjen me dëshmi zyrtare identifikuese për naftëtarët dhe ish-naftëtarët që plotësojnë kushtet ligjore. Komisioni mblidhet jo më vonë se data 10 e çdo muaji dhe merr vendimet për pajisjen ose refuzimin e dëshmimeve me shumicë votash prej të paktën 2/3 të anëtarëve. Vendimet dokumentohen në procesverbal dhe dëshmitë zyrtare përgatiten dhe nënshkruhen nga kryetari i Komisionit. Dëshmia përmban të dhënat personale, vitet e punës në industrinë e naftës dhe gazit, si dhe numrin dhe datën e lëshimit. Aplikantët që refuzohen kanë të drejtë të ankimojnë në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për refuzim.

Për pajisjen me dëshmi, aplikuesit duhet të paraqesin kërkesën, dokumentin e identifikimit, librezën e punës ose pensionit, një vërtetim zyrtar dhe fotografi në format dokumenti. Vërtetimi i posaçëm zyrtar jepet për naftëtarët që kanë punuar në profesionet e përcaktuara në legjislacion, përfshirë edhe ata që janë aksidentuar në punë, dhe pajisja bëhet përmes ndërmarrjeve apo institucioneve ku ata kanë punuar, ose në mungesë të tyre nga institucionet që mbajnë dokumentacionin përkatës. Ish-naftëtarët në pension pajisen me vërtetim pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ndërsa për periudhat e punës në shtete të tjera dokumentacioni duhet të konfirmohet nga institucionet përkatëse të shtetit të huaj dhe më pas nga

institucionet shqiptare. Ministria e Energjisë dhe Industrisë, institucionet dhe shoqëritë që operojnë në industrinë e naftës dhe gazit, si dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore janë institucionet përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi.

Ligji Nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”.

Ky ligj ka si qëllim që të ofrojë një trajtim financiar suplementar për punonjësit që kanë punuar në miniera në nëntokë, në industrinë e naftës dhe të gazit, si dhe në sektorin e metalurgjisë. Ky trajtim shtesë u jepet përveç përfitimeve që ata marrin sipas ligjeve ekzistuese të sigurimeve shoqërore. Ligji synon të njohë natyrën e vështirë, të rrezikshme dhe të lodhshme të këtyre profesioneve, duke u garantuar punonjësve të këtyre sektorëve përfitime të veçanta financiare. Përfitues sipas këtij ligji janë edhe personat në profesione e punë në industrinë e naftës e të gazit, të cilat sipas ligjit janë edhe ndër të tjerë punonjës dhe personel inxhiniero-teknik që kanë punuar në sektorë të ndryshëm të industrisë së naftës dhe gazit (p.sh. shpim, kërkim, prodhim, sizmikë, transport etj.). Për efekt të zbatimit të këtij ligji, vjetërsia e përgjithshme në punë dhe periudhat e sigurimit vlerësohen e njihen sipas përcaktimeve në dispozitat e ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të akteve ligjore në zbatim të tij.

Llojet e përfitimit sipas këtij ligji, mbi ato të përcaktuara në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, janë pension për shkak të profesionit (llojit të punës), shtesë mbi pensionin e pleqërisë ose shtesë mbi pensionin e invaliditetit.

Sipas nenit 5, kushtet dhe masa e pensionit për shkak të profesionit për ish-punonjësit, të cilët kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit, në profesione e punë të përcaktuara në pasqyrën nr. 1, “Punë, që hyjnë në kategorinë e parë”, kërret IV, pikat 2 e 3, dhe XI, të Vendimit nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, të ndryshuar, përcaktohet mosha për burrat 55 vjeç e për gratë 50 vjeç, periudha e përgjithshme e sigurimit për burrat 30 vjet e për gratë 25 vjet dhe vjetërsia në punë të kategorisë së parë për burrat 15 vjet e për gratë 12,5 vjet.

Ndërsa për ish-punonjësit, të cilët kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit, në profesione e punë të përcaktuara në pasqyrën nr. 2, “Punë, që hyjnë në kategorinë e dytë”, kreu V, të vendimit nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar, dhe personeli inxhiniero-teknik, që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës, sipas listës së miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, përcaktohet mosha për burrat 60 vjeç e për gratë 55 vjeç, periudha e sigurimit për burrat 30 vjet e për gratë 25 vjet dhe vjetërsia në punë të kategorisë së dytë për burrat 20 vjet e për gratë 15 vjet. Sipas ligjit Nr. 29/2019, ish-punonjësit e industrisë së naftës e të gazit dhe punonjësit e metalurgjisë përfitojnë shtesë mbi pensionin e pleqërisë për çdo vit periudhe sigurimi në profesion prej 0,6 % të masës së pensionit të pleqërisë, ndërsa masa e përfitimit të shtesës mbi pensionin e invaliditetit për përfituesit është e drejta e përfitimit të shtesës mbi pension në masën 1 % për çdo vit vjetërsie pune në industrinë e naftës.

4.2 NDIKIMI MJEDISOR

Ndotja industriale është një nga shkaqet kryesore të ndotjes në të gjithë botën, duke qenë se zhvillimi i aktiviteteve industriale vjen në rritje, ato janë në një burim kryesor i ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës. Ndotja nga industria në vendin tonë është subjekt i legjislacionit kombëtar i harmonizuar me legjislacionin evropian dhe ndërkombëtar, si dhe standardeve që kufizojnë emetimet në ajër, ujë dhe tokë, minimizimin e mbeturinave dhe përdorimin e burimeve natyrore.

Zhvillimi i aktiviteteve industriale në vendin tonë jep një kontribut të rëndësishëm në mirëqenien ekonomike dhe zhvillimin e tij, por nga ana tjetër aktivitetet industriale mund të kthehen në një burim kryesor për ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës. Në këtë kontekst, vërejmë se ndonëse shoqëria, “Albpetrol” sh.a, ka vite që operon në Shqipëri, duke kontribuar në rritjen ekonomike të vendit, nga ana tjetër raportohen në mënyrë të vazhdueshme shqetësime të shumta nga qytetarët në lidhje me ndotjen e shkaktuar nga aktivitetet e Albpetrolit.³⁶

Bazuar në analiza të kryera nga autoritetet vendase dhe raportime të Programit Mjedisor të Kombeve të Bashkuara (UNEP), janë identifikuar nëntë zona të Shqipërisë me ndotje të lartë industriale, të kategorizuara si “zona të nxehta” mjedisore. Tre prej tyre ndodhen në qarkun e Fierit: fusha naftëmbajtëse e Patos-Marinzës, zona e Kucoves dhe rafineria e naftës në Ballsh.³⁷

Pikat e nxehta mjedisore në Shqipëri	Sasia potenciale e mbetjeve që ato kanë të depozituara	Përshkrimi i gjendjes
Nxjerrja e naftës në Ballsh, Kuçovë, Patos Marinzë	Në zonën e Ballshit shkarkohen rreth 20,000 ton naftë në mjedisin përreth	Në zonën e Patos Marinzës ujrë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë ndotën seriozisht nga pusët e naftës, gjatë nxjerrjes me pompa, nga tubacionet dhe impiantet e paratrajtit, dhe në ajër shkarkohen gazë sulfurik dhe hidrokarbure të ndryshme. Ujrë e përdorur nga këto impiante shkarkohen në ujrë e lumit Gjanica, ku përveç përbërësve të naftës kanë edhe lëndë toksike

Institucioni i Avokati i Popullit edhe përgjatë vitit 2022 ka trajtuar problematikat e ndotjes nga hidrokarburet në lumin Gjanica dhe mjedisin përreth, hetim i cili është përmbyllur me hartimin e rekomandimit drejtuar Bashkisë Fier, Bashkisë Mallakastër, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si edhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë . Në këtë rekomandim, gjetjet e Avokatit të Popullit treguan se qëllimi kryesor i parashikuar në ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, mbrojtja e jetës dhe shëndetit nuk është realizuar, ndër të tjera në përgjigjet e institucioneve, vërehet mungesa e masave parandaluese për shkarkimin e ujërave të pa trajtuara, në veçanti atyre industriale dhe mbeturinave. Zbatimi i parimit të parandalimit kërkon një nivel më të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit. Pra, institucionet duhet të bëjnë shumë më tepër përpjekje në mënyrë që të arrihet mbrojtja efikase e së drejtës për një jetë të shëndetshme dhe mbrojtjes së mjedisit.

Edhe pse institucionet përgjegjëse pranuan rekomandimin duke informuar se do të merret parasysh hetimi i zonave të ndotura apo potencialisht të ndotura, duke vlerësuar gjëndjen e ndotjes nga rezultatet e monitorimit të mjedisit për vitin 2022, përsëri konstatohet se situata e ndotjes ka arritur në nivele

³⁶ Avokati i Popullit, (2024). *Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe mjedisit nga ndotja e hidrokarbureve në zonën e Patos Marinzë dhe qytetet përreth*. Marrë nga <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/rekomandim%2011%20dhjetor%20%202024%20albpetrol.pdf>, Faqe 13.

³⁷ Agjencia Kombëtare e Mjedisit. *Raport i gjendjes në mjedis 2021*. Tiranë, Faqe 156.

alarmante, duke u kthyer në një shqetësim jetik për banorët. Avokati i Popullit vëren, se njësitë e qeverisjes vendore në bashkëpunim me autoritetet qendrore përgjegjëse për fushën e mjedisit, kanë dështuar në menaxhimin e situatës, duke vijuar me mospërbushjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga e drejta për mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Ky institucion vërehen se rasti konkret përbën një problematikë të mbartur ndër vite, ndonëse institucionet janë angazhuar formalisht në përmirësimin e legjislacionit në fushën e mjedisit dhe nxjerrjen e akteve nënligjore, konstatohet mospërbushja vit pas viti e standardeve të legjislacionit ekzistues në mbrojtje të mjedisit.³⁸

Në analizë të fakteve të mësipërme, dhe në kuadër të përpjekjeve të Qeverisë për të realizuar një ndërhyrje efektive për rehabilitimin mjedisor të fushës naftëmbajtëse Patos Marinzë, vërejmë se ky është një problem historik mjedisor i cili paraqitet në kontradiktë të plotë me standartet mjedisore dhe aspiratat e vendit në proceset integruese. Ndër të tjera, duhet të theksojmë se jo vetëm që nuk janë marrë masa efektive për adresimin e emergjencës, për ndotjen e viteve të shkuara, pasi qartazi ndotja vijon dhe masat e marra janë thuajse inekzistente³⁹

Të gjithë përbërësit e naftës kur digjen janë të dëmshëm për mjedisin. Papastërtitë e squfurit të naftës dhe metaleve të rënda do të shkaktojnë formimin e tymrave toksikë me përmbajtje të lartë të blozës, dhe një përmbajtje të konsiderueshme e përbërjeve që përmbajnë azot, çon në një përqëndrim relativisht të lartë të oksideve të azotit. Dëmi nga djegia e naftës së papërpunuar është e dukshme dhe jo vetëm për mjedisin, por edhe për pajisjet e përdorura.⁴⁰

4.2.1 Emetimet e gazeve serrë dhe ndotja e ajrit

Industria e naftës në Shqipëri është një nga burimet kryesore të emetimeve të gazrave serrë dhe ndotjes së ajrit. Shkarkimet industriale kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në ndotjen e ajrit. Një nga probleme serioze të ndotjes në Fier në përgjithësi dhenë zonat naftëgazmbajtëse janë pluhurat të shkaktuara nga industria e naftës. Në zonën e Fierit, të dhënat tregojnë probleme serioze të shkaktuara nga industria prezente dhe e mëparshme e naftës.⁴¹

Në emetimet e gazeve me efekt serrë nga sektori i energjisë llogariten emetimet që rezultojnë për shkak të veprimtarive të djegies së lëndëve djegëse, si dhe emetimet aksidentale që rezultojnë nga nxjerrja e lëndëve djegëse të ngurta dhe nga transmetimi dhe shpërndarja e lëndëve djegëse të lëngëta dhe të gazta. Emetimet ndahen në kategoritë e mëposhtme: Industrinë energjetike, industrinë prodhuese dhe ndërtimi, transporti, sektorët e tjerë (sektori i tregtisë/institucional, i banesave dhe sektori i bujqësisë/pyrjeve/peshkimit) dhe të paspecifikuara. Janë llogaritur gjithashtu emetimet aksidentale nga nxjerrja e linjitet dhe nga veprimtaritë e lidhura me rafinimin e naftës.⁴²

Fusha naftëmbajtëse e Patos Marinzës është nga më të mëdhatë në Europë për sa i takon rezervave të naftës në brëndësi të kontinentit. Industria e naftës në zonë nuk është menaxhuar sipas standardeve

³⁸ Avokati i Popullit, (2024). Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe mjedisit nga ndotja e hidrokarbureve në zonën e Patos Marinzës dhe qytetet përreth. Marrë nga <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/rekomandim%2011%20dhjetor%20%202024%20albpeterl.pdf>, Faqe 6-7.

³⁹ Avokati i Popullit, (2024). Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe mjedisit nga ndotja e hidrokarbureve në zonën e Patos Marinzës dhe qytetet përreth. Marrë nga <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/rekomandim%2011%20dhjetor%20%202024%20albpeterl.pdf>, Faqe 7.

⁴⁰ Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Raport i gjendjes në mjedis 2023. Tiranë, Faqe 30.

⁴¹ Po aty.

⁴² Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Raport i gjendjes në mjedis 2023. Tiranë, Faqe 35.

mjedisore, duke e renditur zonën përkrah rrjetit të vatrave të nxehta mjedisore. Në zonë vërehet dhe ngarkesë e ajrit me substanca hidrokarbure volatile, sulfide të hidrogjenit apo okside të squfurit.⁴³

4.2.1.1 Grupimet e ndotësve të ajrit

Cilësia e ajrit është një ndër çështjet më kritike mjedisore me interes për popullatën. Deri disa vite më parë, në fakt, ndotja e ajrit mund të konsiderohej një problem i kufizuar në qendrat me të mëdha urbane, ndërsa tani, nga banorët e qyteteve të mëdha, duket të perceptohet si një problem i përhapur, për shkak të nivelit të lartë të ndotësve që ndodhin si gjatë muajve të dimrit (grimcat e imta, oksidet e azotit) dhe niveleve të larta të ozonit, veçanërisht në verë, kur reagimet atmosferike janë katalizuar në mënyrë më efikase.

Mbështetur në legjislacionin mjedisor dhe në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, miratuar nga MTM për vitin 2023, AKM ka realizuar monitorimin e cilësisë së ajrit urban me stacione automatike në qytetet kryesore të vëndit tonë si Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, ku ndwrr tww tjera dhe nw Fier dhe Korçë për treguesit kryesorë të cilësisë së ajrit urban si: PM10, PM2.5, NO2, SO2, O3, CO dhe BTEX.⁴⁴

Për vitin 2023, monitorimi i PM 2.5 është realizuar në 6 stacione monitorimi, në Tiranë (MTM dhe AKM), Durrës, Shkodër, ndwrr to edhe nw qytetin e Fierit dhe Korçë. Sipas rezultateve, vihet re që nuk kemi tejkalim të normës vjetore të PM 2.5 në asnjë nga stacionet e monitoruara.⁴⁵

Të gjitha proceset e djegies në ajër prodhojnë okside azoti (NOx). Dyoksidi i azotit (NO₂) dhe monoksidi i azotit (NO) janë të dy okside azoti dhe të dy së bashku referohen si (NOx). Transporti rrugor është burimi kryesor, i ndjekur nga sektori i industrisë. Mund të shkaktojë inflamacion në rrugët e frymëmarrjes dhe problem në funksionimin e mushkërive. Përfshihet në formimin e PM-së dhe ozonit. Efektet e ekspozimit afatgjatë janë më pak të sigurt se sa efektet e ekspozimit afatshkurtër. Kontribuon në acidifikimin dhe eutrofikimin e tokës dhe ekosistemeve ujore, duke dëmtuar habitatet, dhe çon në humbjen e biodiversitetit.

Monitorimi i NO₂ për vitin 2023 është realizuar në stacionet Tirana Sauk, Tirana ASHR, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë dhe Shkodër. Bazuar në të dhënat e monitoruara rezulton se nuk kemi tejkalim të vlerës limite vjetore në asnjë nga stacionet e monitoruara për vitin 2023. Por në stacionin Tirana ASHR vlera e monitoruar është shumë afër normës vjetore të BE. NO₂ është një ndotës që shkarkohet në ajër si rezultat i djegjes së lëndës djegëse në proceset industriale dhe nga transporti rrugor.

Vlerësimi i situatës për SO₂ (Dioksid Squfuri). Burimi kryesor i pluhurave, themi se ka për origjinë djegjen e karburanteve që përmbajnë squfur, si qymyri dhe vajra të rëndë nga rafineritë. Mund të shkaktojë inflamacion në rrugët e frymëmarrjes dhe problem në funksionimin e mushkërive. Përfshihet në formimin e PM-së. Kontribuon në acidifikimin dhe eutrofikimin e tokës dhe ekosistemeve ujore, duke dëmtuar habitatet, dhe çon në humbjen e biodiversitetit. Monitorimi i SO₂ për vitin 2023 është realizuar në stacionet e Tirana Sauk, Tirana ASHR, Durrësit, Fierit, Shkodrës, Korçës dhe Elbasanit. Bazuar në të dhënat e monitoruara rezulton se në asnjë stacion nuk kemi tejkalim të vlerës limite ditore dhe as të vlerës limite orare për SO₂.⁴⁶

⁴³ Agjencia Kombëtare e Mjedisit. (2015) *Ndotjet që vijnë nga hidrokarburet*. Tiranë. Marrë nga <https://akm.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/ndotjetet-qe-vijne-nga-hidrokarburet.-prill-2015.pdf>

⁴⁴ Agjencia Kombëtare e Mjedisit. *Raport i gjendjes në mjedis 2023*. Tiranë, Faqe 10.

⁴⁵ Agjencia Kombëtare e Mjedisit. *Raport i gjendjes në mjedis 2023*. Tiranë, Faqe 14.

⁴⁶ Agjencia Kombëtare e Mjedisit. *Raport i gjendjes në mjedis 2023*. Tiranë, Faqe 15.

4.2.1.2 Kategoritë e grimcave ndotëse

Industria e naftës në zonën e Fierit është një burim kryesor ndotjeje të ajrit, duke kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në degradimin e cilësisë së mjedisit. Shkarkimet industriale që vijnë nga aktivitetet e nxjerrjes, përpunimit dhe transportit të naftës dhe gazit përfshijnë një gamë të gjerë ndotësish si tymrat e motorëve të sondave, avujt e naftës bruto, gazrat natyrorë dhe djegiet në kullat e flakërimit. Këto shkarkime çojnë në formimin e pluhurave të imët, tymit, mjegullës dhe erërave të cilat qëndrojnë në atmosferë.

Një nga ndotësit kryesor në zonën e Fierit është SO₂, i cili kryesisht shkarkohet në ajër nga nxjerrja dhe përpunimi i naftës. Shumë “pellgje vajrash” në zonën e Fierit kontribuojnë në një emetim të konsiderueshëm të hidrokarbureve. Në afërsi të industrive të mëdha mund të ekzistojnë probleme me CAM-in, por monitorimi i një burimi të vetëm nuk është një mjet eficient për strategjitë e pakësimit/zvogëlimit. Një monitorim i përshtatshëm i shkarkimeve, duhet t'i prezantohet kontrollit të shkarkimeve nga burime pikësore. Dampat dhe depozitat e krijuara nga aktivitetet të mëparshme industriale, mund të kontribuojnë gjithashtu, në shkarkimet dhe formimin e pezullive të grimcave.⁴⁷

Në zonën e Patos – Marinez vërehet dhe ngarkesë e ajrit me substanca hidrokarbure volatile, sulfide të hidrogjenit apo okside të squfurit.⁴⁸

4.2.1.3 Djegia. Ndotja e Ajrit.

Djegia e naftës apo e gazit në pikat e nxjerrjes janë një burim ndotjeje të ajrit. Aditivët dhe produktet e djegies së naftës, VOC, NO_x, SO_x, CO, CO₂, PM-10, PM-2.5 dhe Pb, kanë ndikime të shumta mjedisore edhe në shëndetin e njeriut. Ndotja kimike dhe e grimcave të ajrit lidhet me sëmundjet e zemrës dhe mushkërive (sëmundja kronike obstruktive e mushkërive dhe astma) dhe vdekjen e parakohshme. NO_x dhe VOC kombinohen për të formuar ozonin në nivelin e tokës (O₃) ose smogun fotokimik. Ky reagim varet nga temperatura; kështu ngrohja rrit formimin e smogut fotokimik. Studimet mbi marrëdhëniet e vendburimeve të naftës dhe shëndetit njerëzor tregojnë se edhe nivelet e lejuara të shumë prej ndotësve rezultojnë në efekte të rëndësishme negative shëndetësore.

Prodhimi dhe përdorimi i hidrokarbureve të halogjenuara alfatike përfshinë probleme serioze shëndetësore të cilat janë:

1. Kanceri - Disa hidrokarbure të halogjenuar alifatike gjithashtu shfaqin veti mutagenike dhe teratogenike
2. Depresioni i sistemit nervor qendror - Depresioni është efekti më i shquar i shumë hidrokarbureve alfatike të halogjenuar. Dehja dhe ngacmimi duke kaluar në narkozë është reagimi tipik, dhe për këtë arsye shumë prej kimikateve në këtë grup janë përdorur si anestetike. Në ekspozimin akut ekziston gjithmonë rreziku i arrestit kardiak sepse hidrokarburet e halogjenuara alifatike e bëjnë zemrën më të ndjeshme ndaj “katekolaminës”.
3. Irritime në lëkurë - Disa nga këto substanca ,të tilla si 1,2- dibrometani dhe 1,3-dikloropropani janë patjetër irrituese dhe të dëmshme në lëkurë ,duke shkaktuar skuqje, ashpërsi dhe nekrozë madje dhe në kontakt fare të shkurtër. Duke qënë tretës të mirë, të gjitha këto kimikate mund të dëmtojnë lëkurën duke e gërryer atë dhe duke e bërë të thatë ,të ndjeshme ,të plasaritur dhe të carë , vecanrisht në kontakte të përsëritura. Ka dhe dëmtime të tjera që vijnë dhe nga nafta .Vetëm duke e nuhatur

⁴⁷ Agjencia Kombëtare e Mjedisit. *Raport i gjendjes në mjedis 2023*. Tiranë, Faqe 26.

⁴⁸ Avokati i Popullit, (2024). *Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe mjedisit nga ndotja e hidrokarbureve në zonën e Patos Marinëz dhe qytetet përreth*. Marrë nga <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/rekomandim%2011%20dhjetor%20%202024%20albpeterl.pdf>, Faqe 13.

naftën mund të shfaqen një serë komplikimesh në shëndetin tonë. Të cilat mund të jenë afatëshkurtra ose afatgjata. Ndër efektet afatëshkurtra mund të përmëdim: Halucinacione, marrje mendsh, të kollitura, të vjella, agresivitet, reflekse të ngadalta etj. Këto efekte mund të zgjasin rreth një orë ose më shumë nëse ekspozohemi në kohë të gjatë nën aromën e naftës. Ndër efektet afatëgjata përmëdim: Kimikatet helmuese të naftës dëmtojnë dalëngadalë: Zemrën, Trurin, Mushkритë, Sistemin imunitar, Sistemin skeletor etj.⁴⁹

Një raport monitorimi i hartuar nga ISHP-ja pas shpërthimit të pusit P29A, zbulon se banorët e fshatit Marinzë vuajnë nga një seri problemesh shëndetësore, që vijnë si pasojë e ndotjes së shkaktuar nga industria hidrokarbure në këtë zonë.

Sipas Raportit të Institutit të Shëndetit Publik për fshatin Marinzë i kryer gjatë periudhës kohore kur ndodhi shpërthimi i puseve në këtë zonë, nxirren në pah ndikimet negative të sektorit të naftës në shëndet. Sipas familjeve të investuara në këto zone, ekspozimi ndaj ndotësve të ajrit kryesisht të emëtuara nga komponimet e hidrokarbureve lejon zhvillimin e një sërë simptomash në rrugët e fryëmarrjes (19% e familjeve deklarojnë se kanë të sëmurë më astmë bronchiale të konfirmuar dhe trajtohen nga mjekë specialistë). Në familjet e përfshira në studim janë në total 22 raste të raportuara më astmë bronchiale e ndërkohë në 51% të familjeve të përfshira në studim shfaqin probleme të herëpashershme plmonare. Përveç problemeve plmonare, një shqetësim tjetër janë dhe problemet e lëkurës (alergjike, prurite, dermatite, ekzema e deri në melanoma. Gjithashtu, ky sektor sipas të intervistuarve, ISHP cilëson se rezulton se vetëm 8% e familjeve të të intervistuarve rezultojnë të kenë fëmijë me anomali, pesha e lindjeve në 14% të familjeve të intervistuarve rezultojnë se kanë patur lindje të fëmijëve nën peshën normale. Probleme të tjera të cilat të intervistuarit cilësojnë lidhen me djegien e syve, hipertensionin, dhimbje koke, marrje mendsh, dhimbje barku, tharje goje, përgjumje, vështirësi në frymëmarrje, djegie fyti, kollë, e deri edhe në sëmundje malinje. Sipas raportit të ISHP-së, numri më i lartë i personave të paraqitur pranë ambulancës gjatë periudhës së shpërthimit të gazit natyror për ndihmë mjekësore është ai i gjinisë femërore.⁵⁰

4.2.1.4 Ndotja e ujërave dhe flaring-u

Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore të Shqipërisë për parametrat fiziko- kimik , biologjik dhe trofik është kryer nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit me një frekuencë 4 herë/vit në 38 stacione në lumenjtë kryesore të vendit Drin, Bunë, Mat, Ishëm, Erzen, Seman, Shkumbin dhe Vjosë., 3 stacione për tributarët e liqenit të Ohrit, 10 stacione në liqenet natyrore, Ohër, Shkodër, Prespë, Prespë e Vogël. Ndotja radioaktive alfa-beta total e ujrave sipërfaqësore dhe precipitimeve atmosferike (Fallout) është monitoruar nga Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar në lumenj dhe liqene. Gjithashtu, Instituti i Gjeoshkencës ka kryer monitorimin e prurjeve në ujëra sipërfaqësore përgjatë gjithë vitit 2023, në lumenjtë Buna, Drin, Mat, Ishëm Erzen, Shkumbin, Seman, Vjosë, Bistricë.⁵¹

NR.	PARAMETRI	VLERA	NJËSIA
1	Oksigjeni i tretur	9.8	mg/l
2	pH	7.62	—
3	NBO5 (Demandi Biokimik)	12	mg/l

⁴⁹ Agjencia Kombëtare e Mjedisit. (2015) *Ndotjet që vijnë nga hidrokarburet*. Tiranë. Marrë nga <https://akm.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/ndotjetet-qe-vijne-nga-hidrokarburet.-prill-2015.pdf>

⁵⁰ Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik, Raport nga ISHP për fshatin Marinzë.

⁵¹ Agjencia Kombëtare e Mjedisit. *Raport i gjendjes në mjedis 2023*. Tiranë, Faqe 109-110.

4	Amoniumi (NH_4^+)	0.46	mg/l
5	Nitriti (NO_2^-)	0.005	mg/l
6	Nitrati (NO_3^-)	0.67	mg/l
7	Fosfati (PO_4^{3-})	0.018	mg/l
8	Fosfori total	0.021	mg/l

Table 23. Matjet e kryera në pikën monitoruese Gj4 - Gjanice, Ura e Qytetit Fier.⁵²

Përsa i takon ndotjes së ujërave sipërfaqësore vlerësohet se rreth 117 km trupa ujore janë të ndotura nga substancat/polimeret e naftës, ku përfshihen ujërat e lumit Gjanicë, Seman dhe përrenjeve të zonës. Kjo gjëndje e ujërave përbën rrezik direkt për zinxhirin ushqimor bujqësor, si pasojë e përdorimit të ujit për ujitjen e tokave.⁵³

Ujërat janë të ngopura me oksigjen. Nevoja biokimike për oksigjen (NBO5) është i rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së ujërave të lumenjve si një tregues i shkallës së ndotjes, ku stacioni Gj4 - Ura e qytetit ka një përmbajtje të lartë të NBO5 duke e klasifikuar këtë stacion në Klasën IV – Gjendje e Varfër. Referuar vlerave mesatare të amonjakut, vlerësojmë ndotje në stacionin Gj4 – Ura e qytetit Fier duke u klasifikuar në Klasën III – Gjendje e moderuar. Përmbajtja e nitriteve, nitrateve dhe fosforit total i klasifikon stacionet në Klasa I – Gjendje e Lartë. Bazuar mbi përmbajtjen e orto – fosfateve, këto stacione klasifikohen në Klasa II- Gjendje e mirë.

Vlerësojmë se Baseni i Semanit klasifikohet në Klasën IV- Gjendje e varfër me një ndotje të konstatuar në stacionin Gj4 (Stacioni i monitorimit Gjanica) – Ura e qytetit Fier ku impakti i shkarkimeve urbane dhe industriale është i lartë.

Në aspektin hidrologjik, industria e naftës ka shkaktuar ndotje të rëndë në lumenjtë Gjanica dhe Seman, përmes derdhjeve të ujërave të dekantimit nga rafineria e Ballshit dhe rrjedhjeve të vazhdueshme nga pusët e naftës.

Nxjerrja dhe përpunimi i hershëm i naftës në zonën rreth Fierit (Lumi Seman), ka sjellë si rezultat ndotjen e konsiderueshme me hidrokarbure të tokës dhe ujit sipërfaqësor. Që prej vitit 2012, janë bërë përpjekjeve të bashkërenduara për të përmirësuar metodat e përpunimit dhe rehabilituar zonat e ndotura me hidrokarbure. Si rezultat i drejtpërdrejtë i këtyre përpjekjeve sistemi ujqor është përgjigjur në mënyrë pozitive por ndotja është ende e konsiderueshme.⁵⁴

Sipas INSTAT përsa i perket cilësisë së ujërave të lumenjve Seman (Gjanicë, Mbrostar, Mujalli) për vitet 2014-2023, paraqitet si më poshtë:

⁵² Agjencia Kombëtare e Mjedisit. *Raport i gjendjes në mjedis 2023*. Tiranë, Faqe 109-110.

⁵³ Avokati i Popullit. (2024). *Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe mjedisit nga ndotja e hidrokarbureve në zonën e Patos Marinëz dhe qytetet përreth*. Marrë nga <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/rekomandim%2011%20dhjetor%20%202024%20albpatorl.pdf>, Faqe 12.

⁵⁴ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2022-2030. (2023). Marrë nga https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_538_Draft-Strategjia-Kombetare-per-Zhvillim-dhe-Integrim-2021--2030-.pdf, Faqe 135.

Referenca / Reference	Përmbajtja në ujë / Water Content	Cilësia e ujit të lumenjve / Water quality of the rivers									
		2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Seman: Gjanicë	pH	4	4	..	..	3	1	2	2	..	2
	O2	4	5	..	..	4	1	1	1	..	1
	NBO5	..	2	..	..	2	4	5	4	..	4
	NH4	5	4	..	..	5	5	5	4	..	3
	NO2	4	1	..	..	4	4	1	2	..	1
	NO3	1	2	..	..	2	2	1	1	..	1
	P-total	4	1	..	..	2	2	3	2	..	1
	P04	5	2	..	..	3	2	3	2	..	1
Seman: Mbrostar	pH	1	1	1	1	1	1	2	2	2	2
	O2	3	3	4	3	3	1	1	1	1	1
	NBO5	..	2	..	..	2	4	3	3	2	3
	NH4	3	2	2	2	4	3	1	1	2	2
	NO2	1	2	2	2	1	1	1	1	1	1
	NO3	1	1	1	1	1	1	1	1	2	1
	P-total	1	1	1	1	1	2	1	1	1	1
	P04	3	2	4	3	2	3	1	1	2	1
Seman: Mujalli	pH	1	1	..	..	1	1	1	2	2	2
	O2	4	3	4	4	3	1	1	1	1	1
	NBO5	..	2	..	..	2	4	4	3	3	3
	NH4	2	2	2	2	2	4	4	3	3	1
	NO2	1	1	2	1	2	2	1	1	1	1
	NO3	1	2	1	1	2	2	1	1	1	1
	P-total	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
	P04	4	1	4	3	2	1	1	1	1	1

Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
/Agjencia Kombëtare e Mjedisit

STANDARDET KRAHASUESE PËR UJËRAT E LUMENJVE SIPAS "UNEC"

Kategoria 1: Oksigjen i tretur >7 dhe BOD5<2 dhe NH4<0.05 dhe NO2<0.01 dhe NO3<0.8 dhe PO4<0.05 dhe P-total<0.1

Kategoria 2: Oksigjen i tretur >6 dhe BOD5<3.5 dhe pH (acid)>6.5 dhe pH (alkalin)<8.5 dhe NH4<0.3 dhe NO2<0.06 dhe NO3<2 dhe PO4<0.10 dhe P-total<0.20

Kategoria 3: Oksigjen i tretur >5 dhe BOD5<7 dhe NH4<0.6 dhe NO2<0.12 dhe NO3<4 dhe PO4<0.2 dhe P-total<0.4

Kategoria 4: Oksigjen i tretur >4 dhe BOD5<18 dhe NH4<1.5 dhe NO2<0.3 dhe NO3<10 dhe PO4<0.5 dhe P-total<1

Kategoria 5: Oksigjen i tretur <3 dhe BOD5>18 dhe pH (acid) dhe pH (alkalin) dhe NH4>1.5 dhe NO2>0.3 dhe NO3>10 dhe PO4>0.5 dhe P-total>1⁵⁵

Laguna e Karavastasë është nën presionin e depozitimeve të Lumenjve Shkumbin dhe Seman dhe aktivitetit bujqësor në zonën rreth saj. Laguna e Nartës është nën ndikimin e depozitimeve të Lumit Vjosa dhe aktivitetit bujqësor. Origjina e metaleve (Cd, Pb dhe në disa raste Cu) për lagunën e Karavastasë mund të jetë e lidhur me ndikimin historik të ujërave të ndotura të Lumit Shkumbin. Shkarkimet industriale në zonën e Elbasanit para viteve 1990 dhe me pas depozitimi i mbetjeve dhe derdhja e ujërave të ndotura urbane në Lumin Shkumbin. Cd dhe Pb janë dy elementë që bashkëshoqërojnë industrinë nxjerrëse dhe përpunuese të naftës. Shkarkimet historike të Semanit në Detin Adriatik dhe depërtimi i tyre në ujin e Lagunës së Karavastasë mund të jetë shkak për kontaminimin e ujërave.⁵⁶

⁵⁵ Cilësia e ujit të lumenjve të shqiperise 2024- ref-2023, <https://www.instat.gov.al/>.

⁵⁶ Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Raport i gjendjes në mjedis 2023. Tiranë, Faqe 90-91.

Monitorimi i cilësisë së lagunave		Përmbajtja e metaleve µg/l				
		As	Cd	Cu	Pb	Hg
Laguna e Karavastasë	Lagunë	0	104	57.	948	0
	Ujëkëmbim det – lagunë	0	92	79	928	0
Laguna e Nartës	Ura e Manastirit	0	25	98	1779	0
	Ujëkëmbim det – lagunë	0	53	99	1777	0

Table 24. Përmbajtja e metaleve në ujin e lagunave për vitin 2023. ⁵⁷

Problematika shfaqet me përmbajtjen e Cd dhe Pb në ujërat e Lagunave Karavasta, Nartë dhe Butrint, duke i klasifikuar ujërat e tyre me cilësi të dobët. Tendencia e përqendrimit të lartë të metaleve Cd dhe Pb është e njëjtë për tre sezonet Pranverë, Verë dhe Vjeshtë.

Ekspozimi i njerëzve ndaj riskut mjedisor (përmbajtja e lartë e Cd dhe Pb) mund të ndodhë vetëm nëpërmjet konsumimit të produktit të këtyre lagunave.⁵⁸

4.2.1.5 Ndikimi në habitate natyrore dhe biodiversitetin

Sa i takon biodiversitetit, vlerësohet se duke përkeqësuar kushtet fiziko – kimike të burimeve natyore, sidomos ujërave sipërfaqësore, janë ndikuar negativisht vlerat biologjike të zonës. Nga ana tjetër, vërehet një gjëndje shëndetësore e banorëve e ndikuar negativisht nga gjëndja mjedisore e zonës dhe kryesisht cilesia e ajrit dhe ujit të pijshëm të zonës. Për sa u takon dëmeve ekonomike, gjëndja mjedisore dhe shëndetësore ndikon direkt në sistemin e prodhimit ekonomik të zonës, rendimentin e ulët të prodhimit bujqësor dhe rritjen e shpenzimeve për kujdesin shëndetësor. Ndërkohe, derdhja e naftës në det është problematike sidomos për Qarkun Fier është ndotja nga nafta të industrive përpunuese apo shfrytëzuese të naftës.⁵⁹

Projektet e industrisë nxjerrëse mund të shkaktojnë ndikime negative në biodiversitet (florë dhe faunë. Përgjithësisht projektet e naftës dhe gazit shpërndahen në vende relativisht të vogla eksplorimi, në vende përreth një rajoni ose shtrirje në një sipërfaqe të madhe, duke zvogëluar kështu efektin e heqjes të bimësisë dhe copëtimin e madh të habitateve. Sidoqoftë, kjo mund të ndryshojë nga një rast në tjetrin, në varësi të llojit të projektit.

Projektet e industrisë nxjerrëse mund të shkaktojnë ndikime të drejtpërdrejta dhe jodirekte në dëmtimin e florës dhe faunës. Ndikimet e drejtpërdrejta mund të përfshijnë zhdukjen e bimësisë dhe humbjen e habitatit natyror. Ndikimet jodirekte mund të përfshijnë shqetësime të specieve të faunës për shkak të gërmimeve, gjenerimit të zhurmave, dridhjeve/ vibrimeve dhe ndotësve të ajrit, kryesisht pluhurit.

Në industrinë e naftës dhe gazit, fraktimi hidraulik ka krijuar probleme për shkak të dridhjeve. Kjo teknikë përdoret për të nxjerrë hidrokarbure duke injektuar ujë (dhe kimikate) nën presion për të thyer shkëmbinjtë dhe për të lejuar lëshimin e naftës dhe gazit në sipërfaqe. Kjo teknikë mund të shkaktojë lëvizjen e shtresave nëntokësore të tokës dhe shkëmbinjve, të cilat si pasojë mund të shkaktojnë

⁵⁷ Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Raport i gjendjes në mjedis 2023. Tiranë, Faqe 90-91.

⁵⁸ Po aty.

⁵⁹ Avokati i Popullit. (2024). Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe mjedisit nga ndotja e hidrokarbureve në zonën e Patos Marinëz dhe qytetet përreth. Marrë nga <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/rekomandim%2011%20dhjetor%20%202024%20albpeterl.pdf>, Faqe 13.

shqetësime në tokë, lëvizje të shtresave, dridhje dhe tërmete. Përveç ndikimeve të mundshme mjedisore, dridhjet për shkak të fraktimit hidraulik mund të shkaktojnë shqetësime dhe ndikime të rënda sociale në komunitetet lokale afër zonave të shfrytëzimit të naftës dhe gazit.⁶⁰

Disa ndikime janë afatshkurtra dhe të kufizuara në zonën e projektit, ndërsa të tjerat mund të kenë efekte afatgjata. Madhësia dhe ashpërsia e ndikimeve do të varet nga qasja që ndërmerr mbajtësi i lejes. Nëse mbajtësi i lejes angazhohet të zbatojë masat e duhura zbutëse dhe menaxhuese gjatë aktiviteteve të kërkimit dhe shfrytëzimit, ndikimi do të minimizohet në një nivel të pranueshëm në përputhje me kërkesat specifike ligjore.

Në industrinë e naftës dhe gazit rehabilitimi i zonave / habitateve të prekur/ ndikuar mund të jetë më i vështirë për shkak të funksionimit / shfrytëzimit të zonave për periudha të gjata kohore. Sidoqoftë, mbajtësi i lejes në këto raste duhet të angazhohet për të rivendosur dhe rikthyer në gjendjen e mëparshme të gjitha zonat e prekura gjatë fazës së kërkimit dhe për të minimizuar ndikimet në habitatin dhe biodiversitetin dhe kufizimin e tyre brenda zonave të punës ku ndodh shfrytëzimi.⁶¹

Ndikimet nga kjo lloj kategorie projekti janë zakonisht më të ulëta sesa ato në gurore dhe miniera. Sidoqoftë, gjatë fazës së shfrytëzimit mund të ketë ndikime të konsiderueshme në gjeologjinë dhe cilësinë e tokës për shkak të proceseve të shpimit dhe fraktimit hidraulik. Fraktimi hidraulik mund të ketë ndikime të konsiderueshme në gjeologji për shkak të injektimit të ujit për nxjerrjen e hidrokarbureve. Në varësi të zonës më të favorshme për nxjerrjen e hidrokarbureve, zonat e projektit mund të ndodhen në një larmi të madhe të llojeve të terrenit, duke përfshirë afër zonave të banuara, zonave kodrinore / malore dhe tokave bujqësore. Në rastin e tokave bujqësore, zona do të shndërrohet nga një tokë e kultivuar në një zonë industriale, e cila si rezultat i aktiviteteve të projektit mund të kontaminohet (derdhje) dhe / apo të degradohet për shkak të proceseve të ndryshme nxjerrëse. Për sa i përket ndikimeve në peizazh, madhësia mund të jetë më e ulët në projektet e naftës dhe gazit krahasuar me guroret dhe projektet e minierave. Sidoqoftë, ndikimet vizuale mund të jenë afatgjata për shkak të periudhës së gjatë të shfrytëzimit të hidrokarbureve. Pajisjet dhe makineritë nxjerrëse mund të krijojnë shqetësime vizuale në komunitetet lokale dhe tek vizitorët. Këto lloj ndikimesh mund të zvogëlohen përmes masave të ndryshme zbutëse dhe menaxhuese nëse praktikatat e mira ndiqen në çdo kohë.⁶²

Sot, trashëgimia e gjallë e luginës së lumit Vjosa qëndron në komunitetet e saj të shumta. Pellgu i lumit Vjosa është i pasur me burime jometalike, si argjila, inerte, gipsi, fosforit, gëlqeror, dolomit dhe burime energjetike si nafta, gazi dhe qymyri.⁶³ Diversiteti mjedisor i luginës së lumit Vjosa përballë me sfida nga aktivitetet ekzistuese dhe potenciale në rajon që burojnë nga komunitetet dhe të cilat bazohen te lumi si burim. Nxjerrja e gurit gëlqeror, zhavorrit dhe bitumit nga minierat dhe guroret ka prishur

⁶⁰ EITI, (2021). *Raporti Studimor Perfundimtar në fushën e Mjedisit për Industrinë Nxjerrëse*. Marrë nga <https://www.albeiti.org/site/wp-content/uploads/2021/07/al-ab-ba1-albania-eiti-environment-scoping-study-final-report-shqip-firmosur.pdf>, Faqe 64.

⁶¹ EITI, (2021). *Raporti Studimor Perfundimtar në fushën e Mjedisit për Industrinë Nxjerrëse*. Marrë nga <https://www.albeiti.org/site/wp-content/uploads/2021/07/al-ab-ba1-albania-eiti-environment-scoping-study-final-report-shqip-firmosur.pdf>, Faqe 60.

⁶² Po aty.

⁶³ Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. (2020). *Plani i Biznesit për Parkun Kombëtar të Lumit të Egër Vjosa (2024-2034)*. Marrë nga <https://akzm.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Kapitulli-E.-Plani-i-Biznesit.pdf>, Faqe 20.

historikisht shtretërit e lumenjve, ndërsa nxjerrja e naftës dhe gazit ndodh zakonisht veçanërisht në rajonin e Vjosës së poshtme.⁶⁴

Aktiviteti industrial gjithashtu ushtron presion të vazhdueshëm mbi burimet e pellgut të lumit Vjosa. Të tre qarqet e Vjosës (Gjirokastra, Fieri dhe Vlora) kanë trashëguar ndotje industriale nga e kaluara dhe përballen me probleme serioze aktualisht, pavarësisht se ndotja është e përqendruar kryesisht në Vjosën e poshtme, ku ndodh aktiviteti mineral më i madh, prodhimi i naftës dhe gazit. Shpeshherë shkarkimet nga veprimtaria dhe ndarja e ujërave nga industria e naftës shkojnë direkt në lumin Vjosa dhe degët e tij, ose ri-injektohen në nëntokë, duke rrezikuar kështu ndotjen e ujërave nëntokësore.⁶⁵

4.2.1.6 Ndikimi në cilësinë e ajrit

Ndotja e ajrit mbetet ndër çështjet më shqetësuese të mjedisit në industritë nxjerrëse. Emetimet në ajër mund të ndodhin gjatë secilës fazë të ciklit të projektit të industrive nxjerrëse, veçanërisht gjatë hulumtimit, përgatitjes së aktiviteteve, shfrytëzimit dhe veprimtarive operacionale. Burimet më të mëdha të ndotjes së ajrit në operimin e industrive nxjerrëse janë:

- Grimcat ngurta në ajër (kryesisht PM2.5 dhe PM10) si rezultat i gërmimeve, shpërthimeve (p.sh. gurore), transportit të materialeve, erozionit të erës (më e shpeshtë në minierat e hapura), pluhurit të shpërndarë nga objektet e mbetjeve industriale, rezervave, vend-depozitimeve të mbetjeve dhe trafiku rrugor;
- Emetimet e shkarkimit nga burimet e lëvizshme (makina, kamionë, makineri / pajisje të rënda) gjithashtu mund të kontribuojnë në rritjen e niveleve të grimcave të ngurta në ajër, si dhe çlirimin e emetimeve të gazit (NO_x, SO_x, CO, etj.);
- Emetimet e pluhurit nga përpunimi i mineraleve dhe hidrokarbureve dhe lëvizja e trafikut, veçanërisht në rrugët e pashtuara; dhe,
- Emetimet e gazit nga djegia e karburanteve në burime të palëvizshme dhe të lëvizshme, nga shpërthimet, dhe përpunimi i mineraleve dhe hidrokarbureve. Sapo ndotësit lëshohen/çlirohen në atmosferë, ata pësojnë ndryshime fizike dhe kimike përpara se të arrijnë një receptor. Këta ndotës mund të shkaktojnë efekte serioze negative në shëndetin e njeriut dhe në mjedis, veçanërisht në biodiversitet (faunë dhe florë). Aktivitetet e minierave dhe / apo naftës dhe gazit në shkallë të gjerë kanë potencialin të kontribuojnë ndjeshëm në ndotjen e ajrit, veçanërisht në fazën e operimit ose shfrytëzimit. Rastet më problematike mendohen të jenë aktivitetet nxjerrëse që operohen pranë komuniteteve dhe / apo brenda zonave të banuara. Emetimet më shqetësuese të ndotësve të ajrit nga lloje të ndryshme të industrive nxjerrëse, janë: Nafta dhe Gazi - ndotësit më shqetësues të ajrit kanë të bëjnë me emetimet e gazit, në veçanti SO_x, NO_x, CO, CO₂, etj., Gjatë veprimtarisë ose aktiviteteve të shfrytëzimit. Gjatë aktiviteteve të eksplorimit mund të ketë aktivitete shpuese, të cilat gjenerojnë ndotës të grimcave të ngurta në ajër. Gjenerimi i pluhurit mund të ndodhë gjithashtu për shkak të lëvizjes së trafikut; megjithatë, kjo konsiderohet si një çështje me më pak rëndësi në këto lloje aktivitetsesh.⁶⁶

⁶⁴ Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit. (2024). Marrë <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/Kapitulli-F.-Masterplani-per-Turizmin.pdf>, Faqe 9.

⁶⁵ Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. (2020). *Plani i Biznesit për Parkun Kombëtar të Lumit të Egër Vjosa (2024-2034)*. Marrë nga <https://akzm.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Kapitulli-E.-Plani-i-Biznesit.pdf>, Faqe 21.

⁶⁶ EITI, (2021). *Raporti Studimor Perfundimtar në fushën e Mjedisit për Industritë Nxjerrëse*. Marrë nga <https://www.albeiti.org/site/wp-content/uploads/2021/07/al-ab-ba1-albania-eiti-environment-scoping-study-final-report-shqip-firmosur.pdf>, Faqe 62.

4.2.2 Derdhjet aksidentale dhe mbetjet e naftës

Shqipëria nuk ka regjistruar ndodhi të mëdha derdhesh detare të naftës gjatë periudhës 2014–2024, por ka pasur shumë raste ndotjeje tokësore kronike dhe aksidentale. Puset e vjetra, depozitat e paizoluara, mungesa e mirëmbajtjes së linjave të transportit dhe rrjedhjet nga rafineritë janë ndër burimet më të zakonshme të ndotjes. Në zonat si Zharrëz, Marinëz dhe Ballsh, banorët kanë raportuar vazhdimisht derdhje të pakontrolluara të ujërave industriale dhe mbetjeve të naftës në tokat përreth, shpesh afër banesave ose tokave bujqësore.

Derdhjet aksidentale mund të shkaktojnë ndikime të mëdha në mjedis. Toka e ndotur me substanca hidrokarbure konsiderohet si mbetje e rrezikshme dhe duhet të menaxhohet dhe asgjësohet si duhet në përputhje me kërkesat ligjore në zonat e dedikuara të depozitimit ose në landfillë. Materialet e tjera të rrezikshme siç janë pajisjet e vjetra, makineritë, depozitat e magazinimit dhe substanca të tjera konsiderohen gjithashtu mbetje të rrezikshme. Përgjithësisht këto mbetje mund të ndoten me substanca hidrokarbure dhe kimikate të tjera. Në Shqipëri, ka shumë zona të "nxehta" si Marinza, Ballshi, Kucova, etj., që paraqesin rreziqe mjedisore dhe sociale për shkak të pajisjeve të vjetra të shpimit të hidrokarbureve të lëna në zonë, derdhjeve të hidrokarbureve dhe / apo llojeve të tjerë të materialeve të rrezikshëm të braktisur nga aktivitetet e mëparshme industriale nxjerrëse. Shpesh këto materiale dhe substanca të rrezikshme paraqesin shqetësime të mëdha për komunitetin lokal për shkak të çlirimit të mundshëm të aromave, kontaminimit të burimeve ujore dhe tokës, veçanërisht gjatë periudhës së verës. Mbajtësit e lejeve duhet të jenë plotësisht në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe të sigurojnë menaxhim të praktikës më të mirë për asgjësimin, trajtimin dhe ripërdorimin e mbetjeve të gjeneruara nga aktivitetet e tyre.⁶⁷

Nga inspektimi i bërë nga specialistët në vendburimin e naftës Visokë, konstatohet se fluidi i prodhuar nga fusha grumbullohet në grupe dhe prej andej transportohet me autobot ose pompohet për në dekantim. Në grupe ka ndotje të mjedisit si pasojë e shkarkimit të H₂O teknologjik dhe rrjedhje të naftës gjatë mbushjes së autoboteve të transportit të ujit dhe naftës. Është konstatuar se ka ujë teknologjik dhe mbetje hidrokarbure në mjedis dhe prej andej këto shpërndahen në kanalet përreth. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me marrëveshjet hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Visokë.⁶⁸

4.3 EFEKTIVITETI I MASAVE MBROJTËSE

4.3.1 Procesi Teknik i Pastrimit të Përmbajtjeve të Sulfateve dhe H₂S në Ujërat e Ndotur nga Industria e Naftës

Për shkak të pranisë së niveleve të larta të lëndëve ndotëse, është e domosdoshme integrimi i një impianti pastrimi në skemën teknologjike të uzinës, i cili vendoset në hyrje të kolektorëve kryesorë të ujrave të shkarkimit. Ky implant synon pastrimin nga produktet naftë dhe mbeturinat mekanike, duke përdorur teknologji të ndryshme të trajtimit të ujërave.

Metodat Kryesore të Pastrimit të Ujrave të Ndotura me Naftë janë:

- Trajtimi me Karbon Aktiv- Karboni aktiv përdoret për të adsorbuar komponimet organike të naftës, duke siguruar pastrim efikas të ujërave të ndotur.

⁶⁷ EITI, (2021). *Raporti Studimor Perfundimtar në fushën e Mjedisit për Industrinë Nxjerrëse*. Marrë nga <https://www.albeiti.org/site/wp-content/uploads/2021/07/al-ab-ba1-albania-eiti-environment-scoping-study-final-report-shqip-firmosur.pdf>, Faqe 65.

⁶⁸ Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2023). *Raport përfundimtar i auditimit të përputhshmërisë të ushtruar në Albpetrol sh.a Patos*. Tiranë, Faqe 293.

- Metoda Biologjike e Pastrimit të Ujrave - Në këtë metodë, bakteriet luajnë një rol kyç. Më shumë se 100 lloje bakteriesh të specializuara ushqehen me hidrokarbure të naftës dhe realizojnë degradimin biologjik të saj. Kolonizimi i këtyre mikroorganizmave ndodh në sipërfaqen e cipës së hollë të naftës mbi ujë, ku zbërthimi i substancave ndotëse kryhet brenda 2-3 muajve.
- Oksidimi me Trajtim Termik - Ky proces përfshin oksidimin e komponimeve të ndotura në temperatura të larta për të reduktuar përmbajtjen e sulfateve dhe H₂S në ujë.

4.3.2 Trajtimi Biologjik i Ujrave të Ndotura me Naftë

Bakteriet metabolizojnë hidrokarburet në një proces natyror që ndodh në shtresën e sipërme të ujit dhe kërkon kohë nga një deri në dy javë për kolonizim dhe disa muaj për degradim të plotë.

A. METODA ME FLOTIM

Ujërat që përmbajnë naftë në formë emulsioni pastrohen përmes flotimit, i cili bazohet në ngjitjen e pikave të naftës në sipërfaqen midis ujit dhe fluskave të ajrit. Ajri shpërndahet në thellësi të ujit, duke krijuar fluska që bartin naftën drejt sipërfaqes, ku formohet një cipë shkume e ngopur me naftë. Për të rritur efikasitetin, përdoren substanca kimike si sufati i natriumit. Për ndarjen e cipës së naftës mund të përdoren edhe filtra prej rëre ose kashte, ku nafta ngjitet në kokrra rëre ose kashtë dhe më pas merret me ujë të ngrohtë në temperaturë 60-70°C.

B. SKEMA PRINCIPIALE TEKNOLOGJIKE E PASTRIMIT TË NAFTËS

- Nafta dhe uji i grumbulluar nga vaskat e puseve dhe kanalet hidraulike dërgohen në një rezervuar grumbullimi.
- Në rezervuar kryhet një ndarje paraprake termike për dekantim.
- Përzierja pastaj futet në reaktorin e flotimit, ku me ndihmën e ajrit ndahen fazat e naftës dhe ujit.
- Nafta nga sipërfaqja e reaktorit kalon në dehidratorin e parë ku nxirret nafta pa ujë.
- Mbetja që përmban deri në 70% ujë dhe 30% naftë kalon në dehidratorin e dytë për ndarje përfundimtare.
- Llumi i formuar kalon në mbledhësin e llumrave dhe më pas në filtër pres për ndarjen e ujit nga argjilat dhe dherat, të cilat dërgohen në destinacionet e përcaktuara.
- Për të përshpejtuar flotimin, në proces shtohen reagentë kimikë si sulfat alumini dhe solucion kripe.
- Temperatura e procesit mbikëqyret dhe mbahet në 75-80°C për efektivitet optimal.

4.4 PLANI I PËRMBALLIMIT TË EMERGJENCAVE

Kompanitë e naftës në veprimtarinë e tyre, detyrohen të planifikojnë, të organizojnë dhe të realizojnë me shpenzimet e veta dhe të shtetit shërbimet për përballimin e emergjencave civile në zonën ku zhvillohet veprimtaria. Shoqëritë kanë për detyrë:

A. IMPLEMENTIMI I SISTEMEVE TË MONITORIMIT NË KOHË REALE

- Vendosja e sensorëve dhe kamerave për monitorim të vazhdueshëm të zonave kritike si magazinat e lëndëve djegëse, zonat me pajisje elektrike dhe pusët e nxjerrjes.
- Përdorimi i sistemit të alarmit automatik për rrezikun e zjarrit, rrjedhjes së lëndëve kimike apo ndryshimeve të parametrave të mjedisit (presion, temperaturë, përqindje oksigjeni).
- Integrimi i këtyre sistemeve me qendrën e komandës për reagim të shpejtë.

B. TRAJNIME TË AVANCUARA DHE SIMULIME TË EMERGJENCAVE

- Organizimi i trajnimeve periodike, jo vetëm për njohuritë bazë, por edhe simulime realiste të situatave emergjente (zjarri, përmytjet, rrjedhjet e gazit, shpërthimet).

- Përdorimi i realitetit virtual për të përgatitur punonjësit për situata me rrezik të lartë.
- Përfshirja e ekipeve të jashtme emergjente në ushtrime për përmirësimin e koordinimit.

C. SISTEMI I MENAXHIMIT TË RREZIQEVE TË BIOLOGJIKE DHE KIMIKE

- Krijimi i një protokollit të detajuar për menaxhimin e lëndëve kimike dhe substancave toksike me magazinim dhe trajtim të sigurt.
- Përditësimi i listës së substancave me rreze të veçanta dhe ofrimi i pajisjeve mbrojtëse individuale (pajisje mbrojtëse respiratore, rroba speciale).
- Sistemi i monitorimit dhe kontrollit të nivelit të substancave toksike në ajër.

D. PËRFORCIMI I INFRASTRUKTURËS PËR PARANDALIMIN E PËRMBYTJEVE

- Ndërtimi i barrierave dhe sistemit të kanalizimeve për largimin efektiv të ujit në rast përmbytjesh.
- Projektimi i sistemeve të mbrojtjes ndaj erozionit në tokë dhe mbjellja e bimëve me rrënjë të thella për stabilitet më të mirë të tokës.
- Krijimi i planit të evakuimit të veçantë për situatat e përmbytjeve me pika grumbullimi dhe rrugë daljeje të sigurtë.

E. MENAXHIMI EFEKTIV I MBETJEVE DHE RICIKLIMI

- Zbatimi i procedurave të përmirësuara për grumbullimin, ruajtjen dhe transportin e mbetjeve të rrezikshme dhe jo-rrezikshme, duke përdorur sisteme selektive për riciklim.
- Edukimi i punonjësve për ndarjen dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me standardet mjedisore.
- Bashkëpunimi me operatorë të autorizuar për trajtimin e mbetjeve industriale.

F. PËRMIRËSIMI I KOMUNIKIMIT DHE KOORDINIMIT ME AUTORITETET LOKALE

- Vendosja e një protokollit të qartë komunikimi me autoritetet e emergjencave civile dhe shërbimet e tjera (Zjarrfikësit, Policia, Shërbimi Shëndetësor).
- Përdorimi i platformave digjitale për njoftime të shpejta dhe koordinim në situata emergjente.
- Pjesëmarrja në takime dhe trajnime të përbashkëta me autoritetet për përmirësimin e përgjigjes ndaj emergjencave.

G. PLANIFIKIMI PËR REDUKTIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS GJATË OPERACIONEVE

- Zbatimi i metodave më të mira teknike për reduktimin e zhurmave dhe ndotjes së ajrit gjatë punimeve, për shembull, përdorimi i pajisjeve me nivel të ulët të zhurmës dhe kontrolli i emetimeve.
- Kontrolli dhe mirëmbajtja periodike e makinave dhe pajisjeve për të parandaluar rrjedhjet dhe avullimet e substancave helmuese.
- Përdorimi i burimeve të energjisë së rinovueshme dhe efienca energjetike në impiante.

H. PËRFORCIMI I SISTEMIT TË SINJALISTIKËS DHE NDRIÇIMIT EMERGJENT

- Vendosja e sinjalistikës me materiale reflektuese dhe të qëndrueshme ndaj motit për të siguruar shikueshmëri maksimale edhe në errësirë apo mjegull.
- Sistemet rezervë të ndriçimit me bateri ose burime alternative për të garantuar daljen e sigurt në rast ndërprerje energjie.

I. KONTROLL SHËNDETËSOR

Vlerësimi i gjendjes së shëndetit të çdo punëmarrësi në funksion të ekspozimit ndaj substancave kimike në vendin e punës;

Vlerësimi i rrezikut të mundshëm.

- Në vlerësimin e rrezikut të mundshëm, punëdhënësi përcakton paraprakisht praninë e mundshme të substancave kimike të rrezikshëm, në vendin e punës dhe vlerëson rrezikun e mundshëm për sigurinë

dhe shëndetin e punëmarrësve të shkaktoar nga prania e këtyre substancave, duke marrë në konsideratë veçanërisht:

- Në rastin e aktiviteteve të punës që sjellin ekspozimin ndaj shumë substancave kimike të rrezikshme, rreziqet e mundshme vlerësohen mbi bazën e rrezikut që sjell kombinimi i të gjithë substancave kimike të mësipërm.
- Furnizuesi ose prodhuesi i substancave kimike duhet të vërë në dispozicion të punëdhënësit blerës, të gjitha informacionet e nevojshme për vlerësimin e plotë të rreziqeve të mundshme.
- Në rastin e një aktiviteti të ri që sjell praninë e substancave kimike të rrezikshme, vlerësimi i rrezikut të mundshëm nga këto substanca dhe zbatimi i masave të parandalimit programohen paraprakisht. Aktiviteti i ri fillon vetëm pasi ka përfunduar vlerësimi i rreziqeve të mundshme dhe zbatimi i masave të parandalimit.
- Aty ku natyra e aktivitetit të punës nuk mundëson parandalimin në vendin e punës të pranisë së koncentimeve të rrezikshme të substancave të djegshme ose sasi të rrezikshme të substancave kimikisht jo të qëndrueshme, punëdhënësi, në mënyrë të veçantë duhet të evitojë praninë e burimeve të ndezjes që mund të shkaktojnë zjarre dhe eksplozione, ose ekzistencën e kushteve jo të favorshme që mund të provokojnë efekte fizike të dëmshme, për shkak të substancave ose përzierjeve të substancave kimike jo të qëndrueshme; të zvogëlojë, nëpërmjet masave procedurale dhe organizative të parashikuara nga aktet në fuqi, efektet e rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë e punëmarrësve në rast zjarresh ose eksplozionesh të shkaktoar nga substanca ose përzierje të substancave kimikisht jo të qëndrueshme.

Masat në rast zjarri ose emergjence.

- Punëdhënësi, për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e punonjësve nga pasojat e aksidenteve ose të emergjencave të shkaktoara nga prania e substancave kimike të rrezikshme në vendin e punës, ka vendosur procedura të përshtatshme ndërhyrjeje për t'u zbatuar në këto raste.
- Këto masa përfshijnë ushtrime praktike për sigurinë që duhet të kryhen me intervale të rregullta dhe vënien në dispozicion të mjeteve të përshtatshme për ndihmën e shpejtë.
- Në rast zjarri ose emergjencë, punëdhënësi ka marr masa të drejtpërdrejta për të zvogëluar efektet dhe në mënyrë të veçantë asistencën për largimin, evakuimin dhe informimin e punëmarrësve.
- Punëdhënësi merr masa të përshtatshme për të normalizuar situatën sa më parë.
- Punëdhënësi përshtat masat e nevojshme për të përgatitur sistemin e alarmit dhe sisteme të tjera komunikimi të nevojshme për të sinjalizuar menjëherë aksidentin ose emergjencën.
- Masat e emergjencës, të përfshira në plan përmbajnë informacione paraprake mbi aktivitetet e rrezikshme, mbi substancat kimike të rrezikshme, mbi masat e identifikimit të rrezikut të mundshme, mbi masat parandaluese dhe procedurat, në mënyrë të tillë që zyrat kompetente për situatat e emergjencës të mund të përcaktojnë menjëherë procedurat përkatëse dhe masat parandaluese; çdo lloj tjetër informacioni mbi rreziqet e mundshme të shkaktoara ose që mund të shkaktohen nga aksidente ose situata emergjente, përfshirë informacionet mbi procedurat e ndjekura në bazë të këtij neni.
- Në rast zjarri ose emergjence, subjektet e pambrojtura duhet të largohen nga zona menjëherë.

Informimi dhe formimi i punëmarrësve

- Punëdhënësi garanton që punëmarrësit ose përfaqësuesit e tyre të kenë në dispozicion të dhënat e vlerësimit të rrezikut të mundshëm dhe informacione të tjera sa herë që ndryshime të rëndësishme në vendin e punës shoqërohen me ndryshimin e këtyre të dhënave;
- Punëdhënësi garanton informacione mbi substancat kimike të rrezikshme të pranishëm në vendin e punës, ndër të cilët natyrën e substancës, rreziqet e mundshme për sigurinë dhe shëndetin, vlerat e lejuara përkatëse të ekspozimit profesional dhe dispozita të tjera normative që i përkasin substancave kimike;
- Punëdhënësi garanton formimin dhe informacione mbi masat parandaluese dhe veprimet e përshtatshme që duhen zbatuar për mbrojtjen e tyre dhe të punëmarrësve të tjerë në vendin e punës;

- Punëdhënësi garanton konsultimin e çdo skede me të dhënat e sigurisë të vënë në dispozicion nga furnizuesit.
- Punëdhënësi siguron që informacionet të jenë në përputhje me rezultatet e vlerësimit të rrezikut të mundshëm.

Këto informacione mund të përbëhen nga informacione gojore ose nga kurse formimi dhe praktika individuale të integruara me informacione të shkruara, sipas natyrës dhe nivelit të rrezikut të mundshëm të përcaktuar gjatë vlerësimit; të jenë të përditësuara me ndryshimet e kushteve.

4.5 SHËRBIMET E EKOSISTEMIT

4.5.1 Pastrimi i ujit.

Ndër ndikimet më të rëndësishme të projekteve të industrive nxjerrëse janë efektet e tyre në cilësinë e ujit dhe disponueshmërinë e burimeve ujore brenda zonës së projektit. Pasiguritë kryesore janë nëse burimet ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore do të mbesin të pa devijuara, të pa ndotura dhe / apo të përshtatshme për konsum njerëzor (p.sh. ujërat nëntokësore), dhe nëse cilësia e ujërave sipërfaqësore në zonën e projektit do të mbetet e përshtatshme për të mbështetur jetën ujore vendase dhe jetën e egër tokësore. Në varësi të llojit të aktivitetëve nxjerrëse ka ndikime të ndryshme në burimet ujore sipërfaqësore dhe ujore nëntokësore.

Nafta dhe Gazi - ndikimet në burimet ujore në sektorin e naftës dhe gazit gjithashtu mund të ndryshojnë në varësi të proceseve nxjerrëse dhe teknologjisë së përdorur. Aktivitetet e shpimit të naftës dhe gazit mund të shkaktojnë shqetësime, humbje të burimeve të ujërave nëntokësore dhe përkeqësim të cilësisë së ujit. Aktivitetet e eksplorimit mund të përfshijnë injektimin e ujit nën tokë. Ka raste kur uji i injektuar i përdorur në proces është i kripur ose i njelmët. Kjo teknikë mund të çojë në ndikime negative në cilësinë e ujërave nëntokësore, përmes shkaktimit të prurjes së ujit të kripur ose të njelmët. Janë zhvilluar teknika të cilat përdorin ujë të pijshëm ose ujë të trajtuar për injeksion nëntokësor. Sa i përket ndikimeve të mundshme në ujërat sipërfaqësore, derdhjet gjatë proceseve të kërkimit dhe shfrytëzimit mund të çojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe të shkaktojnë ndikime negative në biodiversitetin ujor dhe mjedisin në përgjithësi. Ndikime të tjera në burimet ujore sipërfaqësore nga sektori i naftës dhe gazit lidhen me keqAdministrimin e mbetjeve të hidrokarbureve.⁶⁹

Për të kuptuar sesi aktiviteti i naftës kontribuon në ndotjen e sistemeve ujorë, psh një nga lumenjt si ai Gjanicës dhe Vijën e Ngalës ku derdhen mbetjet hidrokarbure. Treguesi CEE është një tjetër standard për performancën e ujit të pijshëm sipas standardeve të Komisionit ekonomik evropian direktiva 60EC 2000. Ky tregues për lumin Gjanica duke i'u referuar rezultateve të marra në vitin 2022 ka marrë vlerat nga 2.9-10.4, ku vihet re qartazi fenomeni i rënies drastike të cilësisë së ujit menjëherë pas daljes së lumit nga zona e qytetit të Ballshit dhe një përmirësim shumë i vogël në pikë fundorë të bashkimit të lumit Gjanica me lumin e Semanit.

Ujërat janë të ngopura me oksigjen. Nevoja biokimike për oksigjen (NBO5) është i rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së ujërave të lumenjve si një tregues i shkallës së ndotjes, ku stacioni Gj4 – Ura e qytetit Fier ka një përmbajtje të lartë të NBO5, duke e klasifikuar këtë stacion në Klasën IV – Gjendje e Varfër. Referuar vlerave mesatare të amonjakut, vlerësojmë ndotje në stacionin Gj4 – Ura e qytetit Fier

⁶⁹ EITI, (2021). *Raporti Studimor Perfundimtar në fushën e Mjedisit për Industrinë Nxjerrëse*. Marrë nga <https://www.albeiti.org/site/wp-content/uploads/2021/07/al-ab-ba1-albania-eiti-environment-scoping-study-final-report-shqip-firmosur.pdf>, Faqe 63.

duke u klasifikuar në Klasën III – Gjendje e moderuar. Përmbajtja e nitriteve, nitrateve dhe fosforit total i klasifikon stacionet në Klasa I – Gjendje e Lartë. Bazuar mbi përmbajtjen e orto – fosfateve, këto stacione klasifikohen në Klasa II- Gjendje e mirë.

Vlerësojmë se Baseni i Semanit klasifikohet në Klasën IV- Gjendje e varfër me nje ndotje te konstatuar në stacionin Gj4 – Ura e qytetit Fier ku impakti i shkarkimeve urbane dhe industriale është i lartë. Vlerat mesatare të përqendrimit të metaleve në trupën ujore të Lumit Seman Cilësia e ujit të Lumit Seman është e mirë referuar vlerave limite të VKM, por shfaq problem lidhur me përmbajtjen e Cd dhe Pb në rrjedhën e Gjanicës. Vlerat e metaleve janë mbi limitet e rekomanduara nga DKU. Oksigjeni i tretur, mg/l pH NBO5 mg/l NH4 mg/l NO2 mg/l NO3 mg/l PO4 mg/l P-total mg. Stacioni Pishë Poro ka ujë më cilësi jo të mirë. Përmbajtja e NO2, NO3, NH4, Cl, Na dhe Mg, mbetje e thatë e mineralizim i përgjithshëm janë mbi normat e ujit të pijshëm sipas standartit shqiptar në fuqi dhe BE. Pish-Poro Tregues ka tyregrues jo te mire të elementëve kimik si Na, Mg, Cl, NH4 të cilat janë mbi normë, madje shumë të larte, Mth, Mp , Fp, cka e klasifikojnë atë në ujë të papishem, për shkak se pranë këtij akuaferi kemi depërtim të shkarkimeve hidrokarbure.

Ujërat që dalin nga separatori së bashku me lëndët përpunuese të dekantimit, kalojnë në kanal të hapur dhe derdhen direkt në lumin Gjanicë. Separatori ku kalojnë këto ujra është në gjendje pune, por herë pas here do pastruar, për rritjen e efektivitetit.⁷⁰

Fertiliteti i tokës

Studimet e ndryshme të kryera më parë tregojnë se ndotja e tokës mund të ndodhë gjatë punimeve të zakonshme të shpimit për naftë e gaz, nxjerrjes, transportit apo edhe përpunimit të këtyre produkteve, si p.sh. hedhja në vëndë të papërshtatshme e mbeturinave të shpimit, depozitimin e ndotësve të emetuar nga procedura e djegies së gazit, etj. Megjithatë, në shumë studime të kryera në vite, është arritur në përfundimin se: ndotja e tokës shkaktohet kryesisht nga derdhjet aksidentale, qofshin këto të mëdha ose të vogla ose nga veprimtaritë industriale, pasi janë braktisur objektet.

Fusha naftëmbajtëse e Patos Marinzës është nga më të mëdhatë në Europë për sa i takon rezervave të naftës në brendësi të kontinentit. Industria e naftës në zonë nuk është menaxhuar sipas standardeve mjedisore, duke e renditur zonën përkrah rrjetit të vatrave të nxehta mjedisore (hot spote) që kanë nevojë për ndërhyrje dhe rehabilitim. Në këtë zonë është e pranishme ndotja e tokës, ku ekzistojnë rreth 1480 pellgje llumrash naftë, në një sipërfaqe prej rreth 95 ha, duke përbërë edhe një ekspozim të hapur të banorëve ndaj kësaj ndotje.⁷¹

4.5.2 Sasia e naftës që depërton në shtresë në varësi të tipit litologjik

Nafta depërton në tokë nën ndikimin e gravitetit dhe veprimit kapilar: Sasia e naftës që mban toka (mbushje e hapsirave poroze) është përafërsisht 15 deri 40 l/m³, gjë që varet nga struktura e shtresës ku depërton ajo. Shkalla e penetrimit të naftës në tokë varet nga lloji i naftës dhe lloji i tokës. Në praktikë naftat e papërpunuara, si dhe naftat me viskozitet të nuk depërtojnë në thellësi të konsiderueshme në tokë. Edhe naftat e vendit tonë hyjnë në tipet e naftave asfalto – rrëshinore, prandaj nuk priten të depërtojnë në thellësi.

Migrimi nëntokësor i ndotësve të naftës mund të ndikojë në ekspozimin e popullsisë kundrejt këtyre ndotësve, si p.sh.

⁷⁰ Agjencia Kombëtare e Mjedisit. *Raport i gjendjes në mjedis 2023*. Tiranë.

⁷¹ Avokati i Popullit. (2024). *Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe mjedisit nga ndotja e hidrokarbureve në zonën e Patos Marinëz dhe qytetet përreth*. Marrë nga <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/rekomandim%2011%20dhjetor%20%202024%20albpeterl.pdf>, Faqe 12.

- a) Substancat e paqëndrueshme të emetuara nga nafta BTEX;
- b) Komponimet organike të paqëndrueshme VOCs, (këtu përfshijmë benzenin, toluenin, etilbenzenin dhe ksilolin) që migrojnë në drejtim të zonave të banuara dhe mund të depërtojnë në shtëpi dhe të thithen nga banorët.

Ky migrim i naftës dhe hidrokarbureve në përgjithësi në vendet e banuara ku zhillohet kopshtaria mund të çojë në grumbullimin e ndotësve në perimet dhe bimët e tjera të kopshtit, të cilat më pas konsumohen nga njerëzit. Gjatë procesit të shpimit – shfrytëzimit dhe konturimit për naftë e gaz mundësia e ndotjes së tokës është më e vogël. Për realizimin e shpimit të një pusi zihet një sipërfaqe më e madhe toke, por koha e zënies është më e vogël se në rastin e nxjerrjes së naftës. Shpimi i përqëndruar i puseve e ka zvogëluar sipërfaqen e tokës që zihet për shpim apo dhe shfrytëzim të një shtrese naftë – gaz mbajtëse. Gjatë procesit të shpimit të përqëndruar të puseve ndodhin edhe avari, që shkaktojnë ndotje të madhe të mjedisit, siç ishte ajo në Marinez. Mbetjet industriale ku bëjnë pjesë dhe hidrokarburet, të cilët nga ana e tyre mund të trajtohen dhe të degradohen. Ky transformim varet nga ndikimi i temperaturës, presionit, përbërjes së tokës/ajrit/ujit, etj.

4.5.3 Përcaktimi i pjellorisë natyrore të tokës

Ndër zonat më të rrezikshme të gjallesave, në zonat bujqësore janë edhe mbetjet e hidrokarbureve. Si regjistrimet në fushë edhe rezultatet analitike tregojnë një nivel më të lartë të ndotjeve të tokës në grupe se sa në pusët e naftës. Prej nga kupton se tokat në afërsi të puseve janë ndotur mbi një zonë më të pakët dhe në thellësi më të ulët sesa tokat në afërsi të grupeve dhe stacioneve të dekantimit. Po kështu, tokat e stacioneve të dekantimit janë të ndotura në një zonë më të gjerë dhe në thellësi më të madhe sesa tokat e grupeve.

4.5.3.1 Përcaktimi i shkallës së ndotjes së tokës bujqësore

A. VLERËSIMI I TOKAVE BUJQËSORE NË ZONËN NAFTE NXJERRËSE

Tokat e zonave naftë gazmbajtëse paraqesin probleme. Këto toka janë nën trysinë e shfrytëzimit të naftës. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos. për të vazhduar aktivitetin hidrokarbur normalisht gjatë vitit 2022 ka hasur vështirësi, ka pasur nevojë të marrë në përdorim toka bujqësore nga fermerë të ndryshëm. Këto toka janë përdorur për sheshe pusesh (ku ka pasur puse të reja) dhe rrugë hyrje për në puse apo asete të ndryshme ku ka lindur nevoja.

Për nevoja të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos. dhe për të mundësuar aktivitetin normal të Qendrave të Prodhimit të Naftës për vitin 2022 janë lidhur dhe zbatuar 15 kontrata të marrjes së tokës bujqësore fermerëve të ndryshëm në përdorim të përkohshëm. Kanë dalë 12 Urdhra për likuidimin e vitit 2022 me vlerë totale 1,595,318 lekë, sipas Aneksi 2.3.1 bashkëlidhur Projekt Raport Auditimit.

Gjatë vitit 2022 janë kryer procedurat e zhdëmtimeve bujqësore si pasojë e avarive të ndryshme të ndodhura në Q.P.N. dhe QASHNG sipas Rregullores së Zhdëmtimeve Bujqësore që disponojmë, komfor ligjit Nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore” dhe Ligjit Nr.10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.

Nga përllogaritjet e bëra në akt - vlerësimet për fitimin e munguar bujqësor për këtë vit kanë dalë 12 “Urdhra” për 35 fermerë me një shpenzim total prej 2,912,444 lekësh, nga 8 000 000 lekë të planifikuara për vitin 2022. Në këtë shumë të shpenzuar për vitin 2022 përfshihen edhe dëmtime të tokave bujqësore të shkaktuara nga avari të ndodhura në fund të vitit 2021.

Konkretisht për dëmshpërblimet financiare të tokave dhe kulturave bujqësore për vitin 2021 kanë dale 3 urdhra në 6-mujorin e parë të 2022 për të likuiduar 5 fermerë me një shumë totale 385,622 lekë. Ndërsa

për zhdëmtime bujqësore nga avari të ndodhura në vitin 2022 kanë dale 9 urdhra për te dëmshpërblyer 30 fermerë me një shumë prej 2,526,822 lekë, sipas Aneksi 2.3.2 bashkëlidhur Projekt Raport Auditimit. Faktorët kryesorë që kanë diktuar këto shpenzime për zhdëmtime bujqësore janë kryesisht avari të ndodhura nga çarje të magjistralit të naftës sidomos në periudhën e dimrit për shkaqe të ndryshe teknologjike, rrjedhje gropash avarie dhe sepëratorëve, çlirimi i gazit në dekantime dhe grupe zëvendësime të pjesshme të tubacioneve të transportit të naftës, shkarjet e dherave si rezultat i terrenit kodrinor, sjellin për pasojë zhvendosje e shkëputje të tubacioneve të naftës e gazit, si dhe për shkak të amortizimit dhe korodimit të tubacioneve të transportit të naftës.

Kryerja e proceseve për eliminimin e avarive ka kërkuar kalimin e mjeteve të rënda nga ana e Qendrave duke shkaktuar dëmtimin e tokave, kulturave bujqësore dhe drufrutorëve të fermerëve. -Duhet theksuar fort se Qendra e Prodhimit më problematikë përsa i përket avarive të shkaktuara dhe dëmet financiare që i shkaktohen kompanisë Albpetrol është QPN Fier, dhe më konkretisht Sektori Cakran -Mollaj. Shkaqet e këtyre dëmtimeve kanë ardhur si pasojë e amortizimeve të mëdha që kanë linjat e transportit të fluidit nga qendrat Nr 38, Nr 59, Nr 29, drejt Qendrës Nr 17, ku bëhet dhe grumbullimi i fluidit të këtij vendburimi naftë. Gjithashtu ngelet një problem shqetësues permanent edhe linja e transportit të fluidit nga Qendra Nr.17 drejt dekantimit Usojë. Duhet theksuar se zëvendësimet e pjesshme nuk e kanë zgjidhur situatën duke shkaktuar humbje të fluidit, kosto shtesë për zhdëmtimet e fermerëve, si dhe penalitetet e vendosura nga ISHPMUT Fier.⁷²

Pjelloria aktuale e këtyre tokave ka ardhur gjithmonë e në rënie. Një nga faktorët e këtij degradimi është shfrytëzimi i naftës në më shumë se 33,000 ha. Këto toka kanë një variabilitet të lartë të pH, vlerat e të cilit janë nga (7.2 deri 8.50), duke i klasifikuar ato me karakter neutral deri në alkaline.

Gjithashtu treguesit e përmbajtjes së Ni në të gjitha këto toka është relativisht e lartë. Përmbajtja e tij është në vlera 215.9 deri 284 mg/kg, çka tregon për nivele toksike të përmbajtjes së këtij elementi në tokë. Përmbajtja e elementit plumb (Pb), konstatohet se në këto toka janë në nivele të konsiderueshme, por që nuk arrijnë vlera të larta të pranueshme nga BE. Lidhur me përmbajtjen e hidrokarbureve në tokë konstatohet se ajo paraqitet në vlera të larta që variojnë nga 117.2 deri 454.3 mg/në 100 gr.

Mendojmë se në zonën naftëmbajtëse përmbajtja e lartë e metaleve të rënda (Ni,Vn dhe Pb) ndikojnë në ndotjen e tokës. Për më tepër, analizimi edhe i hidrokarbureve në këtë zonë, e cila rezulton me përqëndrim të lartë, e përforcon akoma më shumë kokluzionin për influencën e veprimtarisë naftënxjerrëse në ndotjen e tokës të kësaj zone.

B. VLERESIMI PEDOLOGJIK DHE AGRONOMIK I TOKAVE NE ZONEN STUDIMORE

Tokat në vend burimin Patos – Marinëz psh, ku është bërë vleresimi pedologjik dhe agronomik, në drejtimin lindje-perëndim fillojnë në afërsi të Roskovecit dhe përfundon në bregdet, ndërsa në drejtimin jug – veri, këto toka fillojnë në kufirin Patos-Visok dhe përfundojnë në hapësirën midis dy krahëve të lumit Seman e Vjosë. Sipërfaqja tokësore e përmendur më sipër është një zonë, ku aktiviteti industrial më kryesor është ai i nxjerrjes së naftës dhe gazit, përfshirë edhe ndikimet e aktiviteteve të mëparëshme të uzinave të prodhimit të plehrave azotike dhe tani ato të tecit të Fierit. Sipërfaqja e zonës është në rreth 50,000 ha, nga të cilat rreth 23,000ha janë nën ndikimin direkt të vendburimeve të naftës. Çdo pus zë një sipërfaqe kufizuese nga 800 deri 900m², ndërsa një grup grumbullimi naftë arrin nga 3000 m² deri 5000 m² tokë.

Brenda kufirit të kësaj zone, sipërfaqet e tokave të kultivuar me bimë bujqësore kanë ardhur vazhdimisht duke u ulur. Ky fenomen është jo vetëm rezultat i efektit dhe ndikimit, që ka dhe luan aktiviteti i

⁷² Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2023). *Raport përfundimtar i auditimit të përputhshmërisë të ushtruar në Albpetrol sh.a Patos*. Tiranë, Faqe 109-110.

shfrytëzimit të naftës, por edhe i efektit kufizues i kripës në tokat në afërsi të bregdetit por edhe më gjerë. Për të dhënë një ide të qartë të karakterizimit të tokave në këtë zonë, është e rëndësishme të bëhet një vlerësim i përgjithshëm i karakteristikave pedologjike, agronomike përfshirë edhe treguesit fizik dhe ujore.

Mjedisi: Këto toka përfshihen në zonën klimatike mesdhetare qendrore fushore dhe kanë reliev të sheshtë, ku bimësia është e ndryshme dhe përfaqësohet nga graminoret dhe shkurret.

Ndërtimi i profilit. Profili është i tipit A-C. Në Roskovec psh., shtresëzimi është:

horizonti Ap nga 0 deri 31 cm, horizonti Cg1 nga 31 deri 53 cm, horizont Cg2 nga 53 deri 63 cm, horizont Cg3 nga 63 deri 72 cm dhe horizont Cg4 nga 72 deri 102 cm.

Në Marinz profili është i tipit A-C horizonti Ap nga 0 deri 20 cm, horizonti C1 nga 20 deri 41 cm, horizont C2 nga 41 deri 58 cm, horizont C3 nga 58 deri 86 cm dhe horizont Cg4 nga 86 deri 130 cm.

Veçoritë hidrologjike: Këto toka paraqesin veti përshkuese të ujit në nivel mesatar. Konduktiviteti hidraulik është me vlera mesatare dhe në vartësi të shtresave. Kanë kapacitet ujëmbajtës mesatar, e lëshojnë ujin me lehtësi, prandaj gjatë kohës së thatë është e domosdoshme ujitja e bimëve. Kapaciteti ujqor fushor varion nga 21 deri 31% dhe lagështia produktive është 127 dhe 16,4%, përshkueshmëria nga 1,25 deri 0.26mm/minut.

Veçoritë fizike: Janë toka të ndjeshme ndaj kompakticitetit (ngjeshjes), dhe në thellësi të ndryshme të profilit takohen shtresa të çimentuara, të pa përshkueshme. Kjo dukuri haset pothuajse në të gjitha tokat. Në përgjithësi janë toka me porozitet, që ndryshon në kufij të gjerë, ku dominojnë mikroporet. Janë të ajrosura mesatarisht. Fraksionet e rërës janë në kufijt nga 74% në horizontet e para deri në 44% në horizontin e fundit, lymi nga 29% në 37% dhe argjilat nga 60% deri 18%.

Në Marinëz - fraksionet e rërës janë në vlera nga 46% në horizontet e sipërme deri në 45% në horizontin e poshtëm, lymi është në vlerat nga 33% në horizontet e sipërme deri në 32% në horizontin e poshtëm, argjila është në vlerat nga 27% në horizontet e sipërme deri në 36% në horizontin e poshtëm.

Skemë që pasqyron ecurinë e përmbajtjes së kadmiumit sipas matjeve të kryera më dt 14.01 2022, prej nga tërheqim konkluzionin se ky element arrin të akpë vlerën 4-10 herë më të lartë se pragu i ndotjes në tokat pranë aktivitetëve të naftës.

4.6 NDIKIMI MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE

Spektori i naftës ka një ndikim të konsiderueshëm në ndryshimet klimatike për shkak të emetimeve të gazeve me efekt serrë që lidhen me nxjerrjen, përpunimin dhe përdorimin e naftës. Gjatë nxjerrjes së naftës, shpesh ndodhin rrjedhje të metanit, një gaz me efekt ngrohjeje shumë më të fortë se dioksidi i karbonit, i cili kontribuon në ngrohjen globale. Për më tepër, proceset e rafinimit dhe përpunimit të naftës janë burim i emetimeve të ndryshme të gazeve që ndotin atmosferën. Në zonat ku zhvillohet aktiviteti naftëror, cilësia e ajrit është shpesh e rënduar për shkak të pranisë së pluhurave të imët PM10 dhe PM2.5, si dhe të komponimeve organike të avullueshme, benzenit dhe oksideve të azotit. Këta ndotës janë të dëmshëm për shëndetin e banorëve dhe ndikojnë në formimin e ozonit troposferik, i cili gjatë periudhave me rrezatim të lartë diellor, si në verë, arrin nivele shqetësuese në ajër. Gjithashtu, emetimet e dioksidit të squfurit (SO₂) në këto zona shkaktojnë formimin e grimcave sulfat, të cilat ndikojnë jo vetëm në ndotjen e ajrit, por edhe në proceset klimatike duke reflektuar dritën diellore dhe ndikuar në temperaturën e atmosferës.

Për të minimizuar ndikimin negativ të sektorit të naftës, është e nevojshme të ketë masa strikte për monitorimin dhe reduktimin e emetimeve, duke përfshirë përdorimin e teknologjive për kapjen e metanit,

kontrolle të vazhdueshme të cilësisë së ajrit dhe standarde mjedisore të larta për rafineritë dhe aktivitetet e nxjerrjes së naftës. Informimi dhe ndërgjegjësimi i komuniteteve lokale janë po ashtu pjesë e rëndësishme e strategjive për mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit. Në përmbljedhje, aktivitetet në zonën e naftës janë ndër burimet kryesore të emetimeve të gazeve me efekt serrë dhe ndotësve atmosferikë, duke kontribuar në ndryshimet klimatike dhe përkeqësimin e cilësisë së ajrit, dhe kërkojnë vëmendje të vazhdueshme për menaxhimin dhe reduktimin e ndikimit të tyre.

4.6.1 Vlerësimi i përputhshmërisë së projekteve të naftës me angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare për klimën.

Projektet e naftës, si burim i rëndësishëm i energjisë, përballen me sfida serioze në përputhshmërinë me objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë dhe luftën kundër ndryshimeve klimatike. Në kuadër të angazhimeve të vendit, si dhe në kuadër të Marrëveshjes së Parisit dhe mekanizmave të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (PNNK), Shqipëria ka vendosur objektiva për reduktimin e emetimeve dhe promovimin e burimeve të energjisë së pastër.

Në këtë kontekst, aktivitetet e naftës duhet të rregullohen dhe monitorohen strikt për të reduktuar emetimet e gazrave si CO₂ dhe metan, që janë burim kryesor i ndryshimeve klimatike. Pa një menaxhim të kujdesshëm dhe përdorim të teknologjive të avancuara për minimizimin e emetimeve, projektet e naftës mund të jenë në kundërshtim me këto angazhime.

Nga ana tjetër, pyjet luajnë një rol kyç në balancën klimatike të vendit duke funksionuar si sekuestrues natyral të karbonit. Sipas Raportit të Gjendjes në Mjedis 2023, pyjet tona stokojnë rreth 100.9 milion ton karbon, nga të cilat 80% ruhen në tokën pyjore dhe 20% në biomasën pyjore. Pyjet trungisht janë më efikase në kapjen e karbonit, ku pyjet fletorë kontribuojnë me 51% të këtij stokimi dhe pyjet halorë me 27%. Kjo tregon se mbrojtja dhe zgjerimi i sipërfaqeve pyjore janë strategji të rëndësishme për përmbushjen e angazhimeve klimatike.

Prandaj, për të arritur qëllimet klimatike, është thelbësore që projektet e naftës të integrohen me politika që promovojnë ruajtjen dhe zgjerimin e pyjeve si një mënyrë natyrale për të balancuar emetimet e gazrave serrë. Një qasje gjithëpërfshirëse që bashkon reduktimin e emetimeve nga sektori i naftës dhe ruajtjen e ekosistemeve pyjore mund të ndihmojë Shqipërinë të përmbushë në mënyrë efektive angazhimet e saj kombëtare dhe ndërkombëtare për klimën.

4.6.2 Burimet ujore lokale

Vlerësimi i ndikimit të nxjerrjes dhe përpunimit të naftës mbi resurset ujore lokale - Nxjerrja dhe përpunimi i naftës kanë një ndikim të konsiderueshëm negativ mbi cilësinë dhe sasinë e resurseve ujore në zonat ku zhvillohen këto aktivitete. Bazuar në studimet dhe matjet hidrologjike në zonat naftëgazmbajtëse të rajonit në studim, është konstatuar se lëvizja e ujrave nëntokësorë përkon me atë të ujrave sipërfaqësorë, duke rrjedhur kryesisht nga lindja në perëndim. Kjo drejtim është po ashtu i lidhur me pjerrësinë e shtresave gjeologjike, të ndikuara nga forcat tektonike dhe neotektonike.

Ndotja e ujërave nëntokësorë dhe sipërfaqësorë - Proceset industriale dhe shkarkimet e mbetjeve nga aktivitetet e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës, sidomos në kompleksin industrial të Fierit, kanë shkaktuar kontaminim serioz të ujërave nëntokësorë dhe lumenjve që kalojnë nëpër këto zona. Në ujërat shtresore dhe lumenjtë Vjosë dhe Kanali i Ngjalës janë evidentuar përqendrimet e larta të substancave toksike si fenol, bora dhe përbërës tensioaktivë me karakter toksik (separol, propalit, servo), që kanë ndikim negativ në cilësinë e ujit dhe vetëpastrimin natyral të lumenjve.

Ndikimi në mjedisin ujq dhe jetën e banorëve - Përmbajtja e substancave toksike në ujë ka dëmtuar faunën dhe florën ujore, duke shkaktuar pasoja ekologjike të rëndësishme. Për më tepër, ujërat e kontaminuar përdoren për vaditje në bujqësi dhe për ujitjen e kafshëve, duke përbërë rrezik për shëndetin e njerëzve dhe kafshëve. Evidencat tregojnë se ndotja ka depërtuar edhe në ujërat nëntokësorë shumë afër sipërfaqes. Vlerësohet se rreth 117 km trupa ujore janë të ndotura nga substancat/polimeret e naftës, me pasoja direkte për cilësinë e ujit të pijshëm në zonat përreth. Në të përfshihen ujërat e lumit Gjanicë, Seman dhe përrenjeve të zonës. Kjo gjëndje e ujërave përbën rrezik direkt për zinxhirin ushqimor bujqësor, si pasojë e përdorimit të ujit për ujitjen e tokave.⁷³

Ndotja në detin Adriatik - Ndotja e lumenjve përhapet deri në detin Adriatik, ku shtresat e naftës në sipërfaqen ujore dhe rërën e bregut paraqesin një shqetësim serioz për turizmin dhe ekosistemin detar. Gjendja është përkeqësuar nga prania e peshqve të ngordhur në breg, që pasqyrojnë nivelin e lartë të ndotjes dhe ndikimin toksik të përbërësve naftë në habitatet detare. Cd dhe Pb janë dy elementë që bashkëshoqërojnë industrinë nxjerrëse dhe përpunuese të naftës. Shkarkimet historike të Semanit në Detin Adriatik dhe depërtimi i tyre në ujin e Lagunës së Karavastasë mund të jetë shkak për kontaminimin e ujërave.⁷⁴

4.7 NDIKIMI SOCIAL

Industria e naftës ka një ndikim të rëndësishëm në aspektet sociale të zonave ku zhvillohet aktiviteti i saj. Nga ana e punësimit, kjo industri ofron mundësi të shumta për punë, duke përfshirë punonjës teknikë, inxhinierë dhe personel mbështetës, çka ndihmon në zhvillimin ekonomik të komuniteteve lokale. Megjithatë, kushtet e punës shpesh janë të rrezikshme për shëndetin e punonjësve, për shkak të ekspozimit ndaj ndotësve toksikë si hidrogjeni sulfhidrik dhe hidrokarburet, të cilët shkaktojnë sëmundje kronike që ndikojnë në aftësinë për punë dhe cilësinë e jetës.

Marrëdhëniet me komunitetin shpesh përballen me sfida për shkak të ndotjes së mjedisit, e cila ndikon drejtpërdrejt në shëndetin dhe mirëqenien e banorëve përreth. Probleme të tilla si sëmundjet respiratore, çrregullimet nervore, dhe dëmtimet e lëkurës janë të përhapura, duke sjellë një ngarkesë shtesë në sistemin shëndetësor dhe duke ulur cilësinë e jetës në komunitet. Në mungesë të një dialogu të mirëfilltë dhe të përfshirjes së banorëve në vendimmarrje, ndodh që marrëdhëniet sociale të tensionohen dhe besimi ndaj kompanive dhe institucioneve të ulët.

Shëndeti i punonjësve dhe i popullatave lokale është i kërcënuar nga ndikimet afatgjata të ndotjes, ku shfaqen sëmundje serioze si encefalopatia toksike, sëmundjet kronike të aparatit respirator, dëmtimet e dëgjimit dhe dermatitet profesionale. Këto probleme shëndetësore ndikojnë jo vetëm në punëtorët, por edhe në familjet dhe komunitetet e tyre, duke u shoqëruar shpesh me stres dhe probleme sociale.

Për të reduktuar këto ndikime negative sociale, është e nevojshme të zbatohen masa mbrojtëse dhe të bëhet monitorim i vazhdueshëm shëndetësor i punonjësve, si dhe të rritet përfshirja e komuniteteve në vendimmarrje. Një vlerësim i mirëplanifikuar i ndikimeve mjedisore dhe sociale mund të ndihmojë në identifikimin dhe minimizimin e rreziqeve, duke kontribuar në një zhvillim të qëndrueshëm dhe në mirëqenie afatgjatë për të gjithë palët e përfshira.

⁷³ Avokati i Popullit. (2024). *Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe mjedisit nga ndotja e hidrokarbureve në zonën e Patos Marinëz dhe qytetet përreth*. Marrë nga <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/rekomandim%2011%20dhjetor%20%202024%20albpeterl.pdf>, Faqe 12.

⁷⁴ Agjencia Kombëtare e Mjedisit. *Raport i gjendjes në mjedis 2023*. Tiranë.

4.7.1 Punësimi dhe mundësitë për punë lokale

Industria e naftës në Shqipëri ka qenë historikisht një burim punësimi për mijëra banorë të zonave rurale dhe periferike, veçanërisht në Patos-Marinzë, Ballsh, Kuçovë, dhe zona të tjera naftëmbajtëse. Gjatë viteve 2014–2024, sektori ka përjetuar ulje-ngritje të vazhdueshme në punësim, për shkak të ndryshimeve në pronësinë e kompanive, uljes së prodhimit dhe vështirësive ekonomike.

Të dhënat për periudhën 2014–2023 tregojnë një rënie të ndjeshme dhe të qëndrueshme të numrit të të punësuarve në sektorin e naftës në Shqipëri. Nga 3,746 punonjës të regjistruar në vitin 2014, ky numër është reduktuar në 2,462 në vitin 2023, duke reflektuar një tkurrje prej mbi 34%. Kjo është një prej tendencave më të forta negative të punësimit në sektorët industrialë në Shqipëri dhe shërben si indikator për transformimet që po kalon industria e naftës në vend.

Rënia e vazhdueshme e nivelit të punësimit në sektorin e naftës në Shqipëri gjatë dekadës së fundit është rezultat i një sërë faktorësh strukturore dhe zhvillimesh të brendshme e të jashtme. Së pari, një ndër shkaqet themelore ka qenë shterimi natyror i disa fushave naftëmbajtëse, që ka çuar në uljen graduale të intensitetit të operacioneve të nxjerrjes. Si rrjedhojë, është reduktuar ndjeshëm kërkesa për fuqi punëtore, veçanërisht në nivelet bazë të aktivitetit operativ.

Së dyti, mungesa e investimeve të reja, veçanërisht në aktivitetet e kërkimit dhe zbulimit të fushave të reja, ka ndikuar thelbësisht në ngushtimin e hapësirave për rritje të punësimit. Pas vitit 2016, investimet kapitale në sektorin e naftës janë tkurrur ndjeshëm, duke frenuar projekte të reja dhe duke ndaluar hapjen e vendeve të reja të punës.

Një tjetër faktor me ndikim të drejtpërdrejtë është zhvillimi i teknologjisë dhe përhapja e automatizimit në proceset e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës. Këto zhvillime, ndonëse rrisin efikasitetin dhe sigurinë, kanë reduktuar në mënyrë të konsiderueshme nevojën për punë manule apo operacionale, duke ndikuar negativisht në nivelin e përgjithshëm të të punësuarve.

Gjithashtu, ndryshimet në qasjen e politikave publike, të cilat janë orientuar gjithnjë e më shumë drejt sektorëve me ndikim më të ulët mjedisor, si energjitë e rinovueshme, kanë bërë që sektori i naftës të humbasë prioritetin në strategjitë zhvillimore dhe financimin publik apo ndërkombëtar. Ky ri-orientim ka ulur interesin dhe mbështetjen për zhvillimin afatgjatë të industrisë tradicionale të hidrokarbureve.

Së fundi, dalja nga tregu ose reduktimi i pranisë së disa kompanive të huaja, që historikisht kanë qenë kontribuesit më të mëdhenj në punësim dhe investime ka lënë një boshllëk të madh në sektor, që nuk është zëvendësuar në mënyrë të mjaftueshme nga kapitali vendas apo projektet e reja. Kjo ka sjellë jo vetëm reduktim të aktiviteteve operacionale, por edhe humbje të drejtpërdrejtë të vendeve të punës, veçanërisht në zonat ku këto kompani kanë pasur ndikim të rëndësishëm ekonomik dhe social.

Në funksion të adresimit të rënies së punësimit në sektorin e naftës dhe për të garantuar një tranzicion të qëndrueshëm në tregun e punës, rekomandohet hartimi i politikave të posaçme për mbështetjen e punonjësve ekzistues. Këto politika duhet të përfshijnë skema trajnimi dhe ri-kualifikimi profesional, që do të mundësonin kalimin e tyre drejt sektorëve alternativë me potencial punësimi më të lartë.

Gjithashtu, duhet të inkurajohen investimet që përfshijnë komponentë sociale të fortë, ku punësimi lokal të jetë një nga kriteret prioritarë për dhënien e licencave apo përfitimin e lehtësirave fiskale. Në këtë kuadër, krijimi i mekanizmave për monitorimin e vazhdueshëm të tregut të punës në industrinë e naftës është jetik, për të identifikuar në kohë reale tendencat, nevojat dhe mungesat strukturore. Kjo do të ndihmonte në formulimin e politikave proaktive dhe ndërhyrjeve efektive që mbështesin jo vetëm ruajtjen e punësimit ekzistues, por edhe përshtatjen me zhvillimet afatgjata të sektorit energjetik dhe ekonomik.




Figure 16. Grafiku numri i të punësuarve gjithsej në sektorin e naftës në Shqipëri (2014-2023) sipas të dhënave të marra nga INSTAT.

Viti	Të punësuar gjithsej (nr. mes. vjet.)
2014	3,746
2015	3,705
2016	3,385
2017	3,514
2018	3,121
2019	2,655
2020	2,561
2021	2,545
2022	2,438
2023	2,462

Table 25. Numri i të punësuarve gjithsej në sektorin e naftës në Shqipëri (2014-2023) sipas të dhënave të marra nga INSTAT.

ANALIZË KRAHASUESE E PUNËSIMIT SIPAS GJINISË NË SEKTORIN E NAFTËS DHE GAZIT (2019–2023) (ALBPETROL)

Gjatë periudhës pesëvjeçare 2019–2023, të dhënat e punësimit në sektorin e naftës dhe gazit në Shqipëri tregojnë një prani dominuese të punonjësve meshkuj në krahasim me femrat. Sektori ka ruajtur një strukturë punësimi ku meshkujt përbëjnë mesatarisht rreth **86.6%** të fuqisë punëtore, ndërsa femrat përfaqësojnë vetëm 13.2%. Ky disproporcion gjinor është një tregues i fortë i karakterit tradicionalisht mashkullor të industrisë së hidrokarbureve, e cila historikisht ka qenë më pak tërheqëse dhe më pak e

aksesueshme për gratë, për shkak të natyrës teknike, fushave të punës me intensitet fizik dhe kulturës organizative të ndërtuar mbi role më konvencionale gjinore.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve ka shënuar luhatje të moderuara gjatë kësaj periudhe, por struktura gjinore mbetet gati e pandryshuar. Për shembull, në vitin 2019 ishin të punësuar 2,610 persona në total, prej të cilëve 87.1% meshkuj dhe 12.8% femra. Në vitin 2023, ndonëse numri total i të punësuarve u rrit lehtë në 2,471, raporti gjinor mbeti pothuajse i njëjtë, me 86.5% meshkuj dhe 13.5% femra. Kjo sugjeron se nuk ka pasur një përmirësim domethënës në drejtim të barazisë gjinore në këtë sektor.

Përfshirja e kufizuar e grave në këtë industri mund të lidhet me disa faktorë kyç:

- Ndarja gjinore në arsim: Profesionet e lidhura me industrinë e naftës (si inxhinieria gjeologjike, mekanike, e naftës etj.) janë më të frekuentuara nga burrat, duke ndikuar direkt në strukturën e rekrutimeve.
- Kushtet e vështira të punës: Shumë prej pozicioneve kërkojnë punë në terren, në zona të thella apo me kushte të vështira klimaterike dhe logjistike, çka shpesh kufizon përfshirjen e grave.
- Kultura organizative dhe mungesa e politikave mbështetëse gjinore: Mungesa e mekanizmave të brendshëm që nxisin përfshirjen e grave në rolet teknike dhe menaxheriale ka bërë që sektori të mos arrijë balancë gjinore.

Ekzistojnë mundësi konkrete dhe të realizueshme për të nxitur përfshirjen më të gjerë të grave në sektorin e industrisë. Rritja e pjesëmarrjes së tyre mund të arrihet përmes politikave të mirëstrukturuara që synojnë fuqizimin gjinor. Ndërhyrjet duhet të fokusohen fillimisht në nxitjen e edukimit të vajzave dhe grave në fushat teknike dhe të inxhinierisë, duke ofruar bursa të dedikuara dhe zhvilluar fushata ndërgjegjësimi për të thyer stereotipet gjinore.

Një instrument tjetër i domosdoshëm është vendosja e kuotave gjinore, veçanërisht në proceset e rekrutimit apo në pozicione vendimmarrëse, për të garantuar përfaqësim më të drejtë. Po aq e rëndësishme është krijimi i kushteve të përshtatshme për gratë që punojnë në terren, si dhe mbështetja përmes politikave sociale e familjare, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në balancimin e jetës profesionale dhe asaj personale. Këto masa përbëjnë një hap të domosdoshëm drejt ndërtimit të një sektori më gjithëpërfshirës, të drejtë dhe socialisht të qëndrueshëm.

Një barazi më e mirë gjinore në sektorin e naftës dhe gazit nuk është vetëm një çështje drejtësie sociale, por edhe një mundësi për të përfituar nga një fuqi punëtore më e larmishme dhe më inovative, çka është jetike për zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të industrisë.




Figure 17. Grafik. Punësimi sipas gjinisë në sektorin e naftës dhe gazit (2019–2023) sipas të dhënave të marra nga DPT.

Viti	Meshkuj	Femra	Totali	% Femra
2019	2,275	335	2,610	12.8%
2020	2,096	316	2,412	13.1%
2021	2,182	333	2,515	13.2%
2022	2,134	326	2,460	13.3%
2023	2,138	333	2,471	13.5%

Table 26. Punësimi sipas gjinisë në sektorin e naftës dhe gazit (2019–2023) sipas të dhënave të marra nga DPT.




Figure 18. Përqindja e të punësuarve femra dhe meshkuj në sektorin e naftës dhe gazit ndër vite (2019–2023).

Përqindja e të punësuarve në sektorin e naftës dhe gazit (2019-2023)




Figure 19. Përqindja e të punësuarve femra dhe meshkuj ne sektorin e naftes dhe gazit per vitet 2019-2023 (total).

4.7.2 Praktikrat e punës në sektorin e naftës

Praktikat e punës në sektorin e naftës përfshijnë një sërë masash dhe rregullash të cilat synojnë sigurinë, shëndetin e punonjësve dhe mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Bazuar në ligjin Nr. 53/2020 dhe ndryshimet e tjera të ligjeve për mbrojtjen e mjedisit dhe lejet mjedisore, kompanitë që operojnë me leje mjedisore të kategorive A dhe B janë të detyruara të hartojnë dhe dorëzojnë raporte për menaxhimin e riskut në qendrat ku ushtrojnë aktivitetin e tyre të kërkimit dhe nxjerrjes së naftës dhe gazit. Këto raporte janë pjesë e detyrimeve të vetmonitorimit dhe kontribuojnë në sigurimin e një ambienti pune të sigurt dhe të qëndrueshëm.

Në kuadër të sigurisë në qendrat e punës, kuptimi i "qendrës së punës" përfshin të gjithë aktivitetet e zhvilluara gjatë kërkimit dhe nxjerrjes së hidrokarbureve. Koordinator i përgjegjës për realizimin e punimeve ka detyrë të monitorojë dhe verifikojë zbatimin e rregullave të sigurisë dhe shëndetit, si dhe aplikimin korrekt të procedurave të punës sipas planit të sigurisë dhe koordinimit. Ky plan përbën një dokument plotësues dhe detajuar i rregullores së raportit të sigurisë dhe duhet të përditësohet dhe verifikohet rregullisht për të garantuar përputhshmërinë me kërkesat ligjore.

Për të siguruar një mjedis pune të sigurt, organizohen mbledhje të Këshillit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë çdo tre muaj, si dhe mbledhje të jashtëzakonshme në rast aksidentesh apo emergjencash. Në këto mbledhje bashkëpunojnë punonjësit dhe menaxhmenti për të koordinuar aktivitetet dhe për të informuar në mënyrë reciproke. Punëdhënësi ka përgjegjësinë të monitorojë përdorimin e pajisjeve të punës dhe të pajisjeve mbrojtëse personale, si dhe të sigurojë kushte të përshtatshme pune dhe higjienike në qendër.

Një aspekt i rëndësishëm është edhe planifikimi operativ i sigurisë, i cili përfshin zgjedhjen e vendndodhjes së pozicioneve të punës, përcaktimin e rrugëve të qarkullimit dhe menaxhimin e depozitimit të materialeve, veçanërisht të substancave të rrezikshme. Mirëmbajtja dhe kontrolli i pajisjeve janë të rregullta dhe kryhen para fillimit të punës, për të eliminuar çdo defekt që mund të rrezikojë sigurinë e punonjësve.

Në kuadër të parandalimit të aksidenteve dhe menaxhimit të emergjencave, kompanitë e naftës nënkontraktajnë ekspertë të specializuar për hartimin e planeve të menaxhimit të situatave emergjente që mund të lindin gjatë funksionimit të pajisjeve të tyre. Qëllimi kryesor i këtyre planeve është mbrojtja e

mjedisit dhe jetës së punonjësve, si dhe krijimi i kushteve optimale për zhvillimin e aktivitetit. Ekspertët hartojnë skenarë të ndryshëm të avarive dhe emergjencave, duke përcaktuar masat e nevojshme dhe grupet përgjegjëse për reagimin, restaurimin dhe rigjenerimin e zonës së prekur.

Karakteristikat bazë të këtyre emergjencave mund të lidhen me faktorë teknologjikë, natyrorë ose të kombinuar, si goditje sizmike, rrëshqitje dhe ose përmytje. Për shkak të rrezikut të lartë që këto situata paraqesin për mjedisin dhe popullatën, masat paraprake dhe reagimet duhet të jenë të shpejta dhe të sakta për të mbrojtur jetën dhe për të minimizuar dëmet. Për më tepër, në zhvillimin e punimeve në sipërfaqe merret parasysh ndikimi minimal mbi ujrat sipërfaqësore dhe nëntokësore, ndërkohë që përpunimi i objekteve bëhet në përmasa të kufizuara, për të minimizuar rreziqet.

Në përgjithësi, praktikat në sektorin e naftës duhet të jenë në përputhje të plotë me ligjet dhe rregulloret shqiptare dhe të sigurojnë jo vetëm një ambient pune të sigurt për punonjësit, por edhe mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të industrisë.

4.7.3 Standardet e sigurisë në vendin e punës

Industria e naftës në Shqipëri, që përqendrohet kryesisht në zonat e Patos-Marinzës, Ballshit dhe Kuçovës, ka qenë historikisht një ndër sektorët më të rrezikshëm për punëtorët, për shkak të teknologjive të vjetruara, menaxhimit të pamjaftueshëm të rrezikut dhe mungesës së investimeve në mbrojtjen teknike dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit.

Gjatë periudhës 2014–2024, standardet e sigurisë kanë shfaqur një zhvillim të ngadaltë dhe të fragmentuar. Ndërsa në letër Shqipëria ka përafruar legjislacionin e saj me direktivat e Bashkimit Evropian për sigurinë dhe shëndetin në punë, në praktikë ka pasur mungesë të zbatimit dhe monitorimit të rregullt. Sipas të dhënave të Institutit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë sektori i energjisë dhe minierave përfshihet si ndër më problematikët. Puna në fushat e nxjerrjes së naftës përfshin rreziqe si shpërthime, rrëshqitje në pusët e hapura, ekspozim ndaj gazrave toksikë (si H₂S), dhe ndotje të rëndë të mjedisit që prek edhe shëndetin e punonjësve.

Gjatë vitit 2022 kanë ndodhur 4 aksidente në punë, ku shoqëria Albpetrol nëpërmjet Drejtorisë dhe specialisteve përkatës ka ndjekur gjithë procedurat ligjore dhe ka bërë analiza të detajuara për çdo rast aksidenti. Në këto aksidente njëri ka përfunduar me humbje jete, nëse ne tre të tjerët punonjësit janë dërguar për të marrë kontrollin e specializuar.⁷⁵

Përpyekjet për përmirësim janë intensifikuar sidomos pas vitit 2019 me krijimin e më shumë strukturave të kontrollit të brendshëm në kompanitë naftënxjerrëse, por mungon një sistem efektiv i raportimit dhe auditimit të sigurisë. Për më tepër, mungojnë inspektime të rregullta të pavarura dhe shpesh kompanitë shmangin përgjegjësinë për aksidentet duke mos zbatuar kompensime të plota për punëtorët.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos, specialistet përkatës kanë punuar vazhdimisht për mbarëvajtjen e punës dhe zbatimin e rregullave të sigurimit teknik, ruajtjes së shëndetit dhe mbrojtjes së mjedisit. Puna në këtë vit është përqendruar në këto drejtime kryesore:

- Janë kryer inspektime mbi gjendjen mjedisore përcaktimin e hotspotëve mjedisore dhe evidentimin e problematikave të lidhura me sigurinë në punë.
- Janë bërë inspektime në qendrat dhe njësitë në varësi për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik, ruajtjes së shëndetit dhe mbrojtjes së mjedisit.

⁷⁵ Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2023). *Raport përfundimtar i auditimit të përputhshmërisë të ushtruar në Albpetrol sh.a Patos*. Tiranë, Faqe 108.

- Po ndiqet zbatimi i kontratës të sigurimit të jetës nga aksidentet në punë me ekzaminimet mjekësore për punonjësit të cilët mbulohen me policë sigurimi.
- Është ndjekur instruktimi i punonjësve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë, mbrojtjen nga zjarri dhe ruajtjen e mjedisit (për çdo profesion) mbështetur në rregulloren e brendshme dhe legjislacionin në fuqi.
- Është punuar në drejtim të vlerësimit të dokumentit të risqeve për uljen e tyre në punë dhe parandalimin e incidenteve të ndryshme dhe prezantimi me të i gjithë punonjësve.
- Janë ndjekur inspektimet e kryera nga inspektoratet shtetërore mbi Sigurinë në Punë dhe Mbrojtjen e Mjedisit. Gjithashtu është mbajtur komunikim i vazhdueshëm me këto inspektorate apo institucione shtetërore mbi informacionet e kërkuara prej tyre.⁷⁶

4.7.4 Prokurimi lokal dhe zhvillimi i bizneseve vendore

Industria e naftës, për shkak të natyrës së saj teknologjikut komplekse dhe kapitalkërkuese, ka potencial të konsiderueshëm për të gjeneruar efekte multiplikative në ekonominë lokale, përmes stimulimit të kërkesës për mallra dhe shërbime ndihmëse si mirëmbajtja e pajisjeve, transporti, shërbimet ushqimore, pajisjet mbrojtëse, teknologjitë e informacionit, etj. Megjithatë, në praktikë, ndikimi i kësaj industrie në zhvillimin e biznesit vendor ka rezultuar i kufizuar për disa arsye kyçe. Së pari, përqendrimi i kontratave në duart e operatorëve ndërkombëtarë me zinxhirë furnizimi të mbyllur dhe përdorimi i kontraktorëve të huaj ka reduktuar ndjeshëm mundësitë për përfshirjen e sipërmarrjeve lokale. Së dyti, shumica e bizneseve vendore nuk arrijnë të përmbushin standardet teknike, të sigurisë dhe të cilësisë që kërkon industria e naftës, për shkak të mungesës së certifikimeve dhe kapaciteteve të specializuara. Së fundmi, ndërhyrja dhe asistenca institucionale për nxitjen e integritetit të bizneseve të vogla dhe të mesme (SME) në zinxhirët e vlerës ka qenë minimale, me politika të paqarta, mungesë databazash transparente për prokurime publike dhe mungesë platformash ndërmjetësuese që do të lehtësonin lidhjet midis aktorëve lokalë dhe kompanive të mëdha të sektorit energjetik.

4.7.5 Zhvillimi i infrastrukturës

Sektori i nxjerrjes së naftës në Shqipëri ka kontribuar pjesërisht në zhvillimin e infrastrukturës në zonat prodhuese, por këto investime kanë qenë kryesisht të motivuara nga nevojat teknike të industrisë dhe kanë pasur ndikim të kufizuar në përmirësimin e përgjithshëm të cilësisë së jetës në komunitetet pritëse. Që prej vitit 2014, kompania ka realizuar investime të konsiderueshme në ndërtimin e rrugëve industriale, sistemeve të trajtimit të mbetjeve, impianteve për injeksion të avullit dhe përmirësime të mjedisit, të cilat janë bërë të mundura edhe me mbështetje nga institucione ndërkombëtare si EBRD dhe IFC. Megjithatë, këto investime janë përqendruar brenda perimetrit të operacioneve dhe nuk kanë prodhuar efekte transformuese në infrastrukturën e përgjithshme publike, si rrugët lokale, ujësjellësit apo shërbimet energjetike për banorët.

Rrugët që janë ndërtuar apo mirëmbajtur në zonën Patos-Marinzë janë përdorur kryesisht për transport të brendshëm industrial, ndërkohë që infrastruktura rrugore për përdorim komunitar ka mbetur e amortizuar. Në aspektin energjetik dhe të ujësjellësit, disa ndërhyrje janë kryer nga operatorët për të mbështetur operacionet e tyre teknike, por pa një qasje të integruar dhe pa përfshirje të komunitetit në vendimmarrje. Sa i përket kapaciteteve të përpunimit, rafineria e Ballshit ka pësuar një rënie drastike të funksionimit gjatë kësaj periudhe për shkak të krizave financiare, mungesës së investimeve dhe mosmodernizimit, duke reduktuar ndikimin ekonomik rajonal që dikur kishte.

⁷⁶ Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2023). *Raport përfundimtar i auditimit të përputhshmërisë të ushtruar në Albpetrol sh.a Patos*. Tiranë, Faqe 110.

Në planin më të gjerë strategjik, ndërtimi i gazsjellësit Trans-Adriatic Pipeline (TAP) gjatë viteve 2016–2020 përbën ndërhyrjen më të rëndësishme infrastrukturore në sektorin energjetik, ku segmenti që kalon përmes Shqipërisë solli përmirësime të përkohshme në rrjetin rrugor dhe energjetik, si dhe mundësi të reja për zhvillimin e rrjeteve të gazit në vend. Nga viti 2021 e në vazhdim, janë ndërmarrë hapa të parë për ndërtimin e infrastrukturës së shpërndarjes së gazit në qytete si Korça, Pogradeci dhe Erseka, duke përfshirë bashkëpunim ndërmjet Albغاز dhe SOCAR. Megjithatë, deri në fund të vitit 2024, shumë nga këto projekte mbeten në fazë implementimi apo planifikimi, ndërkohë që ndikimi real në infrastrukturën e brendshme mbetet i kufizuar krahasuar me potencialin

4.7.6 Zhvendosjet e popullsisë

Në aspektin social dhe demografik, edhe pse nuk janë dokumentuar zhvendosje të përhershme të popullsisë të organizuara në mënyrë institucionale, raportet e komuniteteve dhe raste të dokumentuara tregojnë për migrim të detyruar ekonomik dhe lëvizje joformale për shkak të përkeqësimit të kushteve të jetesës në zonat përreth puseve të naftës. Dëmtimet mjedisore, ndotja e ujërave nëntokësore, erozioni i tokës dhe aktivitetet e shpimeve të thella kanë shkaktuar efekte fizike të drejtpërdrejta mbi banesat dhe infrastrukturën civile. Rasti më i rëndë u shënuar në Zharrëz, ku në vitet 2016–2017 u regjistruan mbi 2,700 mikrotërmete, të lidhura potencialisht me aktivitetin e fracking-ut. Ky fenomen shkaktoi plasaritje të strukturave banesore, gjendje pasigurie sociale, dhe një valë protestash përfshirë greva urie. Megjithatë, nuk u aktivizua asnjë mekanizëm formal zhvendosjeje apo mbështetje për strehim të ri.

Në kontrast, projekti TAP (Trans-Adriatic Pipeline) që u ndërtua gjatë viteve 2016–2020, ka ndjekur standarde të BE-së për zhvendosje të planifikuara të popullsisë dhe kompensim të strukturuar, duke përfshirë konsultime me komunitetet, rindërtim të infrastrukturës banesore dhe transferime të formalizuara. Kjo e thekson më tej mangësinë e një kuadri institucional në Shqipëri për adresimin e ndikimeve sociale dhe zhvendosjeve që lidhen me industrinë vendase të hidrokarbureve, në krahasim me projektet ndërkombëtare të standardizuara.

Ekspertët e mjedisit dhe shoqëria civile kanë ngritur shqetësime për mungesën e një mekanizmi të qartë për vlerësimin e rrezikut social, ndërsa nuk ekziston një strukturë ndër-institucionale funksionale për menaxhimin e emergjencave teknologjike, dëmshpërblimin e banorëve apo monitorimin e ndikimeve afatgjata mjedisore dhe shëndetësore.

4.7.7 Angazhimi i komunitetit në vendimmarrje

Pjesëmarrja e komuniteteve lokale në proceset vendimmarrëse që lidhen me industrinë e nxjerrjes së naftës në Shqipëri mbetet shumë e ulët dhe kryesisht formale. Megjithëse disa konsultime publike janë zhvilluar në përputhje me kërkesat ligjore ose si pjesë e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis (EIA), ato shpesh realizohen në mënyrë simbolike, me pjesëmarrje të kufizuar dhe pa përfshirje të thelluar të grupeve të interesit lokal. Mungesa e qasjes së komuniteteve në informacion të qartë dhe të plotë mbi të drejtat e tyre, ndikimet mjedisore dhe sociale të operacioneve, apo planet e zhvillimit afatgjatë të industrisë, ka kufizuar ndjeshëm fuqinë e tyre për të ushtruar presion ose për të ndikuar në politikëbërje lokale.

Për më tepër, nuk ekzistojnë mekanizma të institucionalizuar për adresimin e ankesave, raportimin e incidenteve nga komuniteti, apo përfshirjen e publikut në monitorimin ose auditimin social të aktiviteteve të kompanive. Mungesa e një kuadri të qartë për transparencën fiskale dhe shpërndarjen e përfitimeve e thellon më tej ndarjen midis industrisë dhe komuniteteve pritëse. Aktualisht, të ardhurat nga industria e naftës (p.sh., nga royalty, taksat apo tarifat koncesionare) nuk kanalizohen në mënyrë të strukturuar drejt

zhvillimit lokal, dhe nuk ekziston një fond i dedikuar për investime sociale, siç ndodh në praktikat ndërkombëtare për menaxhimin e resurseve natyrore. Kjo situatë ka krijuar perceptimin se komunitetet mbajnë barrën mjedisore dhe sociale të industrisë, pa u kompensuar në mënyrë të drejtë përmes përfitimeve ekonomike apo investimeve në infrastrukturë dhe shërbime.

4.7.8 Investimet e kompanive të naftës në zonat përreth

Më 19 janar 2023, kompania Anio Oil & Gas realizoi tri investime të rëndësishme sociale në Bashkinë e Mallakastrës, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve dhe forcimin e infrastrukturës publike në sektorët kyç të shëndetësisë, arsimit dhe sigurisë.

Në kuadër të këtij projekti, u ndërmor rikonstruksioni i dhomave të paraburgimit në Komisaratin e Policisë Mallakastër, duke respektuar standardet për të drejtat e njeriut dhe duke siguruar ndarje të veçantë për meshkujt dhe femrat. Një tjetër ndërhyrje e rëndësishme ishte rehabilitimi i plotë i laboratorit të epidemiologjisë në Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, i cili u rikthye në funksion të plotë për kryerjen e analizave të rëndësishme, përfshirë edhe testet për COVID-19. Gjithashtu, u realizua përmirësimi i ambienteve të brendshme të Kopshtit Nr.2 dhe çerdhes së lagjes “28 Nëntori”, duke krijuar kushte më të mira dhe më të përshtatshme për fëmijët e vegjël të komunitetit.

Këto investime nënvizojnë angazhimin e Anio Oil & Gas për të kontribuar në zhvillimin social dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të Mallakastrës.

Këto investime dëshmojnë angazhimin afatgjatë të kompanisë për bashkëpunim me strukturat vendore, për shërbime publike dinjitoze dhe për zhvillimin e një industrie energjetike më të përgjegjshme ndaj mjedisit dhe komunitetit lokal.



4.7.9 Plani i menaxhimit ambiental dhe social

Atributet	Inpakti Potencial	Veprim menaxhimi	Veprimi Monitorues	Enti përgjegjes
Ndikimet në Biodiversitet	Projektet e kerkimit te hidrokarbureve shpërndahen në vende relativisht të vogla eksplorimi, duke zvogëluar kështu efektin e heqjes të bimësisë dhe copëtimin e madh të habitateve. Fragmentimi i habitateve, Speciet e faunës që kanë nevojë për zona të mëdha pyjore zhduken ose ato mund të lëvizin në distanca të gjata për të	Madhësia dhe ashpërsia e ndikimeve do të varet nga veprimet që ndërmerr mbajtësi i lejes. Nëse mbajtësi i lejes angazhohet të zbatojë masat e duhura zbutëse dhe menaxhuese gjatë aktiviteteve të kërkimit dhe zbulimit, ndikimi do të minimizohet në një nivel të	Monitorim perdorimit habitatit	I te ARM (Agjensia Rajonale Mjedisit)

	kërkuar habitate të përshtatshme për jetesë.	pranueshëm në përputhje me kërkesat specifike ligjore.		
Ndikimet në Gjeologji, Cilësinë e Tokës, Përdorimin e Tokës dhe Peizazhin	Gjatë fazës së shfrytëzimit mund të ketë ndikim të konsiderueshm në gjeologjinë dhe cilësinë e tokës për shkak të proceseve të shpimit dhe fraktimit hidraulik. Fraktimi hidraulik mund të ketë ndikime të konsiderueshme në gjeologji për shkak të injektimit të ujit për nxjerrjen e hidrokarbureve. Per tokat bujqësore, zona do të shndërrohet nga një tokë e kultivuar në një zonë industriale, e cila si rezultat i aktiviteteve të projektit mund të kontaminohet (derdhje) apo të degradohet për shkak të proceseve të ndryshme nxjerrëse. Sa i përket ndikimeve në peizazh, mund të jetë i ulët në projektet e naftës dhe gazit	Sa i përket ndikimeve në peizazh, madhësia mund të jetë më e ulët në projektet e naftës dhe gazit. Këto lloj ndikimesh mund të zvogëlohen përmes masave të ndryshme zbutëse dhe menaxhuese nëse praktikatat e mira ndiqen në çdo kohë, dhe rinovohet teknologjia here pas here.	Monitorim te perdorimit te tokes dhe shkarkimeve te mbetjeve teknologjike. Apdetimi I rinovimit te teknologjise shpuse dhe nxjerrese	ARM (Agjensia Rajonale Mjedisit). Kompania shfrytezues e.
Ndikimet në Cilësinë e Ajrit	Emetimet në ajër ndodhin gjatë secilës fazë të ciklit të projektit të industrive nxjerrëse, veçanërisht gjatë hulumtimit, përgatitjes së aktiviteteve, shfrytëzimit dhe veprimtarive operacionale. - Grimcat ngurta në ajër (kryesisht PM2.5 dhe PM10) si rezultat i hapjes së shesheve, transportit të materialeve, pluhurit të shpërndarë nga objektet e mbetjeve industriale, vend-depozitimeve të mbetjeve dhe trafiku rrugor; - Emetimet e shkarkimit nga burimet e lëvizshme (makina, kamionë, makineri / pajisje të rënda) gjithashtu mund të kontribuojnë në rritjen e niveleve të grimcave të ngurta në ajër, si dhe çlirimin e emetimeve të gazit (NOx, SOx, CO, etj.); - Emetimet e pluhurit nga përpunimi i hidrokarbureve dhe lëvizja e trafikut, veçanërisht në rrugët e pashtuara; dhe, - Emetimet e gazit nga djegia e karburanteve në burime të palëvizshme dhe të lëvizshme, dhe përpunimi i hidrokarbureve. 1. Nga nafta ndotësit më shqetësues të ajrit janë emetimet e gazit, në veçanti SOx, NOx, CO, CO2, etj	Sapo ndotësit çlirohen në atmosferë, ata pësojnë ndryshime fizike e kimike përpara se të arrijnë një receptor. Këta ndotës mund të shkaktojnë efekte serioze negative në shëndetin e njeriut dhe në mjedis, veçanërisht në biodiversitet (faunë dhe florë). Aktivitetet e shfrytëzimit të naftës dhe gazit kanë potencialin të kontribuojnë ndjeshëm në ndotjen e ajrit.	Monitorim te shkarkimeve te gazeve atmosferë. Apdetimi I rinovimit te teknologjise absorbuese te gazeve	ARM (Agjensia Rajonale Mjedisit). Kompania shfrytezues e.

Ndikimet në Ujërat Sipërfaqësorë dhe Ujërat Nëntokësorë	Ndër ndikimet më të rëndësishme të projekteve të industrive nxjerrëse janë efektet e tyre në cilësinë e ujit dhe disponueshmërinë e burimeve ujore brenda zonës së projektit. Pasiguritë kryesore janë nëse burimet ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore do të mbesin të pa devijuara, të pa ndotura apo të përshtatshme për konsum njerëzor (ujërat nëntokësore), dhe nëse cilësia e ujërave sipërfaqësorë në zonën e projektit do të mbetet e përshtatshme për të mbështetur jetën ujore vendase dhe jetën e egër tokësore.	Aktivitetet e shpimit të naftës dhe gazit mund të shkaktojnë humbje të burimeve të ujërave nëntokësore dhe përkeqësim të cilësisë së ujit. Aktivitetet e eksplorimit mund të përfshijnë injektimin e ujit nën tokë. Ka raste kur uji i injektuar i përdorur në proces është i kripur ose i njelmët. Kjo teknikë mund të çojë në ndikime negative në cilësinë e ujërave nëntokësore, përmes shkakimit të prurjes së ujit të kripur ose të njelmët.	uji i injektuar i përdorur në procesin e fraktimit të jete i njelmët. Kjo teknikë te ruaje cilësinë e ujërave nëntokësore, dhe parametrat prurjes së ujit të të njelmët. Te perdoren impiantet e depurimit te ujrave para se te shkarkohen ne vijat ujore.	ARM (Agjensia Rajonale Mjedisit). Agjensia e menaxhimit te baseneve ujore Kompania shfrytëzues e.
Ndikimet nga Gjenerimi i Zhurmave Dridhjeve/ Vibrimeve	Shqetësimet nga zhurma mund të shkaktojnë shqetësime të mëdha në receptorët njerëzorë dhe jetën e egër. Në industrinë nxjerrëse, procesi i fraktimit hidraulik (naftë dhe gaz) janë burimi kryesor i dridhjeve. fraktimi hidraulik ka krijuar probleme për shkak të dridhjeve. Pajisjet dhe makineritë e përdorura gjatë aktivitetëve të kërkimit dhe shfrytëzimit gjithashtu mund të shkaktojnë dridhje. Disa zhurma të vazhdueshme s mund të ndodhin, p.sh. aktivitet shpimi, mund të krijojnë zhurmë të vazhdueshme, por, zakonisht mbahet nën kontroll me anë të izolimit. Teknika e fraktimit hidraulik mund të shkaktojë lëvizjen e shtresave nëntokësore të tokës dhe shkëmbinjve, të cilat si pasojë mund të shkaktojnë shqetësime në tokë, lëvizje të shtresave, dridhje dhe tërmete. Dridhjet për shkak të fraktimit hidraulik mund të shkaktojnë shqetësime dhe ndikime të rënda sociale në komunitetet lokale afër zonave të shfrytëzimit të naftës dhe gazit. Dridhjet kanë ndikuar në qëndrueshmërinë e infrastrukturës lokale, shtëpive, ndërtesave dhe aktivitetëve rekreative të vendosura pranë operimit të industrisë dhe aktivitetet e naftës dhe gazit).	Ka një dallim midis zhurmës së vazhdueshme dhe asaj të përhershme për shkak të origjinës së tyre që është e ndryshme dhe krijimit të llojeve të ndryshme të ndikimeve/shqetësimeve. Zhurmat tipike të vazhdueshme janë ato që krijohen nga trafiku i automjeteve përgjatë rrugëve kryesore në zonën e projektit. Zhurma e prodhuar zakonisht nga aktivitetet e naftës dhe gazit në përgjithësi është me ndërprerje ose sporadike. Megjithatë kjo zhurmë e vazhdueshme e nivelit të ulët është pjesë e zhurmës mbizotëruese të sfondit, ndikimi është zakonisht i vogël dhe i tolerueshëm. Zhurma me ndërprerje prodhohet nga procese pune specifike: kryesisht ndezja ditore e motorëve. Nëse nuk ndjek një cikël periodik, ose kur periudha është e gjatë, mund të cilësohet si zhurmë sporadike. Teknika e fraktimit hidraulik mund të shkaktojë lëvizjen e shtresave nëntokësore të tokës dhe shkëmbinjve, të cilat si pasojë mund të shkaktojnë shqetësime në	Praktika më e mirë kërkon që proceset kryesore të gjenerimit të zhurmës të mos kryhen njëkohësisht, por si procese të ndara, si dhe të kryhen brenda orëve të punës në një kohë të përshtatshme gjatë ditës (zakonisht jo koha e drekës apo natën). Për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes se zhurmës nga aktivitetet e industrisë naftes, duhet të ketë masa specifike zbutëse në zonë dhe një plan administrimi (plani I zvogëlimit të zhurmës). Prandaj, është shumë e	ARM (Agjensia Rajonale Mjedisit). AKBN Agjensia Kombetare Burimeve Natyrore Kompania shfrytëzues e.

		tokë, lëvizje të shtresave, dridhje dhe tërmete. Dridhjet për shkak të fraktimit hidraulik mund të shkaktojnë shqetësime dhe ndikime të rënda sociale në komunitetet lokale afër zonave të shfrytëzimit të naftës dhe gazit.	rëndësishme që këto aktivitete të planifikohen siç duhet, dhe të menaxhohen	
Ndikimet nga Gjenerimi i Mbetjeve	Substancat hidrokarbure konsiderohen si materiale të rrezikshme për shkak të përbërjes së tyre dhe vetive toksike që mund të shkaktojnë dëme apo ndotje të mjedisit (në burimet ujore, biodiversitet) dhe mund të dëmtojnë shëndetin e njeriut. Toka e ndotur me substanca hidrokarbure konsiderohet si mbetje e rrezikshme dhe duhet të menaxhohet dhe asgjësohet si duhet në përputhje me kërkesat ligjore në zonat e dedikuara të depozitimit. Materialet e tjera të rrezikshme siç janë pajisjet e vjetra, makineritë, depozitat e magazinimit dhe substanca të tjera konsiderohen gjithashtu mbetje të rrezikshme.	Ka shumë zona të "nxehta" si Marinza, Ballshi, Kucova, etj., që paraqesin rreziqe mjedisore dhe sociale për shkak të pajisjeve të vjetra të shpimit të hidrokarbureve të lëna në zonë, derdhjeve të hidrokarbureve dhe / apo llojeve të tjerë të materialeve të rrezikshëm të braktisur nga aktivitetet e mëparshme industriale nxjerrëse. Këto materiale dhe substanca të rrezikshme paraqesin shqetësime për komunitetin lokal për shkak të çlirimit të aromave, kontaminimit të burimeve ujore dhe tokës, veçanërisht gjatë periudhës së verës	Kompanite e paisura me leje mjedisi duhet të jenë plotësisht në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe të sigurojnë menaxhim të praktikës më të mirë për asgjësimin, trajtimin dhe ripërdorimin e mbetjeve të gjeneruara nga aktivitetet e tyre.	ARM (Agjensia Rajonale Mjedisit). AKBN Agjensia Kombetare Burimeve Natyrore Kompania shfrytëzues e.
Ndikimet në Infrastrukturë dhe Trafik	Projektet e naftës dhe gazit mund të çojnë në ndërtimin e infrastrukturës së re siç janë rrugët dhe urat, apo të përmirësojnë gjendjen ekzistuese të infrastrukturës rrugore. Kompanitë që veprojnë në industrinë e naftës dhe gazit shpesh angazhohen për të përmirësuar infrastrukturën lokale dhe të investojnë në zonën e projektit (ndërtime të reja ose rinovimi i qendrave shëndetësore, shkollave, rrjeteve të furnizimit me ujë, etj.). Trafiku i rritur shkakton një problem në zonat e projektit të industrive nxjerrëse naftes. Shqetësimi nga trafiku është për shkak të vëllimit më të lartë të makinave, kamionëve dhe transferimit të hidrokarbureve për përpunim.	Ka raste kur kompania nuk ofron investime lokale në zonë, por përdor infrastrukturën ekzistuese lokale. Në këto raste, infrastruktura lokale rrezikon të përkeqësohet më shpejt me kalimin e kohës për shkak të rritjes së lëvizjes së trafikut.	Përgatitja e një plani investimi ne infrastructure dhe menaxhimi të trafikut është praktika më e mirë për të siguruar sigurinë e transportit për punonjësit, komunitetin dhe vizitorët, dhe për të shmangur shqetësimet e mundshme gjatë zbatimit të projektit.	ARM (Agjensia Rajonale Mjedisit). AKBN Agjensia Kombetare Burimeve Natyrore Pushteti Vendor Kompania shfrytëzues e.

Ndikimet Komunitetin Lokal	Ndikimet sociale në komunitetet lokale ku ndodhen projekte të naftës dhe gazit janë të diskutueshme dhe komplekse. Projektet e industrisë së naftës mund të krijojnë vende të reja pune, rrugë, shkolla, të promovojnë nisma biznesi dhe të rrisin kërkesat për mallra dhe shërbime në zona të largëta ose të varfra, por përfitimet dhe kostot duhet të ndahen në mënyrë të pabarabartë.	Komunitetet duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë e të drejtë në përputhje me ligjet në fuqi. Por nëse komunitetet mendojnë se po trajtohen padrejtësisht ose dëmshpërblehen në mënyrë jo të duhur, projektet e industrisë së naftës mund të krijojnë tension shoqëror dhe në raste ekstreme, konflikte të dhunshme.	Bilanci midis ndikimeve pozitive dhe negative në komunitetet lokale varet nga sa kompania e licensuar përmbush angazhimet e tij të detyrueshme dhe vullnetare mjedisore dhe sociale.	ARM (Agjencia Rajonale Mjedisit). AKBN Agjencia Kombetare Burimeve Natyrore Pushteti Vendor Kompania shfrytëzues e.
----------------------------------	--	---	--	--

Table 27. Plani I Menaxhimit Ambientale dhe Social.

5. VLERËSIMI TEKNOLOGJIK DHE INFRASTRUKTUROR

5.1 Vlerësimi Teknologjik

Përdorimi i teknologjive moderne në industrinë e naftës ka transformuar në mënyrë thelbësore mënyrën se si kompanitë operojnë, duke sjellë përfitime të rëndësishme në efikasitetin e prodhimit, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të sektorit. Inovacionet teknologjike, nga sensorët inteligjentë dhe automatizimi i proceseve, deri te përdorimi i analizës së të dhënave të mëdha (big data) dhe inteligjencës artificiale, mundësojnë optimizimin e operacioneve në çdo fazë, nga eksplorimi dhe shpimi, deri te përpunimi dhe shpërndarja e naftës.

Në fazën e eksplorimit, përdorimi i teknologjive të avancuara gjeofizike dhe gjeologjike ndihmon në identifikimin më të saktë dhe më të shpejtë të rezervave, duke reduktuar rrezikun dhe kostot. Gjithashtu, teknologjitë e shpimit të drejtuar dhe robotika ndikojnë për të rritur saktësinë dhe sigurinë gjatë punës në terren, duke minimizuar ndërhyrjet njerëzore në zonat me rrezik të lartë. Në proceset e prodhimit dhe përpunimit, automatizimi i sistemeve dhe monitorimi në kohë reale lejojnë kontroll më të mirë të parametrave operacionale, parandalimin e defekteve dhe përmirësimin e menaxhimit të burimeve.

Për më tepër, teknologjitë e gjeneratës së re ndihmojnë në reduktimin e ndikimit mjedisor të industrisë së naftës. Përdorimi i sistemeve për kontrollin e emetimeve, monitorimin e cilësisë së ajrit dhe ujit, si dhe teknologjitë për menaxhimin e mbetjeve dhe riciklimin, kontribuojnë në përmirësimin e qëndrueshmërisë së operacioneve. Për më tepër, aplikimi i burimeve të energjisë së rinovueshme për funksionimin e infrastrukturës së naftës është një trend në rritje që synon të ulë varësinë nga karburantet fosile gjatë prodhimit.

Integrimi i teknologjive moderne në industrinë e naftës sjell një rritje të ndjeshme të efikasitetit operativ, reduktim të kostove dhe përmirësim të sigurisë, ndërsa njëkohësisht kontribuon në përmbushjen e kërkesave për mbrojtjen e mjedisit dhe tranzicionin drejt energjive të qëndrueshme. Kjo përbën një avantazh konkurrues për kompanitë që investojnë në inovacion dhe teknologji, duke i ndihmuar ato të

përballojnë sfidat e një sektori gjithnjë e më të kompleksuar dhe të kërkuar në standarde të larta mjedisore.

5.1.1 Inteligjenca Artificiale (AI) dhe Digitalizimi

Në përpjekje për të modernizuar dhe optimizuar operacionet e saj, Albpetrol ka integruar me sukses teknologjitë e inteligjencës artificiale (AI) në disa procese kyçe të industrisë së naftës. Përdorimi i AI në analizën sizmike ka mundësuar interpretimin më të shpejtë dhe më të saktë të të dhënave gjeofizike, duke ndihmuar në identifikimin e potencialeve për shpime dhe eksplorime të reja. Modelimi i rezervuarëve, një proces kompleks që kërkon analizën e parametrave të ndryshëm gjeologjikë dhe teknikë, përmirësohet ndjeshëm me ndihmën e AI, duke lejuar parashikime më të sakta për sjelljen e rezervuarit dhe optimizimin e prodhimit. Kjo rrit efikasitetin e përgjithshëm të operacioneve dhe ndihmon në reduktimin e kostove operative, pasi mundëson marrjen e vendimeve më të informuara dhe parandalon gabimet e kushtueshme.

Nga ana tjetër, kompania Alban Oil Plc ka sjellë inovacion në menaxhimin e të dhënave dhe digitalizimin e proceseve operative përmes platformës Cognite dhe sistemit Aureka, të cilat janë produkte të tyre. Këto platforma sigurojnë mbledhje dhe analizë në kohë reale të të dhënave që vijnë nga sensorë të ndryshëm dhe sistemet logjistike, duke mundësuar monitorim të vazhdueshëm dhe menaxhim efikas të operacioneve në terren. Platforma Cognite mundëson vizualizimin e të dhënave komplekse në mënyrë të thjeshtë dhe të integruar, ndërsa sistemi Aureka ndihmon në përpunimin dhe organizimin e informacionit për të përmirësuar proceset vendimmarrëse dhe efektivitetin e menaxhimit.

Përmes këtyre teknologjive të avancuara, Alban Oil Plc po transformon mënyrën e funksionimit të industrisë së naftës, duke e bërë atë më efikase, të sigurt dhe më të qëndrueshme në përputhje me kërkesat bashkëkohore për teknologji të gjelbër dhe menaxhim modern.

5.1.2 Teknologji të EOR (Enhanced Oil Recovery)

Në Shqipëri, në fushën e Patos Marinzë, janë ndërmarrë qasje të avancuar dhe inovative për të rritur shkallën e rikuperimit të naftës, duke zbatuar teknologji të avancuara të Enhanced Oil Recovery (EOR). Përmes teknikave si shpimi horizontal, polymer flooding dhe injektimi me avull, po arrihet një rritje e ndjeshme e efikasitetit në nxjerrjen e naftës, duke maksimizuar përdorimin e burimeve ekzistuese dhe duke zgjatur jetëgjatësinë e fushës së prodhimit. Këto teknologji inovative jo vetëm që rrisin shkallën e rikuperimit të naftës me 5-15% në periudhën 2025–2029, por gjithashtu sjellin përfitime të rëndësishme në aspektin ekonomik dhe mjedisor, duke ulur nevojën për puse të rinj dhe duke minimizuar ndikimet negative në ambient.

Shpimi horizontal është një teknikë që lejon arritjen në zona më të gjera të rezervuarit, duke rritur sipërfaqen e kontaktit me shtresat e naftës dhe duke përmirësuar prodhimin në krahasim me shpimet vertikale tradicionale. Kjo metodë ndihmon në shfrytëzimin më të mirë të burimeve ekzistuese dhe në reduktimin e ndikimit mjedisor për shkak të nevojës për më pak puse shpimi.

Polymer flooding është një teknikë e injektimit të polimereve në rezervuar, që synon të rrisë viskozitetin e ujit të injektuar dhe të përmirësojë rrjedhshmërinë e naftës drejt puseve të prodhimit. Kjo metodë ndihmon në përmirësimin e efikasitetit të nxjerrjes së naftës duke reduktuar rrjedhjet e panevojshme dhe duke rritur rikuperimin e naftës së mbetur.

Ndërsa injektimi me avull është një teknikë që përdor avullin e ngrohtë për të ulur viskozitetin e naftës të rëndë në rezervuar, duke e bërë atë më të lehtë për tu nxjerrë në sipërfaqe. Kjo metodë është veçanërisht efektive në fushat ku nafta ka viskozitet të lartë dhe ka ndihmuar në përmirësimin e prodhimit në mënyrë të konsiderueshme.

Ky proces është mbështetur fuqimisht nga projekti i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) dhe Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), të cilët kanë kontribuar në implementimin e këtyre teknologjive si pjesë e një programi të gjerë për rehabilitimin dhe modernizimin e fushës Patos Marinzë. Përmes këtij bashkëpunimi, janë siguruar investime teknike të rëndësishme dhe është përshpejtuar transferimi i dijes dhe ekspertizës moderne në sektorin lokal të naftës, duke ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve dhe forcimin e qëndrueshmërisë së operacioneve.

Në këtë mënyrë, aplikimi i teknologjive EOR jo vetëm që përmirëson performancën teknike dhe ekonomike të fushës Patos Marinzë, por gjithashtu kontribuon në zhvillimin e një industrie më të qëndrueshme dhe inovative, e cila është në përputhje me standardet ndërkombëtare të efikasitetit dhe mbrojtjes mjedisore.

Zbatimi i këtyre metodave moderne EOR në Patos Marinzë është një shembull konkret i përpjekjeve të Shqipërisë për të përmirësuar qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e sektorit të naftës, duke integruar teknologji të avancuara që përputhen me standardet më të larta ndërkombëtare. Kjo nismë synon jo vetëm të maksimizojë prodhimin, por edhe të kontribuojë në zhvillimin e një industrie më inovative, miqësore me mjedisin dhe ekonomikisht të qëndrueshme, duke e pozicionuar Shqipërinë si një aktor të rëndësishëm në rajonin e energjisë.

5.1.3 Mirëmbajtja Parashikuese dhe Automatizimi me Ndihmën e Inteligjencës Artificiale (AI)

Një nga aspektet më të rëndësishme për funksionimin efikas dhe të qëndrueshëm të industrisë së naftës është mirëmbajtja e infrastrukturës dhe pajisjeve teknike. Në këtë drejtim, teknologjitë e inteligjencës artificiale (AI) po luajnë një rol kyç në zhvillimin e sistemeve të mirëmbajtjes parashikuese, të cilat kanë revolucionarizuar mënyrën se si menaxhohet dhe planifikohet mirëmbajtja në këtë sektor.

Sistemet AI përdorin algoritme të avancuara për analizimin e të dhënave të mbledhura në kohë reale nga sensorë të shumtë të instaluar në pajisje dhe infrastrukturë kritike, si p.sh. pompat, kompresorët, tubacionet, sistemet e trajtimit të naftës dhe pajisjet e shpimit. Duke analizuar këto të dhëna, AI është në gjendje të identifikojë modele dhe anomalitë që mund të sinjalizojnë shfaqjen e problemeve apo defekteve para se ato të manifestohen në mënyrë të dukshme.

Ky parashikim i hershëm i defekteve mundëson planifikimin e mirëmbajtjes preventive në kohën më të përshtatshme, duke shmangur ndërprerjet e papritura operative që shpesh sjellin humbje të mëdha ekonomike dhe rreziqe për sigurinë e punonjësve dhe mjedisit. Për shembull, zbulimi në kohë i një problemi në një pompë mund të parandalojë një rrjedhje naftë që mund të shkaktojë ndotje të madhe mjedisore dhe dëme financiare.

Automatizimi i proceseve të mirëmbajtjes është gjithashtu një përfitim i rëndësishëm që sjell përdorimi i AI. Sistemet inteligjente mund të programojnë dhe orientojnë automatikisht operacionet e mirëmbajtjes, duke përfshirë edhe koordinimin e ekipit teknik dhe sigurimin e pjesëve të nevojshme. Kjo redukton kohën e reagimit dhe përmirëson menaxhimin e burimeve, duke siguruar që mirëmbajtja të kryhet me efikasitet maksimal dhe me kosto të reduktuara.

Për më tepër, mirëmbajtja parashikuese ndihmon në rritjen e jetëgjatësisë së pajisjeve dhe infrastrukturës, duke shtyrë nevojën për zëvendësime të shpeshta dhe investime të shtrenjta në pajisje të reja. Kjo kontribuon në qëndrueshmërinë ekonomike të operacioneve dhe redukton ndikimin mjedisor të industrisë së naftës për shkak të uljes së mbetjeve dhe konsumin më të përgjegjshëm të burimeve.

5.2 Vlerësimi i Infrastrukturës

Analiza e gjendjes së infrastrukturës ekzistuese, duke përfshirë pipelines, rafineritë dhe objektet e magazinimit.

5.2.1 Rafinieritë dhe magazinimi

Industria e rafinimit të naftës në Shqipëri ka një rëndësi strategjike për ekonominë dhe energjetikën e vendit, me disa impiante kyçe që kanë siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe cilësor për tregun vendas dhe rajonal. Kompania ARMO ka qenë një prej liderëve në këtë sektor, duke menaxhuar me sukses rafineritë në Ballsh dhe Fibër-Qendër. Rafineria e Ballshit, me kapacitetin e saj prej rreth 1 milion tonë në vit, ka kontribuar në përpunimin e produkteve naftë-përpunuese me standarde të larta, duke mbështetur zhvillimin e industrisë dhe krijimin e vendeve të punës. Ndërkohë, rafineria në Fibër-Qendër, me kapacitet prej 0.5 milion tonë në vit, ka ofruar shërbime të specializuara, duke zgjeruar gamën e produkteve të disponueshme në treg.

Edhe pse sektori i rafinimit ka kaluar periudha sfiduese, këto kanë krijuar një mundësi të rëndësishme për modernizim dhe përmirësim të teknologjive të përdorura. Investimet e planifikuara për rinovimin e impianteve dhe integrimin e teknologjive më të avancuara janë në fokus, duke synuar rritjen e efikasitetit, uljen e ndikimit mjedisor dhe përmbytjen e standardeve ndërkombëtare të sigurisë dhe cilësisë. Kjo transformim i rafinerive do të fuqizojë industrinë në afat të gjatë dhe do të krijojë një bazë më të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik të vendit.

Në fushën e magazinimit dhe logjistikës, infrastruktura shqiptare përbëhet nga terminale moderne dhe të mirëmbajtura, që luajnë një rol kyç në sigurimin e furnizimit të vazhdueshëm të tregut me karburante dhe produkte të naftës. Terminali Porto Romano MBM në Durrës është një nga asetet më të rëndësishme të vendit, me kapacitete të mëdha magazinimi (mbi 75,000 metra kub), të cilat mundësojnë ruajtjen e lëndëve të para dhe produkteve të përpunuara me efikasitet të lartë. Ky terminal, i lidhur me rrjetin e tubacioneve 24" dhe 12", siguron një menaxhim të avancuar logjistik që lehtëson qarkullimin e mallrave dhe garanton furnizim të pandërprerë në treg. Po ashtu, terminali PIA në Vlorë është një tjetër komponent i rëndësishëm në zinxhirin e shpërndarjes së karburanteve në jug të Shqipërisë, duke përmirësuar infrastrukturën rajonale dhe duke ofruar shërbime të standardeve të larta për magazinimin dhe shpërndarjen e produkteve të naftës dhe gazit.

Këto kapacitete dhe investime në infrastrukturë jo vetëm që mbështesin ekonominë dhe rritjen e sektorit energjetik, por edhe kontribuojnë në krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin social në komunitetet përkatëse. Me fokus në inovacion dhe përmirësim të vazhdueshëm, sektori i rafinimit dhe magazinimit në Shqipëri ka potencialin të luajë një rol kyç në tranzicionin energjetik të vendit dhe në forcimin e pavarësisë energjetike.

5.2.2 Rrjeti i pipelajnit dhe rrugët industriale

Shqipëria disponon një infrastrukturë të rëndësishme energjetike, e cila ofron një bazë të mirë për modernizim dhe zhvillim të mëtejshëm të sektorit të naftës dhe gazit. Tubacioni që lidh fushat naftëmbajtëse me portin e Vlorës, me një gjatësi rreth 188 km, përfaqëson një aset strategjik që, ndonëse aktualisht jashtë funksionit, ofron mundësi të jashtëzakonshme për rehabilitim dhe riaktivizim. Ky rrjet ekzistues, nëse modernizohet, do të sjellë ulje të ndjeshme të kostove të transportit, rritje të sigurisë operacionale dhe redukton ndjeshëm impaktin mjedisor, duke zëvendësuar transportin rrugor me zgjidhje të qëndrueshme.

Paralelisht me infrastrukturën ekzistuese, projekti TAP (Trans Adriatic Pipeline) përbën një nga arritjet më të mëdha infrastrukturore në fushën e energjisë për Shqipërinë. Me rreth 215 km gjatësi brenda territorit shqiptar, TAP ka ndërtuar një korridor modern energjetik që jo vetëm mundëson hyrjen e gazit natyror në vend, por krijon mundësi reale për zhvillimin e një rrjeti të brendshëm të gazifikimit. Kjo nënkupton akses të zgjeruar për qytetet, industrinë dhe sektorin publik në një burim më të pastër dhe ekonomik energjie, duke mbështetur tranzicionin drejt energjisë së gjelbër. Përveç kësaj, TAP ka sjellë përfitime konkrete për infrastrukturën vendore: rrugë teknologjike të reja, ndërtim të pikave të matjes dhe përmirësim të aksesit në zona rurale dhe industriale. Kjo infrastrukturë po shndërrohet në një bazë funksionale për zhvillimin e ekonomisë lokale, rritjen e investimeve dhe integrimin më të fortë të Shqipërisë në tregjet rajonale të energjisë.

Në terma afatgjatë, kombinimi mes rrjetit të pipelajnit të naftës dhe infrastrukturës moderne të gazsjellësit TAP krijon një avantazh konkurrues për Shqipërinë, duke e pozicionuar vendin si një qendër energjetike me potencial për eksport, tranzit dhe shpërndarje rajonale. Ky është një shembull i qartë se si përdorimi strategjik i infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimi i korridoreve të reja mund të kontribuojnë në zhvillim ekonomik, siguri energjetike dhe përmbushjen e objektivave të qëndrueshmërisë.

5.2.3 Iniciativa të ardhshme dhe modernizime

Shqipëria po hyn në një fazë të re të zhvillimit energjetik përmes një sërë projektesh ambicioze që synojnë të rrisin efikasitetin, sigurinë dhe pozicionin rajonal të vendit në sektorin e naftës dhe gazit. Një nga iniciativat më premtuese është projekti TAP/IAP/AMBO, që ka për qëllim ndërlidhjen strategjike të zonave naftëmbajtëse shqiptare me portet kryesore të Adriatikut, si Vlora dhe Durrësi. Këto tubacione – aktualisht në faza planifikimi apo prototipi – pritet të shërbejnë si korridore të reja transporti, duke rritur kapacitetin për eksportin e hidrokarbureve dhe duke lehtësuar ruajtjen strukturore të energjisë përmes infrastrukture më të sigurt dhe më të qëndrueshme.

Një tjetër projekt me rëndësi strategjike është zhvillimi i depozitimit të gazit natyror në strukturën gjeologjike të Dumresë, një prej vendndodhjeve më të përshtatshme për magazinim nëntokësor në rajon. Objektivi i këtij projekti është krijimi i një qendre të ruajtjes së gazit me kapacitet deri në 800 milionë metra kub, e cila do të shërbejë jo vetëm për nevojat e brendshme të Shqipërisë, por edhe për furnizim rajonal dhe siguri të sistemit në raste emergjencash ose çrregullimesh në tregjet globale të energjisë. Kjo nismë e pozicionon vendin si një nyje të qëndrueshme gazifikuese në Ballkanin Perëndimor, duke krijuar fleksibilitet të lartë për furnizimin dhe stabilitet ekonomik në periudha të pasigurta.

Këto projekte përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të rrjetit energjetik të Shqipërisë, si dhe një zhvendosje strategjike drejt përdorimit më të madh të gazit natyror, një burim më i pastër dhe fleksibël krahasuar me karburantet tradicionale. Përveç ndikimit ekonomik dhe logjistik, këto investime sjellin përfitime të drejtpërdrejta në mjedis, duke kontribuar në reduktimin e emetimeve të gazeve serrë dhe mbështetur tranzicionin energjetik të gjelbër të vendit.

5.3 Vlerësimi i rreziqeve

Në Shqipëri, identifikimi dhe menaxhimi i rreziqeve në sektorin e hidrokarbureve po trajtohet nga autoritetet shqiptare, të cilat po i qasen këtij procesi me vendosmëri dhe seriozitet të plotë institucional, ku ndërkohë që rreziqet janë prezente, por shihen edhe përpjekje konkrete dhe progresive nga autoritetet shtetërore për t'i adresuar ato me seriozitet dhe kurajo.

Së pari, rreziqet operationale si shpërthimet nga gazi H₂S, rrjedhjet toksike dhe defektet e pajisjeve mbeten sfida reale, por deri tani është parë një avancim në analizën dhe vlerësimin e tyre. Institucionet shtetërore dhe operatorët privatë po fillojnë të zbatojnë me kujdes metoda të përmirësuara të identifikimit

të rreziqeve dhe strategji të menaxhimit të tyre, me qëllim uljen e ndikimit në sigurinë e punës dhe mjedisin përreth.

Pastaj, edhe pse sistemi i monitorimit tradicional në disa zona është akoma i vjetëruar dhe mungesa e një kulture të plotë të sigurisë përbën rrezik, shteti shqiptar është duke avancuar drejt përmirësimeve teknologjike dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale. Kjo përfshin përpjekje për integrimin e qendrave të reja monitorimi dhe standardeve të bashkëpunimit publik-privat për ndërgjegjësimin dhe trajnimin e stafit teknik.

Në anën tjetër, në lidhje me gatishmërinë teknike dhe logjistike për reagime ndaj aksidenteve industriale, edhe pse sot janë evidentë pengesa si planet emergjente të papërfunduara dhe pajisjet jo të plota, Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Civile (AKMC) ka nisur zhvillimin e skemave të koordinuara të përgjegjësisë dhe ndërhyrjeve emergjente. Ka përparime në ndërinstitutionalizim, trajnime të përbashkëta dhe simulime emergjente që synojnë ndërtimin në mënyrë graduale të një sistemi kombëtar reagimi dhe mbrojtje. Ky është një ndryshim pozitiv dhe i rëndësishëm drejt përmirësimit të gatishmërisë kolektive. Për më tepër, rreziqet kibernetike me rritjen e digitalizimit dhe përdorimin e sistemit SCADA/IIoT janë duke u trajtuar me seriozitet në Shqipëri. Autoritetet po fillojnë të vendosin protokolle të sigurisë kibernetike dhe mekanizma mbrojtës, ndërsa po kultivohet ndërgjegjësimi në industrinë e naftës dhe institucionet shtetërore për rëndësinë e mbrojtjes së infrastrukturës digjitale. Edhe pse ka ende punë për të bërë, ky ndryshim pozicionon vendin drejt një niveli më të lartë të sigurisë teknologjike në përputhje me praktikatat ndërkombëtare. Ndërsa sektori përballlet me rreziqe të shumta, angazhimi i institucioneve shtetërore shqiptare tregon se nuk po veprohet pasivisht. Përmes reformave në politikë, përmirësimit të teknologjive të monitorimit, trajnimeve të vazhdueshme dhe ndërgjegjësimit institucional, Shqipëria po ndërton një kuadër më rezistent dhe më të integruar të menaxhimit të rreziqeve. Kjo përbën një tregues të fortë për profesionalizimin e sektorit dhe përkushtimin ndaj sigurisë, cilësisë operationale dhe mbrojtjes së mjedisit.

Përmbushja e qëllimeve të Strategjisë së Menaxhimit të Riskut realizohet përmes disa veprimeve kyçe. Këto përfshijnë:

1. Njohjen e të gjithë punonjësve, veçanërisht menaxherëve të institucioneve, me konceptet e menaxhimit të riskut.
2. Theksimin e domosdoshmërisë së vlerësimit të riskut dhe ndriçimin e menaxherëve për përgjegjësinë e tyre në zbatimin e menaxhimit të riskut, për ta mbajtur atë në nivele që nuk dëmtojnë organizatën.
3. Promovimin e menaxhimit të riskut si një mjet menaxhimi të përditshëm që, ndër të tjera, siguron menaxhim financiar efikas, shfrytëzimin optimal të burimeve dhe shmangien e korrupsionit.
4. Monitorimin e qëndrueshëm të fushave të riskut për të siguruar që ato janë nën kontroll.
5. Marrjen e masave për eliminimin ose pakësimin e riskut deri në një nivel të pranueshëm.

Sfida kryesore në menaxhimin e riskut është identifikimi fillestar i riskut, analiza e tij dhe zhvillimi i procesit të menaxhimit të riskut. Rishikimet e vazhdueshme dhe përmirësimi i përhershëm janë thelbësore për një menaxhim të suksesshëm të riskut.

Në hartimin e dokumentit të strategjisë së menaxhimit të riskut për shoqërinë Albpetrol sh.a., është ndjekur një procedurë dhe metodologji e strukturuar si më poshtë:

1. Krijimi i një ekipi të dedikuar, i cili merr në konsideratë të gjitha operationet dhe aktivitetet e kompanisë, për të identifikuar rreziqet që i shoqërojnë ato.
2. Vetë-vlerësimi i riskut, ku çdo strukturë e kompanisë kontribuon në identifikimin e rreziqeve që ajo përballon.

Skema e menaxhimit të riskut paraqet hapat që do të ndiqen për të siguruar që risku menaxhohet në mënyrë efikase:



Figure 20. Skema e menaxhimit të riskut sipas Albpetrol sh.a.

Menaxhimi i riskut institucional realizohet nga gjithë stafi i shoqërisë Albpetrol sh.a., nga niveli teknik deri në atë drejtues. Ky proces është i lidhur ngushtë me veprimtarinë e përgjithshme të kompanisë. Çdo punonjës duhet të kuptojë rolin e tij në kuadrin e objektivave institucionale dhe në funksionin që ata kanë. Struktura e menaxhimit të riskut përfshin:

- Titullari (Administratori), i cili është përgjegjës për hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë së menaxhimit të riskut brenda kompanisë, si dhe për miratimin e nivelit të tolerancës ndaj riskut.
- Grupi i Menaxhimit Strategjik, i cili vepron si një strukturë ku diskutohen masat për çështjet kryesore dhe serioze lidhur me menaxhimin e riskut. Ky grup duhet të verifikojë nëse janë menaxhuar rreziqet në përputhje me një raport vjetor të përgjithshëm.
- Drejtori i Departamentit Administrativ dhe i Departamentit Teknik, të cilët janë koordinatorë të riskut, me përgjegjësi për bashkëpunimin në aktivitetet që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve, për të siguruar që ato nuk dëmtojnë arritjen e objektivave dhe për ngritjen e sistemit të menaxhimit të riskut.⁷⁷

6. VLERËSIMI I QËNDRUESHMËRISË DHE KALIMI ENERGJETIK

Kalimi energjetik global është një ndër sfidat më të mëdha dhe më urgjente të shekullit XXI. Ai nënkupton një transformim të thellë dhe të qëndrueshëm të sistemit aktual të prodhimit, shpërndarjes dhe konsumit të energjisë – nga burimet fosile si nafta, gazi natyror dhe qymyri, drejt burimeve të rinovueshme si dielli, era, biomasa dhe hidroenergjetika. Qëllimi parësor i këtij tranzicioni është reduktimi i emetimeve të gazrave serrë (GHG), ndalimi i ngrohjes globale përtej kufirit kritik 1.5°C, si

⁷⁷ Albpetrol. (2024). Urdhër Nr. 208, datë 21.06.2024, për “Miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut të shoqërisë “Albpetrol” Sh.a, 2024,. Marre nga <https://albpetrol.al/wp-content/uploads/2024/06/208-Strategjia-e-Menaxhimit-te-Riskut.pdf>.

dhe sigurimi i një sistemi energjetik të sigurt, të pastër dhe ekonomikisht të qëndrueshëm për brezat e ardhshëm.

Mbështetja pothuajse ekskluzive të hidroenergjetikës krijon një varësi të lartë nga kushtet klimatike dhe rrezikon sigurinë energjetike në periudha thatësirash ose ndryshimesh sezonale. Kjo e bën urgjente nevojën për diversifikimin e burimeve energjetike, përmes zhvillimit të sektorëve të tjerë të rinovueshëm si energji diellore, e erës dhe biomasës, por gjithashtu përmes menaxhimit të kujdesshëm të burimeve fosile që janë ende pjesë e ekonomisë kombëtare, përfshirë këtu edhe sektorin e naftës dhe gazit natyror. Objektivat ndërkombëtare për dekarbonizimin e ekonomive, të përcaktuara në Marrëveshjen e Parisit dhe në kuadrin e Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, parashikojnë që përdorimi i karburanteve fosile të reduktohet ndjeshëm deri në vitin 2050.

Sektori i naftës në Shqipëri ka pasur një histori të gjatë dhe të rëndësishme ekonomike, veçanërisht në zonat e jugut dhe perëndimit të vendit si Patos-Marinza, Ballsh apo Kuçova. Në të kaluarën, ky sektor ka kontribuar ndjeshëm në punësim, të ardhura buxhetore dhe eksport, por aktualisht po përballlet me sfida të mëdha për shkak të rënies së prodhimit, mungesës së investimeve të reja dhe rritjes së presionit ndërkombëtar për dekarbonizim. Për këtë arsye, është thelbësore të vlerësohet roli që mund të luajë ky sektor në kuadrin të kalimit energjetik kombëtar, si dhe të analizohen mundësitë për ta transformuar gradualisht nga një sektor tradicional i karburanteve fosile në një aktor mbështetës të energjisë së pastër dhe të qëndrueshme.

6.1 Potenciali për tranzicion energjetik në sektorin e naftës

6.1.1 Gazifikimi dhe tranzicioni i butë

Një nga rrugët më të efektshme për të reduktuar gradualisht përdorimin e naftës në Shqipëri është zgjerimi i përdorimit të gazit natyror si një alternativë më pak ndotëse. Projekti Trans Adriatic Pipeline (TAP), i cili ka hyrë në funksion në fund të vitit 2020, krijon kushte të favorshme për gazifikimin e pjesshëm të tregut energjetik shqiptar. Kjo infrastrukturë e re jo vetëm që përmirëson sigurinë energjetike përmes aksesit më të gjerë në burime të reja, por gjithashtu mundëson zëvendësimin gradual të karburanteve më ndotës si nafta bruto, mazuti apo qymyri. TAP gjithashtu ofron potencial për t'u shndërruar në një kanal importi për gaz natyror të lëngshëm (LNG), çka do të mundësonte një sistem më fleksibël dhe më rezilient për furnizimin energjetik të vendit. Në këtë mënyrë, gazi natyror mund të përdoret si një karburant tranzitor, i aftë të mbështesë kalimin nga energjitë fosile drejt atyre të rinovueshme pa shkaktuar ndërprerje të mëdha në sistemin ekonomik apo industrial.

6.1.2 Transformimi i operatorëve ekzistues

Një tjetër aspekt kritik i tranzicionit energjetik në sektorin e naftës lidhet me rolin transformues të kompanive ekzistuese në këtë industri. Subjektet kryesore si Albpetrol dhe operatorë të tjerë me licenca në fushat e nxjerrjes, disponojnë një gamë të gjerë asetesh, infrastrukture dhe përvojë që mund të shfrytëzohen për të mbështetur investime në energji të rinovueshme. Këto kompani mund të përdorin zonat aktualisht të shfrytëzuara për të instaluar kapacitete fotovoltaike ose turbina ere, duke i shndërruar vendburimet e vjetra në qendra prodhimi të energjisë së pastër. Për më tepër, burimet njerëzore të trajnuara në këtë industri mund të ri-specializohen për teknologjitë e reja të energjisë. Kështu, përmes diversifikimit të portofolit të tyre, këto kompani mund të kalojnë nga një rol tradicional si nxjerrës të naftës, në aktorë aktivë të sektorit energjetik të qëndrueshëm.

6.1.3 Ulja e emetimeve nga nxjerrja

Ndërkohë që procesi i tranzicionit drejt energjisë së rinovueshme mund të kërkojë kohë, është e mundur dhe e nevojshme që të ulen ndjeshëm emetimet nga vetë operacionet ekzistuese të nxjerrjes së naftës. Kjo përfshin përdorimin e energjisë së pastër (si energjia diellore apo nga rrjeti i gjellbër) për të fuqizuar

pajisjet dhe sistemet e pompimit, duke ulur kështu ndjeshëm konsumin e karburanteve të brendshëm. Po ashtu, një masë tjetër e rëndësishme është integrimi i operatorëve në skemat e tregtimit të karbonit, si instrumente ekonomike që nxisin reduktimin e ndotjes përmes tregut. Për më tepër, përdorimi i teknologjive për kapjen dhe riciklimin e gazrave të mbetur, që zakonisht digjen ose lirohen në atmosferë, përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të performancës mjedisore të industrisë. Këto masa janë jo vetëm të nevojshme në kuadër të objektivave klimatike, por edhe strategjike për të ruajtur licencimin dhe legjitimitetin social të industrisë në të ardhmen.

6.1.4 Shfrytëzimi i të ardhurave për tranzicionin energjetik

Përsheptimi i tranzicionit energjetik është një prioritet strategjik për Shqipërinë, veçanërisht në një kontekst global ku vendet po kalojnë me shpejtësi drejt burimeve të qëndrueshme të energjisë. Shfrytëzimi i të ardhurave nga aktiviteti hidrokarburor — përfshirë rentën, tatimet, dividendet dhe kontributet fiskale — ofron mundësinë e financimit të investimeve që do të mundësojnë dhe përsheptojnë këtë kalim në burime energjie më të pastra dhe të qëndrueshme. Këto fonde duhet të orientohet drejt projekteve konkrete, të tilla si energjia e rinovueshme (diellore dhe eolike), elektrifikimi i transportit publik dhe privat, përmirësimi i efikasitetit energjetik në ndërtesa dhe industri, si dhe zhvillimi i qëndrueshëm rural përmes teknologjive të pastra dhe bujqësisë inteligjente për klimën.

Nëse këto të ardhura nuk drejtohen me kohë dhe strategji në ndërtimin e një ekonomie të qëndrueshme dhe të përgatitur për sfidat e epokës post-karburanteve fosile, Shqipëria mund të mbetet me një infrastrukturë të amortizuar dhe varësi të gjatë nga karburantet fosile, duke u përballur me sfida të mëdha. Tranzicioni energjetik nuk është vetëm një nevojë mjedisore, por edhe një mundësi zhvillimore që kërkon një vullnet politik të fuqishëm, planifikim të kujdesshëm dhe përdorimin strategjik të burimeve financiare ekzistuese.

Në këtë kontekst, furnizimi kryesor i Shqipërisë me energji dominohet nga nafta, hidrocentralet dhe biomasa. Megjithatë, sektori energjetik i vendit mbështetet shumë në importet e naftës, qymyrit dhe energjisë elektrike, duke reflektuar një evolucion të moderuar të furnizimit me energji që nga viti 2012, pa ndryshime të mëdha në përqindjet e vektorëve të energjisë. Rritja e aktivitetit në transport, e cila ka sjellë rritje të konsumit të lëndëve djegëse, veçanërisht naftë dhe benzinë, kërkon një angazhim të mëtejshëm për të reduktuar ndotjen dhe për të shkuar drejt përdorimit të energjive më të pastra dhe eficiente.

Në perspektivën afatshkurtër dhe afatmesme, sektori i transportit pritet të kontribuoni në reduktimin e ndotjes, me objektiva ambicioze për të ulur shkarkimet me më shumë se 60% deri në vitin 2050. Teknologjitë si makinat hibride dhe elektrike, si dhe përdorimi i biokarbureve në aviacion dhe transportin rrugor, do të jenë kyçe për këto reduktime. Kjo strategji kërkon politika që nxisin një klimë të qëndrueshme biznesi dhe investime me karbon të ulët, duke i dhënë prioritet zhvillimit të një ekonomie të gjelbër dhe energjetikisht të qëndrueshme.⁷⁸

⁷⁸ Strategjia e ndryshimeve klimatike dhe planet e veprimit. (2019). Marre nga https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/2.-Strategjia-e-Ndryshimeve-Klimatike-dhe-Planet-e-Veprimit_Qershor-2019_-1.pdf

BIBLIOGRAFIA

- Ligji, Nr.7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet” (kërkimi dhe prodhimi), i ndryshuar.
- Ligji Nr. 153/2020, “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”.
- Ligji Nr. 9957, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i përditësuar.
- Udhëzimi Nr. 6, datë 22.2.2022 “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”.
- Ligji nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”.
- Udhëzim i Përbashkët Nr. 17, datë 12.6.2015, “Për përcaktimin e listës së mallrave dhe shërbimeve që përdoren në realizimin e fazës së kërkimit të operacioneve hidrokarbure nga shoqëritë e kërkimit të hidrokarbureve, të cilat përjashtohen nga pagesa e TVSH-së, si dhe procedurat e përjashtimit”.
- Ligji 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar
- Ligji nr 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 247, date 30.04.2014, “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.
- VKM-në Nr. 686, datë 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, e ndryshuar.
- Ligji nr 91/2013 “Mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, i ndryshuar.
- Ligji nr 10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar.
- VKM Nr 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregulla të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”.
- VKM Nr. 551, datë 18.6.2015, “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure”.
- Ligj Nr.10 237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 562, datë 3.7.2013, “Për miratimin e rregullores “për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”.
- VKM Nr. 563, datë 3.7. 2013, “Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”.
- Ligj Nr. 8/2017, “Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit”.
- VKM Nr. 425, datë 10.5.2017, “Për rregullat e organizimit, funksionimit të komisionit për dhënien e dëshmisë së statusit të punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit, kriteret dhe procedurat për lëshimin e vërtetimit të posaçëm zyrtar”.
- Ligji Nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”.
- Këshilli i Ministrave. (2018). *Vendim nr. 480, datë 31.07.2018; Për miratimin e strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018-2030 – Shqipëria 2030*. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Marrë nga <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2024/09/vendim-2018-07-31-480.pdf>,
- Avokati i Popullit, (2024). *Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe mjedisit nga ndotja e hidrokarbureve në zonën e Patos Marinëz dhe qytetet përreth*. Marrë nga

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/rekomandim%2011%20dhjetor%20%2024%20albpetyl.pdf>.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Divizioni Teknik, & Drejtoria e Energjisë së Rinovueshme. (2024). *Hartimi i bilancit energjetik bazuar në përpunimin e informacionit sipas standardeve dhe rregulloreve të statistikës së energjisë të BE-së: Bilanci energjetik 2023*. Marrë nga <http://www.akbn.gov.al/ep-content/uploads/2014/06/Bilanci-Komb%C3%ABtar-i-Energjis%C3%AB-2023.pdf>
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit. *Raport i gjendjes në mjedis 2021*. Tiranë.
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit. *Raport i gjendjes në mjedis 2023*. Tiranë.
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit. (2015) *Ndotjet që vijnë nga hidrokarburet*. Tiranë. Marrë nga <https://akm.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/ndotjetet-qe-vijne-nga-hidrokarburet.-prill-2015.pdf>
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Europian 2022-2030. (2023). Marrë nga https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_538_Draft-Strategjia-Kombetare-per-Zhvillim-dhe-Integrim-2021--2030-.pdf.
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. (2020). *Plani i Biznesit për Parkun Kombëtar të Lumit të Egër Vjosa (2024-2034)*. Marrë nga <https://akzm.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Kapitulli-E.-Plani-i-Biznesit.pdf>.
- EITI, (2021). *Raporti Studimor Perfundimtar në fushën e Mjedisit për Industrinë Nxjerrëse*. Marrë nga <https://www.albeiti.org/site/wp-content/uploads/2021/07/al-ab-ba1-albania-eiti-environment-scoping-study-final-report-shqip-firmosur.pdf>.
- Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik, Raport nga ISHP për fshatin Marinëz.
- Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit. (2024). Marrë <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/Kapitulli-F.-Masterplani-per-Turizmin.pdf>
- Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2023). *Raport përfundimtar i auditimit të përputhshmërisë të ushtruar në Albpetrol sh.a Patos*. Tiranë.
- Albpetrol. (2024). *Urdhër Nr. 208, datë 21.06.2024, për "Miratimin e strategjise së menaxhimit të riskut të shoqërisë "Albpetrol" Sh.a, 2024.*. Marrë nga <https://albpetrol.al/wp-content/uploads/2024/06/208-Strategjia-e-Menaxhimit-te-Riskut.pdf>.
- Strategjia e ndryshimeve klimatike dhe planet e veprimt. (2019). Marrë nga https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/2.-Strategjia-e-Ndryshimeve-Klimatike-dhe-Planet-e-Veprimt_Qershor-2019_-1.pdf
- Albpetrol. (2018). *Geological reserves*. <https://www.albpetrol.al/en/geological-reserves/>
- Albpetrol. *Vendburimet neogjenike*. Albpetrol. <https://albpetrol.al/vendburimet-neogjenike/>
- Albpetrol. *Vendburimet gëlqerore*. Albpetrol. <https://albpetrol.al/vendburimet-gelqerore/>
- Anio.al. *Vendburimi Ballesh – Hekal*. Anio.al. <https://anio.al/prodhimi-nder-vite/>
- Albpetrol. *Prodhimi i naftës ndër vite*. <https://albpetrol.al/prodhimi-i-naftes-nder-vite/>
- Albpetrol. *Vendburimet*. Albpetrol. <https://albpetrol.al/vendburimet/>
- Anio.al. *Prodhimi ndër vite*. Anio.al. <https://anio.al/prodhimi-nder-vite/>
- Trans Adriatic Pipeline. <https://www.tap-ag.com/infrastructure-operation/tap-route-and-infrastructure>
- Albpetrol sh.a.. Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara (sipas viteve). <https://www.albpetrol.al/buxheti-plani-i-shpenzimeve-per-vitin-financiar-ne-vijim-dhe-vitet-e-kaluara-sipas-viteve/>
- Albpetrol sh.a. Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset (sipas viteve). <https://albpetrol.al/raport-vjetor-per-zbatimin-e-buxhetit-dhe-anekset-sipas-viteve/>

- Albpetrol sh.a. *Donacione, sponsorizime (sipas viteve)*. <https://albpetrol.al/donacione-sponsorizime-sipas-viteve/#>
- Cilesia e ujit te lumenjeve te shqiperise 2024- ref-2023, Marre nga <https://www.instat.gov.al/> .
- Shih <https://qbz.gov.al/>
- Shih <http://www.akbn.gov.al/marreveshjet-hidrokarbure-kompanite/>
- Shih <https://www.infrastruktura.gov.al/kompanite-2/>

Ky punim u mbështet nga Fondi Shumëdonator i Mbështetjes Programatike Globale për Industrinë Nxjerrëse (EGPS), i administruar nga Banka Botërore. Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë punim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bankës Botërore, Bordit të Drejtorëve Ekzekutivë të saj apo qeverive që ata përfaqësojnë